MBRETNIJA SHQIPTARE

Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësis

STATISTIKË
E
LËVIZJES DEMOGRAFIKE
DHE
GJENDJES SHËNDETSORE

NË PERIUDËN

1927-1932

BKSH

SHTYP. KRISTO P. LUARASI - TIRANË
1937

MBRETNIJA SHQIPTARE

DREJTORIJA E PËRGJITHËSHME E SHËNDETËSISË

STATISTIKË

E

LËVIZJES DEMOGRAFIKE

DHE

GJENDJES SHËNDETSORE

NË PERIUDËN

1927—1932

BKSH

TIRANË
Shtyp. Kristo P. Luarasi
1933

PËRMBAJTJE

Parathënje . . . . . faqe 5

PJESA E PARË

LËVIZJA DEMOGRAFIKE

I. - Popullsia . . . . . „ 10
II. - Lindjet . . . . . „ 10
III. - Vdekjet . . . . . „ 12
IV. - Vdekje foshnjash nënë 1 motsh . . . . . „ 14
V. - Martesat . . . . . „ 16
VI. - Shtim'i popullsisë . . . . . „ 18
VII. - Popullsia në prefekturat . . . . . „ 21

PJESA E DYTË

GJENDJA SHËNDETËSORE

I. - Buxheti . . . . . „ 29
II. - Organizimi i Drejt së Përgj. të Shëndetësisë . . . . . „ 30
III. - Aktiviteti i Institucioneve shëndetësore në periudën 1927-1932 . . „ 35
IV. - Të sëmurët e shtruar nëpër spitale e dispanseri . . . . . „ 38
V. - Çmendina . . . . . „ 40
VI. - Vepërimet e Shëndetësisë nëpër prefekturat . . . . . „ 41
1. — Prefektura e Shkodrës . . . . . „ 41
2 — „ „ Beratit . . . . . „ 43
3. — „ „ Korçës . . . . . „ 46
4. — „ „ Durrësit . . . . . „ 48
5. — „ „ Gjinokastrës . . . . . „ 50
6 — „ „ Tiranës . . . . . „ 52
7. — „ „ Vlorës . . . . . „ 53
8. — „ „ Elbasanit . . . . . „ 55
9 — „ „ Dibrës . . . . . „ 56
10. — „ „ Kosovës . . . . . „ 57
VII.-Lufta Kundër Malaries . . . . . „ 60
1. — Krijim'i Sekcionit Antimalarik . . . . . „ 60
2 — Methodat e Punës . . . . . „ 61
3. — Vepërimet e Stacioneve Antimalarike në qendrat e ndryshme . 63
A. — Tiranë . . . . . „ 63
B. — Durrës . . . . . „ 66
C. — Elbasan . . . . . „ 69
(Shënime të përgjithshme) . . . . . „ 72
VIII. - Mjekët shetitës dhe lufta kundër sëmundjeve të tjera endemike: sifilis, tuberkuloz . . . . . „ 76

SHTESA

Lista e mjekve në Shqipëri më 1932 . . . . . „ 77
Lista e dentistëve në Shqipëri më 1932 . . . . . „ 80
Lista e farmacistëve në Shqipëri më 1932 . . . . . „ 81
Lista e mamive në Shqipëri më 1932 . . . . . „ 83

Parathënje

Statistika që kemi botuar regullisht gjer më sot ka qënë më tepër një përmbledhje e veprimeve të Drejtorisë s'onë për çdo vit. Në fillim kjo ishte e vetëmja gjë që munt të bënim me që, për të bërë një statistikë në kuptimin e vërtetë të fjalës, duhej më parë grumbulluar materiali për disa vjet me radhë. Sepse, siç e kemi thënë edhe tjetër herë, statistika nuk është vetëm një përmbledhje cifrash por një shkencë e cila, në bazë të cifrave studion proceset e ndryshme të jetës në shoqërí. Për të caktuar se në ç'drejtim shvillohet një proces na duhet me doemos t'a studiojmë atë proces për një kohë pak a shumë të gjatë. Gjith'ashtu për të patur një idhé të saktë mi gjendjen shëndetësore të vëndit t'onë, për të caktuar në se sëmundjet e ndryshme shtohen apo pakësohen, duhej më parë të kishin përpara syve pasqyrën e kësaj gjendjeje për disa vjet me radhë. Tani që kjo kondit'e domosdoshme u plotësua, tani mundëm të bëjmë edhe një çap përpara në pregatitjen e kësaj statistike, çapin deciziv nga pikëpamja e statistikës si shkencë.

Prandaj statistika që po botojmë sivjet ndryshon krejt nga ato që kemi botuar gjer më sot. Ky ndryshim çfaqet në shumë pika. E par'e punës statistika e sivjetme përmbleth aktivitetin e Drejtorisë s'onë që nga viti 1927 e deri në funt të vitit 1932. Kështu që këtë herë kemi të bëjmë me tabela e diagrame që tregojnë tendencat e shvillimit të proceseve të ndryshmë që kanë të bëjnë me shëndetin publik. Kësisoj për herë të parë botimi ynë mer formën e një statistike të vërtetë. Duke hedhur një sy mi këto tabela e diagrame këndonjësi munt të kuptojë menjëherë se në ç'drejtim shvillohet gjendja e Shqipërisë nga pikëpamja e shëndetit pub-

lik. Përveç kësaj kemi bërë edhe një koment të çkoqitur, në mënyrë që kjo Statistikë t'u shërbejë jo vetëm specialistëve por edhe publikut të gjerë që interesohet me problemet sociale të vëndit t'onë.

Statistika që po u paraqesim sot këndonjësve është'e ndarë në dy pjesë: I. - *Lëvizja e popullsisë në Shqipëri në periudën 1927-32* dhe II. - *Vepërimet e shërbimit të Shëndetësisë në periudën 1927-32*. Esht'e tepër të nënëvijojmë këtu rëndësin' e lëvizjes demangrafike në një statistikë si kjo e jona. Popullsia është drejt për drejt materiali mbi të çilën shvillohet tërë aktiviteti yn ; popullsia është faktori kryesor në realizimin e çdo iniciative të fushën ekonomike dhe sociale. Kështu që për të formuar një idhé të saktë mbi shvillimin e një vëndi e para gjë që duhet studiuar është gjendja e popullsisë.

Në Statistikën t'onë materiali që kishim në dispozicion për vitet 1931—32 nuk ishte i plotësuar për disa prefektura. Prandaj u shtërnguam t'a plotësojmë duke u bazuar mbi cifrat e viteve të mëparshëm. Por këto rektifikime janë pa rëndësí dhe nuk e prekin rezultatin e përgjithëshmë. Kështu munt të konstatojmë me kënaqsí se, me gjithë krizën ekonomihe ku ndodhet vendi ynë, popullsia shtohet regullisht nga viti në viti. Kjo pasqyrë ngushëllonjëse po të marrim tërë Shqipërinë, erret në disa vendë kur të këqyrim lëvizjen demografike të çdo prefekture veç e veç. Për arsye që do të përpiqemi të shpiegojmë më poshtë, popullsia e prefekturës së Vlorës pakësohet regullisht, me përjashtim të vitit 1931. Gjith'ashtu edhe popullsia e prefekturës s'Elbasanit pakësohet gjer në vitin 1930 që ku vija e grafikut ndron drejtimin e saj duke shënuar një shtim popullsia relativisht mjaft me rëndësí. Grafiku i lëvizjes demografike në disa prefektura të tjera si Durrësi, Dibra, Kosova paraqitet me zig-zage që tregojnë një tendencë jo të stabilizuar nga pikëpamja e shvillimit të popullsisë.

Pjesën e dytë, q'i përket aktivitetit të instituteve shëndetësore, e kemi ndruar krejt këtë herë. Pik së pari i shtuam një kapitull mbi buxhetin e Drejtorisë s'onë dhe mbi mënyrën se si shpenxohet. Pastaj duke marrë numrin absolut e të mjekuarve nëpër spitale dhe ambulanca për disa vjet u përpoqme të nxjerrim disa konkluzione të përgjithëshme mbi evolucionin e sëmundje endemike si malaria, sifllizi, tukerkulozi, të cilat bëjnë dëmet më të mbëdha në vëndin t'onë. Për sa u përket spitaleve, vume vetëm

cifrat që tregojnë se sa veta janë mjekuar, sa janë operuar, shëruar etj., pa bërë listën e gjatë të sëmundjeve nga të cilat vuanin pacientët e pranuar në çdo spital.

Një kapitull të veçantë u a kushtuam përpjekjeve të Drejtorisë s'onë për të plotësuar rjetën e instituteve shëndetësore. Këtu në radhë të parë vjen spitali i Tiranës, i cili është një realizim i shkëlqyer dhe plotësoi disa nevoja të ngutëshme.

Masat që janë marrë për të lëftuar sifilizin dhe sidomos malarjen formojnë lëndën e një kapitulli më vehte. Lufta energjike q'u shvillua në këto vitet e fundit prej Shërbimit t'onë Antimalarik me ndihmën e çmuarshme të Fondacionit Rockefeller dhá pemët e veta. Sot munt të konstatojmë me kënaqësí të veçantë se malaria filloi të pakësohet në Shqipërí.

Por fitimet që kemi patur gjer më sot në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të vëndit t'onë nuk duhet të na bëjnë të qetësohemi. Se puna që mbetet për të bërë ësht'e madhe, shum'e madhe. Gjér më sot këmi lëftuar sëmundjet sidomos me masa kurative, domethënë duke u munduar të shërojmë njerëzit që vuajnë nga njëra ose tjetra sëmundje. Por shërimi i të sëmurëve nuk munt të jetë qëllimi ynë kryesor. Qëllimi ynë esencial është të ndalojmë përhapjen e sëmundjeve duke forcuar masat profilaktike. Ky qëllim do t'arrihet duke përhapur në popull pricipet e higjienës publike; me fjalë të tjera duhet t'i stërvisim njerëzinë si të rojnë, si të ruhen nga sëmundjet, si të lëftojnë kundër mikrobeve, armiqve më të rezikshëm të shëndetit t'onë. Kjo do të bëhet kur të kemi një organizatë të veçantë, për të cilën jemi duke pregatitur jashtë personalin e posaçëm, pikërisht ashtu sikurse bëhet edhe në botën e jashtme.

Në luftën kundër malarjes patmë rezultate pozitive me që vumë në zbatim sistematikisht dy masat profilaktike më me rëndësi: kininizimi dhe tharja e disa foleve më të rezikëshme mushkonjash. Mirëpo për të çdukur krejt malarjen nga Shqipëria duhet bërë një punë kolosale si tharj'e moçaleve regullim'i lumenjve etj., punë për të cilën nuk arrijnë kursesi mjetet që kemi né në dispozicion. Regullim'i ujrave, tharj'e knetave, është një punë e tërë qeverisë sepse andej varet jo vetëm çdukja e çdo foleje mushkonjash por edhe përmirësimi i bujqësisë, gjë q'intereson drejt për drejt Shtetin. Gjith'ashtu për të lëftuar me sistem tuberkulozën

duhen dispanseri të veçanta, duhet së paku një sanatorium, duhen infermiere shetitëse për të zbuluar folet' e molepsjes dhe për t'izoluar të sëmurët që rojnë në mes të familjes dhe marrin më qafë pa ditur misat e shëndoshë të saj.

Me një fjalë nga do q'e kapim punën përpiqemi gjithmonë në mungesën e mjeteve dhe të elementit medikal. Elementin medikal pak a shumë jemi duke e pregatitur jashtë, por sigurimi i mjeteve në sasin'e nevojshme për të realizuar planin që përshkruam më sipër do të bëhet vetëm ahere kur të shtohen t'ardhurat e Shtetit dhe kur të formohen në vend shoqëri mirëbërëse, ashtu sikurse ndodh edhe në shumë vende të huaja.

Sot për sot né përpiqemi të përdorim até personal mjekonjës dhe ato mjete që kemi në dispozicion në mënyrën më efikase për forcimin e shëndetit të popullit (*).

DREJTORIA E PËRGJITHËSHME

(*) Në pregatitjen teknike dhe në redaktimin e kësaj statistike Z. Tajar Zavalani ka marrë një pjesë aktive.

BKSH

PJESA E PARË

Lëvizja demografike

I. — POPULLSIA

Pas regjistrimit të përgjithëshmë q'u bë më 1930 Shqipëria ka një populls prej 1.003.097 frymë. Densiteti (dëndësia) e populsisë në Shqipërí është 36 frymë për çdo kilometrë kuadrat. Në barazim me shtetet e tjerë t'Evropës kjo cifër është mjaft e ulët. Belgjia, e cila është m'i populluari nga shtétet e vegjël t'Evropës, ka një densitet prej 270 frymë për çdo km², domethënë 7 herë e ca më tepër se Shqipëria. Po të marrim shtetet fqinj, të cilët kanë një strukturë gjeografike dhe ekonomike q'i afrohet s'onës, prapë se prapë krahasimi është në demin t'onë. Kështu për shëmbëll Bullgaria ka 58 frymë për km², Greqia 49 frymë për km² dhe Jugosllavia 48.

Po të vëmë ré mënyrën se si është ndarë populsia e Shqipërisë nëpër qarket e ndryshmë do të shohim ndryshime të mbëdha në densitetin (dëndësinë) për çdo qark. Kjo duket menjëherë po të hedhim një sy mbi kartën Nr. 1. Një pjes'e madhe e malësive në prefekturat e Shkodrës dhe të Kosovës, qarku i Kuçit në pref. e Beratit, Himara dhe qarku i Kolonjës kanë më pakë se 15 banorë për çdo km². Pjesa e madhe e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut ka 16 gjer më 30 frymë për km². Qarku i qytetëve Peshkopí, Durrës, Kavajë, Elbasan, Pogradec, Berat, Vlorë, Gjinokastër kap nga 31 e deri më 60 frymë për km². Shkodra me rethin e saj, Tirana dhe Bilishti arrijnë gjer më 85 banorë për km². Korça me fushën e saj ka rekordin e densitetit në tërë Shqipërinë (përmi 85 frymë për km²). Atje ku bujqësia është m'e përparuar populsia është m'e shëndoshë dhe m'e dëndur se kudo gjetkë në Shqipëri.

Që të munt të bënim një studim të plotë mbi populsinë duhej të dinim edhe ndarjen e saj pas seksit, pas moshës dhe mjeshtërisë. Materiali i mbledhur në kohën e rregjistrimit të përgjithëshmë po punohet prej zyrave kompetente. Shpresojmë se rezultatet do të dalin në dritë për së shpejti.

II. — LINDJET

Në periudhën që kemi parasysh lindjet karakterizohen me këto cifra:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
12776	12532	12806	19241	24927	25062

Një gjë që bie në sy këtu është shtesa e madhe në numrin e lindjeve në vitet 1930—32, kurse në vitet e tjerë cifra e lindjeve është stacionare (pa ndryshim të math). Siç do t'a shohim më poshtë kjo shtesë, duke filluar nga viti 1930, paraqitet edhe në cifrën e vdekjeve. Shtimi paralel i lindjeve dhe i vdekjeve në një sasí kaqë të gjerë nuk munt të jetë një gjë normale. Prandaj ndryshimi që konstatojmë më lart munt të shpiegohet vetëm duke pranuar se nga viti 1930 e tutje statistikat janë mbajtur më me kujdes. Kjo ka të ngjarë me që atë vit janë marrë masa të repta nga an'e autoriteteve për të detyruar popullin të deklarojë çdo lindje ose vde-


KARTA E DENSITETIT TË POPULLSISË:
nën 15 frymë për km²
16—30 » »
31—60 » »
61—85 » »
sipër 85 » »
KUKËS
SHKODRË
PESHKOPI
DURRËS
TIRANË
ELBASAN
LUSHNJË
FIER
BERAT
KORÇË
VLORË
LESKOVIK

kje. Duhet të bëjmë edhe një rezervë. Për dy vjetet e fundit statistika e disa prefekturave nuk është e plotë dhe ajo e pref. Tiranës mungon fare. Për ato prefektura që kanë dhënë cifrën e lindjeve vetëm për disa muaj, e plotësuam këtë cifër duke e zgjeruar proporcionalisht për tërë vitin, sapër prefekturën e Tiranës muarmë cifrat e vitit 1930. Më gjithë këtë, këto plotësime nuk janë të tilla që munt të ndryshojnë aspektin e përgjithëshmë të pasqyrës së lindjeve që parashtruam më sipër.

Po të krahasojmë citrën e lindjeve me atë të popullsisë do të gjejmë se:

PËR ÇDO 1000 FRYMË KANË LINDUR:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
12,7	12,5	12,8	19,2	24,9	25,0

Për të pasur një idhé mbi kuptimin e këtyre cifrave lé të marrim lindjet e përvitëshme në disa vise të tjera t' Evropës.

NUMR' I VËPVITSHËM I LINDJEVE PËR ÇDO 1000 FRYMË

EMR'I VENDIT	1927	1928	1929	1930	1931	1932
Shqipëri. . .	12,7	12,5	12,8	19,2	24,9	25,0
Belgji. . . .	18,4	18,4	18,2	18,7	—	—
Bullgari . .	33,1	32,8	30,1	30,6	—	—
Rumani. . .	35,2	35,9	34,1	35,0	—	—
Hollandë . .	23,1	23,3	22,8	23,0	—	—
Polloni . . .	32,2	32,5	32,1	32,4	—	—
Greqi. . . .	—	—	28,8	31,7	—	—

Vendi që ka rekordin e lindjeve n' Evropë është Rumania, me afro 36 lindje në vit për çdo 1000 frymë. Përgjithësisht nga pasqyra e sipërme del në shesh se viset ku bujqësia është baza e prodhimit kanë lindjet me të shumta. Kurse një vënt me industri të shvilluar dhe me popullsí të dëndur si Belgjia ka cifrën më të ulët të lindjeve. Këtu duken efektet e nji ligje demografike të njohur. Eshtë vënë ré gjithmonë se në katundet lindjet janë më të shumta se në qytetet. Konditat e vështira të jetës dhe përhapja e theorive të Malthus-it i shtyjnë punëtorët dhe përgjithësisht vegjëlin' e qytetëve të kufizojnë me dashje numrin e fëmijëve. Sapër Shqipërinë, po të pranojmë se cifrat e viteve 1930—32 i afrohen më tepër së vërtetës, duhet të konstatojmë se vendi ynë ku predominon bujqësia eshtë shumë prapa nga vëndet që kanë një strukturë ekonomike analloge. Në punën të lindjeve né jemi më afër me shtetet industrialë se sa me ata ku bujqësia është baza e jetës ekonomike. Ekstremet puqen. Një vëzhgonjës percipe do të kujtonte se shqiptarët janë bërë malthuzianistë pa hyrë në fazën industriale. E vërteta është se këtu njeriu ndodhet përpara disa shpiegimeve. Natyrisht nuk munt të pranojmë se katundari ose zanatçiu shqiptar janë bërë malthuzianistë para kohe, domethënë kufizojnë lindjet me dashje. Atëhere mbeten dy shpiegime që munt të merren parasysh: ose regjistrim' i lindjeve nuk është bërë me regull, ose cifra e përgjithëshme e popullsisë është'e ekzagjeruar. Sado që ndreqja e këtyre gabimeve (në qoftë se me të vërtetë këto gabime ekzistojnë) munt t' i shtojë pakë cifrat e lindjeve, prapë se prapë përqindja e lindjeve mbetet e ulët. Edhe këtu arësyeja e thellë është varfëria, niveli ekonomik i ulët dhe gjendja e keqe shëndetësore.

Po të marrim cifrën mesatare të lindjeve për çdo prefekturë në periudën 1927—32 do të kemi pasqyrën që vijon:

kje. Duhet të bëjmë edhe një rezervë. Për dy vjetet e fundit statistika e disa prefekturave nuk është e plotë dhe ajo e pref. Tiranës mungon fare. Për ato prefektura që kanë dhënë cifrën e lindjeve vetëm për disa muaj, e plotësuam këtë cifër duke e zgjeruar proporcionalisht për tërë vitin, sapër prefekturën e Tiranës muarmë cifrat e vitit 1930. Më gjithë këtë, këto plotësime nuk janë të tilla që munt të ndryshojnë aspektin e përgjithëshmë të pasqyrës së lindjeve që parashtruam më sipër.

Po të krahasojmë citrën e lindjeve me atë të popullsisë do të gjejmë se:

PËR ÇDO 1000 FRYMË KANË LINDUR:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
12,7	12,5	12,8	19,2	24,9	25,0

Për të pasur një idhé mbi kuptimin e këtyre cifrave lé të marrim lindjet e përvitëshme në disa vise të tjera t' Evropës.

NUMR' I VËPVITSHËM I LINDJEVE PËR ÇDO 1000 FRYMË

EMR'I VENDIT	1927	1928	1929	1930	1931	1932
Shqipëri. . .	12,7	12,5	12,8	19,2	24,9	25,0
Belgji. . . .	18,4	18,4	18,2	18,7	—	—
Bullgari . .	33,1	32,8	30,1	30,6	—	—
Rumani. . .	35,2	35,9	34,1	35,0	—	—
Hollandë . .	23,1	23,3	22,8	23,0	—	—
Polloni . . .	32,2	32,5	32,1	32,4	—	—
Greqi. . . .	—	—	28,8	31,7	—	—

Vendi që ka rekordin e lindjeve n' Evropë është Rumania, me afro 36 lindje në vit për çdo 1000 frymë. Përgjithësisht nga pasqyra e sipërme del në shesh se viset ku bujqësia është baza e prodhimit kanë lindjet me të shumta. Kurse një vënt me industri të shvilluar dhe me popullsí të dëndur si Belgjia ka cifrën më të ulët të lindjeve. Këtu duken efektet e nji ligje demografike të njohur. Eshtë vënë ré gjithmonë se në katundet lindjet janë më të shumta se në qytetet. Konditat e vështira të jetës dhe përhapja e theorive të Malthus-it i shtyjnë punëtorët dhe përgjithësisht vegjëlin' e qytetëve të kufizojnë me dashje numrin e fëmijëve. Sapër Shqipërinë, po të pranojmë se cifrat e viteve 1930—32 i afrohen më tepër së vërtetës, duhet të konstatojmë se vendi ynë ku predominon bujqësia eshtë shumë prapa nga vëndet që kanë një strukturë ekonomike analloge. Në punën të lindjeve né jemi më afër me shtetet industrialë se sa me ata ku bujqësia është baza e jetës ekonomike. Ekstremet puqen. Një vëzhgonjës percipe do të kujtonte se shqiptarët janë bërë malthuzianistë pa hyrë në fazën industriale. E vërteta është se këtu njeriu ndodhet përpara disa shpiegimeve. Natyrisht nuk munt të pranojmë se katundari ose zanatçiu shqiptar janë bërë malthuzianistë para kohe, domethënë kufizojnë lindjet me dashje. Atëhere mbeten dy shpiegime që munt të merren parasysh: ose regjistrim' i lindjeve nuk është bërë me regull, ose cifra e përgjithëshme e popullsisë është'e ekzagjeruar. Sado që ndreqja e këtyre gabimeve (në qoftë se me të vërtetë këto gabime ekzistojnë) munt t' i shtojë pakë cifrat e lindjeve, prapë se prapë përqindja e lindjeve mbetet e ulët. Edhe këtu arësyeja e thellë është varfëria, niveli ekonomik i ulët dhe gjendja e keqe shëndetësore.

Po të marrim cifrën mesatare të lindjeve për çdo prefekturë në periudën 1927—32 do të kemi pasqyrën që vijon:

NUMRI MESATAR I LINDJEVE NË PREFEKTURAT
(për çdo 1000 frymë)

1)	*Prefektura e Shkodrës . . .*	*22,0*	
2)	» *e Beratit . . . .*	*20,0*	
3)	» *e Durrësit . . .*	*19,2*	
4)	» *e Korçës . . . .*	*18,5*	
5)	» *e Gjinokastrës .*	*18,0*	
6)	*Prefektura e Vlorës. . . .*	*15.4*	
7)	» *e Kosovës . . .*	*14,8*	
8)	» *e Elbasanit . .*	*14,1*	
9)	» *e Dibrës . . .*	*12,0*	
10)	» *e Tiranës. . .*	*9,0*	

Numri mesatar i lindjeve për tërë Shqipërinë është 17 për çdo 1000 frymë. Në pesë prefekturat e para lindjet e kalojnë cifrën mesatare për tërë Shqipërinë. Kështu, prefekturat që kanë lindjet më të shumta janë ato që kanë gjendjen më të mirë qoftë nga pikëpamja ekonomike qoftë nga konditat klimaterike.

III. – VDEKJET

Në periudën që kemi parasysh cifrat absolute të vdekjeve në tërë Shqipërinë janë këto:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
10103	9611	12025	16339	16675	17870

Edhe këtu bie në sy shtes'e fortë e vdekjeve nga viti 1929 më 1930. Ky ndryshim, i cili përsëritet në vitet 1931 dhe 1932, rjeth nga mbajtja m'e kujdesëshme e statistikave.

Numr'i përvitshëm i vdekjeve në krahasim me popullsín'e vëndit na jep pasqyrën që vijon:

VDEKJE PËR ÇDO 1000 FRYMË:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
10,0	9,6	12,0	16,0	16,6	17,8

Duke krahasuar përqindjet e vdekjeve në Shqipërí me ato të disa shteteve të tjerë do të shohim se mortaliteti në vëndin't'onë është nga më të ultët:

VDEKJE PËR ÇDO 1000 FRYMË

EMR'I VËNDIT	1927	1928	1929	1930	1931	1932
Shqipëri. . .	10,0	9,6	12,0	16,0	16,6	17,8
Belgji. . . .	13,5	13,2	15,0	13,3	—	—
Bullgari . .	20,2	17,5	17,8	15,8	—	—
Rumani. . .	22,9	20,2	21,4	19,4	—	—
Hollandë . .	10,2	9,6	10,7	9,1	—	—
Polloni . . .	17,6	16,7	16,9	15,7	—	—

Kjo pasqyrë duhet të na gëzojë, vetëm po të jetë se regjistrimi i vdekjeve nepër qarket është bërë me regull dhe cifrat që kemi në dorë janë ekzakte.

Do t'ishte mirë të dinin shkakun e vdekjeve që kështu të munt të caktonim numrin e viktimave që bëjnë sëmundjet e ndryshme në Shqipërí. Kjo është një nga pikat e programit t'onë. Realizim'i saj është lidhur me plotësimin e rjetës s'insituteve shëndetësore. Vetëm atëhere statistika e lindje-vdekjeve do të munt të mbahet prej organeve të shëndetësisë në tërë Shqipërinë dhe me tërë shënimet që lypen për të bërë një statistikë të plotë.

Po të këqyrim përqindjen e vdekjeve në çdo prefekturë, do të shohim një ndryshim të math në krahasim me lindjet.

CIFRA MESATARE E VDEKJEVE NË PREFEKTURAT
(për çdo 1000 frymë)

1)	*Prefektura e Kosovës . . . .*	*11,5*	
2)	» *e Korçës . . . .*	*11,6*	
3)	» *e Dibrës . . . .*	*11,8*	
4)	» *e Gjinokastrës .*	*12,5*	
5)	» *e Elbasanit . .*	*14,0*	
6)	*Prefektura e Shkodrës . .*	*14,7*	
7)	» *e Beratit . . .*	*16,0*	
8)	» *e Durrësit . .*	*16,0*	
9)	» *e Vlorës . . .*	*18,0*	
10)	» *e Tiranës. . .*	—	

Këtu rendi i prefekturave është pothua së-prapi në krahasim me lindjet. Ato prefektura, të cilat në pasqyrën e lindjeve vinin në shtyllën e parë, këtu vinë në shtyllën e dytë e *vice versa*. Në pasqyrën e lindjeve prefekturat i radhitëm duke vënë në krye ato që kanë lindjet më të shumta në proporcion me popullsinë, kurse në pasqyrën e vdekjeve në krye vumë ato prefektura që kanë vdekjet më të pakta duke marrë si bazë krahasimi çdo grup

TABELA Nr. 1

Lindje - Vdekjet në Shqipëri në periudën 1927-1930



Për vitet 1931-32 shih pasqyrën e faqes 19.

1000 frymësh. Nga kjo rjeth se prefekturat që kanë përqindjen më të lartë të lindjeve nuk kanë me doemos përqindjen më të ulët të vdekjeve. Në realitet ngjet e kundërta. Vetëm Korça me Gjinokastrën formojnë një përjashtim në këtë mes. Ato kanë lindje të shumta dhe vdekje të pakta prandaj në të dy pasqyrat figurojnë në shtyllën e parë. Domethënë nuk është mjaft të kesh shumë lindje po duhet të kesh dhe vdekje pakë që të shtohet popullsia. Kjo vërtetohet edhe me shtetet e tjerë. Rumania ka rekordin e lindjeve n' Evropë, por ka dhe rekordin e vdekjeve, prandaj në shtimin e popullsisë nuk vjen në radhë të parë, siç do t' a shohim më poshtë.

Në tabelën Nr. 1 tregohet raporti i lindjeve me vdekjet në katër vjetët 1927-1930.

IV. — VDEKJE FOSHNJASH (NËNË 1 MOTSH)

Date pak a shumë të sakta mbi vdekjet në mes të foshnjave mot motsh' e poshtë kemi vetëm duke filluar nga viti 1930. Për të pasur një idhé mbi mortalitetin në mes të foshnjave do të krahasojmë lindjet e një viti me numrin e foshnjave nënë 1 motsh që kanë vdekur po n' atë vit.

	1930	1931	1932
Lindje	19241	24927	25062
vdekje foshnjash	3240	2831	3156

TABELA Nr 2

Lindje - Vdekjet në Pref. e Korçës në periudën 1927-1930



Për vitet 1931-32 shih pasqyrën e faqes 22.

BKSH

Domethënë se nga 1000 foshnja lindur të gjallë kanë vdekur brënda vitit:

1930	1931	1932
170	114	126

Këto cifra janë të larta, por jo më të lartat n' Evropë. Siç duket nga pasqyra më poshtë, Shqipëria nuk ësht' e para, për fat të mirë, në vdekjen e foshnjave:

NUMRI MESATAR I VDEKJEVE FOSHNJASH DERI I MOT NË KRAHASIM ME LINDJET

Shqipëri	137	*Rumani*	196
Belgji	93	*Hollandë*	56
Bullgari	137		

TABELA Nr. 3

Lindje - Vdekjet në pref. e Gjinokastrës në periudën 1927-1930



Për citet 1931—1932 shih pasqyrën e faqes 23.

BKSH

Në prefekturat vdekja e foshnjave karakterizohet me këto cifra:

PËR ÇDO 1000 FOSHNJA VDESIN PA MBUSHUR MOTIN	
1) *Prefektura e Beratit 114*	6) *Prefektura e Korçës . . . 135*
2) » *e Durrësit . . . 177*	7) » *e Kosovës . . . 122*
3) » *e Dibrës 180*	8) » *e Shkodrës . . 153*
4) » *e Elbasanit . . . 169*	9) » *e Tiranës . . 146*
5) » *e Gjinokastrës . 106*	10) » *e Vlorës . . . 183*

Këto cifra i japim me rezervë me që nuk i përshtaten gjendjes që dimë nga informata indirekte.

V. — MARTESAT

Numr' i përvitshëm i martesave në periudën 1927—32 arrin.	1927	1928	1929	1930	1931	1932
	6340	5695	4265	5840	5942	4761

TABELA Nr. 4

Lindje-Vdekjet në pref. e Shkodrës në periudën 1927-1930



Për vitet 1931-32 shih pasqyrën e parë të faqes 24.

BKSH

Këtu nuk shohim ndryshimet e mbëdha nga moti në mot, që pamë në cifrat e lindje-vdekjeve, kjo tregon se regjistrim' i martesave është bërë më me regull.

Si pas methodës që kemi adoptuar, edhe për martesat do të bëjmë një krahasim me disa shtete të tjerë.

MARTESA PËR ÇDO 1000 FRYMË

EMR'I VENDIT	1927	1928	1929	1930	1931	1932
Shqipëri . .	6,3	5,7	4,2	5,8	5,9	4,7
Belgji	9,1	9,0	8,9	8,9	—	—
Bullgari . .	9,3	9,9	9,7	9,6	—	—
Rumani . .	10,2	9,2	9,1	9,2	—	—
Hollandë . .	7,5	7,7	7,9	8,0	—	—
Polloni . . .	8,7	9,7	9,8	9,6	—	—

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË BIBLIOTEKA KOMBËTARE

TABELA Nr. 5

Lindje - Vdekjet në pref. e Beratit në periudën 1927-1930



Për vitet 1931-32 shih pasqyrën e dytë të faqes 24.

Një gjë është për t' u vënë ré. Përqindja e martesave në Rumaní është aq' e lartë sa dhe në Belgjí, kurse lindjet janë dy herë më të- | për. Kjo provon se në vënde me industrí të shvilluar si është Belgjija, të martuarit e kufizojnë me dashje numrin e fëmijëve që bëjnë.

VI. — SHTIM' I POPULLSISË

Statistikat e lindje-vdekjeve për tërë Shqipërinë tregojnë se popullsia e vëndit t' onë | shtohet regullisht nga viti në vit. Kjo duket nga cifrat që radhojmë në faqën tjatër.

TABELA Nr. 6

Lindje-Vdekjet në pref. e Durrësit në periudën 1927-1930



Për vitet 1931-32 shih pasqyrën e tretë të faqes 24.

SHTIM'I POPULLSISË NË PERIUDHËN 1927—32

	1927	1928	1929	1930	1931	1932
Lindje. . . .	12776	12532	12806	19241	23927	24360
Vdekje . . .	10103	9611	12025	16339	16675	17870
	+ 2673	+ 2921	+ 781	+ 2902	+ 7252	+ 6490

Gjithësej popullsia e Shqipërisë është shtuar: 23119 frymë. Në krahasim me vitet e tjerë, shtimi më 1931 dhe 1932 është më tepër se dyfish. Kjo tendenc'e popullsisë është përfytyruar më një mënyrë që bie në sy në tabelën Nr. 1. Siç e shënuam edhe në parathënien, tabela kap periudën 1927—1930, me qënë se kur pregatitmë tabelat e diagramet materialin mbi lindje-vdekjet për vitet 1931—32 nuk e kishim në dorë.

Po t'a ndajmë cifrën mesatare të tepricës së lindjeve për një vit me cifrën e përgjithëshme të popullsisë do të gjejmë se popullsia e Shqipërisë shtohet në proporcion 3,8 për çdo 1000 frymë. Ky shtim është tepër i pakë sikundër duhet nga pasqyra e faqes tjatër.

TABELA Nr. 7

Lindje-Vdekjet në pref. e Kosovës në periudën 1927-1930



Për vitet 1931-32 shih pasqyrën e parë të faqes 25.

TEPRICA E LINDJEVE MI VDEKJET PËR ÇDO 1000 FRYMË	
Shqipëri 3,8	*Rumani* 14,0
Belgji 4,7	*Hollandë* 13,1
Bullgari 13,8	*Polloni* 15,6

Këtu cifrat flasin vetë, prandaj komentet janë të tepra. Belgjia ku, siç e pamë, lindjet janë më të ulta nga të gjithë shtetet që figurojnë në pasqyrën t' onë, prap se prapë ka një shtim popullsie më të lartë se t' onën. Edhe një gjë duhet theksuar këtu. Masa e shtime të popullsisë varet nga raporti midis dy faktorëve: lindje, vdekje. Prandaj nuk është mjaft të kesh përqindjen më të lartë të lindjeve ose përqindjen më të ulët të vdekjeve që të kesh shtimin më të fortë të popullsisë. Kështu në krahasimin t' onë Rumania ka përqindjen më të lartë të lindjeve, Hollanda përqindjen më të ulët të vdekjeve, me gjithë këtë Po-

TABELA Nr. 8

Lindje - Vdekjet në Pref. e Tiranës në periudën 1927-1930



Për vitet 1931-32 shih *post-scriptum* në faqen 27.

llonia është vëndi ku popullsija shtohet më shpejt se kudo gjetkë n' Evropë.

Në diagramën Nr. 1 shihet evolucioni i lindjeve për çdo trimestër (tre muaj). Vija e kuqe përfytyron lindjet, vija e zezë vdekjet, pjesa e lyer me bojë të kuqe tregon periudat ku lindjet kapërxejnë vdekjet, pjesa e lyer me bojë të kaltërt tregon periudat ku vdekjet kanë qënë më të shumta se lindjet. Një tepricë vdekjesh shihet në dy raste: në trimestrin e dytë të vitit 1929 dhe në gjysmën e parë të vitit 1930.

Sido qoftë, këto ndryshime akcidentale nuk e prekin tendencën e përgjithëshme, e cila tregon shtimin e regullshëm të popullsisë nga viti në vit. Pas cifrave që radhitëm më sipër popullsia e Shqipërisë duhet të jetë sot:

1,019.741 frymë

VII. — POPULLSIA NË PREFEKTURAT

Ndryshime të mbëdha, tendenca të kundërta njera me tjetrën paraqet lëvizja demografike në prefekturat. Çdo prefekturë do t' a studiojmë këtu duke filluar nga ato që kanë shtimin më të fortë të popullsisë në cifra absolute.

TABELA Nr. 9

Lindje - Vdekjet në pref. e Dibrës në periudën 1927-1930



Për vitet 1931-32 shih pasqyrën e tretë të faqes 25.

1. Në radhë të parë nga shtim'i popullsisë vjen prefektura e Korçës, ku në gjashtë vjet kemi:

	1927	1928	1929	1930	1931	1932	SUMA E SHTIMIT
Lindje . .	2321	2321	2265	2448	3703	4005	
Vdekje . .	1370	1250	1330	2104	2193	2059	
Shtim . .	951	1071	935	344	1510	1946	6757
Pakësim .	—	—	—	—	—	—	

Në tabelën Nr. 2 jepen cifrat për çdo vit në një formë më të dukëshme, por mjerisht gjer më 1930, për arësyet që shpieguam më sipër. Nga këto cifra del se shtim'i popullsisë nuk ësht'i regullshëm: 344 më 1930, 1946 më 1932.

2. E dyta vjen prefektur'e Gjinokastrës me një shtim popullsie në gjashtë vjet prej: 5319

TABELA Nr. 10

Lindje-Vdekjet në pref. e Elbasanit në periudën 1927-1930



Për vitet 1931-32 shih pasqyrën e faqes 26.

frymë. Tabela Nr. 3 tregon sasín'e lindjevdekjeve për katër vjet (1927-30). Këtu evolucioni nuk është aqë i paregulltë sikundër duket nga cifrat që radhojmë më poshtë: (këtu hyjnë edhe cifrat e viteve 1931—32).

	1927	1928	1929	1930	1931	1932	SUMA E SHTIMIT
Lindje . .	1774	2510	1840	3431	3404	3416	
Vdekje . .	1799	1570	1558	2037	2040	2052	
Shtim . .	—	940	282	1394	1364	1364	5319
Pakësim .	25	—	—	—	—	—	

Kështu më 1927 kemi një pakësim 25 vetash, kurse më 1930 shtohen 1394 veta.

3. Prefektura e Shkodrës vjen e para nga lindjet por e treta nga shtim'i popullsisë. Ta-

TABELA Nr. 11

Lindje-Vdekjet në pref. e Vlorës në periudën 1927-1930



Për pitet 1931—1932 shih pasqyrën e dytë të faqes 26.

bela Nr. 4 na jep pasqyrën e lindje-vdekjeve gjer më 1930.

Cifrat që vijojnë e plotësojnë tabelën për vitet 1931—32.

	1927	1928	1929	1930	1931	1932	
							SHUMA E SHTIMIT
Lindje . .	2608	2001	1648	3071	3801	3680	
Vdekje . .	1635	1572	1270	2395	2290	2498	
Shtim . .	973	429	378	676	1511	1182	5149
Pakësim .	—	—	—	—	—	—	

Munt të themi se prefektura e Shkodrës është' ajo që paraqet shtimin më të regullshëm të popullsisë, domethënë se është prefektura që paraqet ndryshimet relativisht më të vogla nga viti në vit.

4. Me prefekturën e Beratit cifra absolute e shtimit të popullsisë fillon e bie afro gjysmë për gjysmë në barazim me atë të Korçës. Në tabelën Nr. 5 duket raporti midis lindjeve dhe vdekjeve për katër vjetët 1927—30.

Pasqyra që vijon na jep shtimin për gjashtë vjet (1927—32) i cili arrin cifrën 3281 frymë.

	1927	1928	1929	1930	1931	1932	
							SHUMA E SHTIMIT
Lindje . .	2129	1705	2296	3029	4126	3773	
Vdekje . .	1607	1095	2073	2820	2874	3308	
Shtim . .	522	610	223	209	1252	465	3281
Pakësim .	—	—	—	—	—	—	

Edhe këtu shtimi është fare i paregullte. Nga viti 1930 më 1931 kemi një diferencë shtimi prej 1043 frymësh, domethënë 1 me 6.

5. Një fenomen t'interesatshëm na paraqet prefektura e Durrësit. Gjer më 1930 gjendja demografike atje ka qën'e vështirë. Kurse nga 1930-a e këtej kemi një shtim sistematik të popullsisë, në mënyrë që prefektura e Durrësit nga radha e 8-të që kish gjer më 1930 vjen në radhën e 5-të më 1932. Kjo munt të shpiegohet sidomos me përmirësimin e gjendjes shëndetësore, në lidhje me luftën sistematike q'është shvilluar kundër malarjes.

Kontrasti midis tabelës Nr. 6 dhe pasqyrës që vjen pas bie në sy.

	1927	1928	1929	1930	1931	1932	
							SHUMA E SHTIMIT
Lindje . .	814	998	1061	1854	1884	2400	
Vdekje . .	1021	814	1084	1554	1304	1733	
Shtim . .	—	184	—	300	580	667	1501
Pakësim .	207	—	23	—	—	—	

Shtimi për 6 vjet në prefekturën e Durrësit arrin kësisoj: 1501 frymë.

6. Kosova, prefektura m'e varfër dhe me popullsinë më të pakë vjen e gjashta nga shtim'i popullsisë në cifra absolute. Në gjashtë vjet (1927—32) janë shtuar: 963 frymë. Tabela Nr. 7 na tregon se shtim'i përvitshëm vjen duke u pakësuar.

Në pasqyrën që vijon shohim se më 1931 pakësimi arrin në cifër negative, domethënë vdekjet i kapërxejnë lindjet. Kurse më 1932 kemi një shtim të fortë.

	1927	1928	1929	1930	1931	1932	SHUMA E SHTIMIT
Lindje . .	609	631	534	714	733	1146	963
Vdekje . .	361	408	428	703	747	757	
Shtim . .	248	223	106	11	—	389	
Pakësim .	—	—	—	—	14	—	

7. Prefektur'e Tiranës vjen e shtata, pas statistikës së bërë gjer në funt të 1930-ës, me që për dy vjetët e fundit s'ka paraqitur asnjë datë. Tabela Nr. 8 edhe pasqyra që vjen më poshtë na tregojnë një cifër negative më 1927, pastaj popullsía vjen duke u shtuar.

	1927	1928	1929	1930	SHUMA E SHTIMIT
Lindje . .	185	184	755	992	528
Vdekje . .	220	157	458	753	
Shtim . .	—	27	297	239	
Pakësim .	35	—	—	—	

Po të marrim për bazë periudën 1927—30 prefektur'e Tiranës vjen e para në përqindjen e vdekjeve, domethënë se atje vdekjet në krahasim me popullsinë kanë qënë më të ulta se në çdo prefekturë tjetër. Me gjith'atë në shtimin e popullsisë, *për periudën që kemi parasysh,* vjen e gjashta sepse edhe përqindja e lindjeve është fare e ulët. Gjith'ashtu po të marrim periudën 1927—30 do të shohim se prefektura e Kosovës vjen e para me përqindjen më të ulët të vdekjeve, me gjith'atë në shtimin e popullsisë në cifra absolute vjen e 6-*a*.

8. Edhe në prefekturën e Dibrës vija e lëvizjes demografike del me hipje e zbritje që kanë një karakter, si të themi, konvulziv. Tabela Nr. 9 na jep raportin e lindje-vdekjeve për periudën 1927—30.

Nga pasqyra që vijon, e cila kap edhe vitet 1931—32 shihet se tendencat konvulzive që shënuam më sipër vazhdojnë.

	1927	1928	1929	1930	1931	1932	SHUMA E SHTIMIT
Lindje . .	1096	969	1144	1151	1292	884	352
Vdekje . .	747	967	1189	1224	1142	915	
Shtim . .	349	2	—	—	150	—	
Pakësim .	—	—	45	73	—	31	

Si rezultat në funt të 6 vjetve kemi një shtim prej 352 frymësh. Por ky proces siç e thamë, nuk është i regullshëm. Në tre vjet nga të gjashtët, kemi cifra negative; kjo tregon se gjendja në prefekturën e Dibrës nga pikëpamja demografike është mjaft kritike.

9. Me prefekturën e Elbasanit hyjmë në radhën e prefekturave ku gjendja nga pikëpamja demografike bëhet fare alarmonjëse. Po të këqyrim vetëm tabelën Nr. 10 do të shohim se popullsia e prefekturës s'Elbasanit pakësohet sistematikisht.

Përkundrazi cifrat komplementare që kemi për vitet 1931—32 tregojnë një ndrrim radikal të situatës. Sikundër duket nga pasqyra që vijon në këto dy vjetet e fundit kemi një shtim, dhe një shtim serioz, të popullsisë.

	1927	1928	1929	1930	1931	1932	SHUMA E SHTIMIT
Lindje . .	929	922	936	1433	2527	2674	84
Vdekje . .	819	1097	1408	1697	2142	2174	
Shtim . .	110	—	—	—	385	500	
Pakësim .	—	175	472	264	—	—	

Një pasqyrë e tillë shënon një gjendje anormale dhe është zor të interpretohet. Duke ditur se datet që kemi në dorë munt të kenë të meta, në kemi pranuar se gabimet janë një soj si për lindjet ashtu dhe për vdekjet, kështu që tendenca e përgjithëshme prapë del në shesh. Për shëmbëll më 1930 kemi një shtim të shëndoshë në lindjet, por ky shtim konstatohet edhe në vdekjet kështu që rezultati mbetet prapë negativ, siç është edhe në vitet e mëparshëm. Kurse më 1931 lindjet shtohen 76 për qint dhe vdekjet vetëm 26 për qint. Shkenca statistike ngel e pafuqishme kur vjen puna për të shpieguar një ndryshim kaqë të math në një kohë kaqë të shkurtër. Aqë më tepër kur konditat e përgjithëshme nuk kanë qënë aspak të tilla që munt të gjystifikonin një shtim kaqë anormal. Prandaj i vetëmi shpiegim në këtë rast është që statistika çalon.

10. Prefekturat që pamë gjer këtu tregojnë sido kudo një shtim popullsie brënda gjashtë vjetve që kemi parasysh. Vetëm prefektur'e Vlorës del me një pakësim popullsie prej 805 frymësh. Tabela Nr. 11 na jep raportin midis lindjeve dhe vdekjeve për katër vjetët 1927-30.

Tre vjet me radhë kemi cifra negative dhe mjaft të shëndosha. Më 1930 shohim një ndryshim qint për qint nga — 333 në + 77. Gjith'atë ndryshim radikal na tregojnë edhe dy vjetët e fundit, sikundër duket nga pasqyra që vijon:

	1927	1928	1929	1930	1931	1932	SHUMA E PAKËSIMIT
Lindje . .	311	252	374	1149	1465	1410	805
Vdekje . .	524	652	707	1072	1190	1621	
Shtim . .	—	—	—	77	275	—	
Pakësim .	213	400	333	—	—	211	

Po të vëmë ré se prefektura e Vlorës ka përqindjen më të lartë në vdekjen e foshnjave deri me 1 mot, munt të nxierim me siguri konkluzien që në prefekturën e Vlorës popullsía pakësohet sistematikisht.

———

Më sipër radhitëm prefekturat duke marrë për bazë numrin absolut të shtimit të popullsisë në gjashtë vjetët 1927—32 Kjo nuk është mjaft. Për të pasur një idhé se me ç'rithmë shtohet popullsia e një vendi duhet parë raporti i shtimit të përvitshëm me tërë popullsín'e atij vëndi.

Shtimi mesatar i popullsisë për çdo vit dhe për çdo 1000 frymë në prefekturat e ndryshme arrin:

1) *Pref. e Korçës* 7,6
2) » *e Shkodrës*. . . 6,5
3) » *e Gjinokastrës*. 6,1
4) *Pref. e Beratit* . . . 3,8
5) » *e Kosovës* . . . 3,3
6) » *e Durrësit* . . 3,2
7) » *e Tiranës* . . . 2,2
8) *Pref. e Dibrës* . . . 0,7
9) » *e Elbasanit* . . 0,1
10) » *e Vlorës* — 2,5

Shtim'i popullsisë për tërë Shqipërinë është, siç e pamë, 3,8 në vit për çdo 1000 frymë. Ndryshimi në mes të prefekturave, i cili vete nga + 7,6 gjer në — 2,5 është shum'i math. (¹) Kjo tregon se në Shqipërinë t'onë të vogël në mes të qarkeve të ndryshme ka ndryshime të mbëdha, si nga pikëpamja gjeografike dhe klimaterike ashtu dhe në strukturën ekonomike dhe sociale; këto ndryshime çfaqen në një mënyrë që bie në sy në cifrat që radhitëm më sipër.

Për të mbyllur këtë kapitull duhet të theksojmë se cifrat që karakterizojnë lëvizjen demografike munt të kenë mjaft të meta, prandaj duhen marrë me rezervë. Sido qoftë një gjë munt t'a themi pa pikë përgënjeshtrimi: gjendja e Shqipërisë nga pikëpamja e popullsisë është mjaft kritike, sidomos në disa prefektura si Elbasani dhe Vlora. Këtu duhen masa të shpejta dhe energjike për të ndaluar rymën e së keqes. Këto masa interesojnë Shtetin e tërë, prandaj duhen studjuar prej qeverisë.

Sapër statistikën e lindje-vdekjeve Drejtoria jonë, me të plotësuar kuadret e qendrave shëndetësore në të gjitha qarket, do të përpiqet t'a mbajë me anën e organeve të saj, kështu që atëhere do të kemi date më të plota dhe më ekzakte.

(¹) Nga këto cifra duket sikur kemi të bëjmë me frakcione (copa) njeriu. Kjo bëhet për të lehtësuar punën. Për të pasur njerës tamam duhej të mernim cifra të ndryshme për çdo prefekturë. P. sh. në prefekturën e Korçës shtohet 1 njeri në vit për çdo 131 veta, në Shkodër shtohet 1 njeri për çdo 154 veta, në Vlorë pakësohet 1 njeri në vit për çdo 400 veta. Mirëpo me këtë mënyrë është shumë zor të caktojmë menjëherë se ku popullsia shtohet më shpejt. Prandaj marrim një cifër uniforme (1000) për të gjithë vëndet dhe, në bazë të shtimit absolut për tërë vitin, shtiem sa i bie për 1000 frymë.

P. S. — Me qënë se materiali mbi lindje-vdekjet në prefekturën e Tiranës më 1931 e 1932 na erdhi tepër von u shtërnguam të plotësojmë lëndën e faqes 25 me pasqyrën që vijon:

OBJEKTI	1931	1932
Lindje	1280	1594
Vdekje	1103	1374
Shtim	+ 177	+ 220

Shtim'i popullsisë në prefekturën e Tiranës për 6 vjet (1927-32) arrin: 925 frymë. Pas këtij hesapi shtimi mesatar i përvitshëm për çdo 1000 frymë arrin: 2,7. Kështu që vëndi i Tiranës në pasqyrën e fundit të faqes 26 mbetet prapë ay që ka qënë.

DIAGRAMË Nr. 1.



BKSH

PJESA E DYTË

Gjendja shëndetësore

I. — BUXHETI

Në periudën që na intereson buxheti i Drejtorisë s'onë ka qënë:

NË MIJËRA FR. ARI

1928-29	1929-30	1930-31	1931-32	1932-33
559,00	519,90	594,00	524,20	887,4

Në buxhetin e vitit financiar 1932-33 kemi një shtim prej 68,7%, në barazim me atë të vitit të mëparshëm. Ky shtim është rezultati i hyrjes në shërbim të Drejtorit të Përgjithshëm të sotmë.

Për të caktuar mënyrën se si spenxohet buxheti ynë, në pasqyrën që vjen më poshtë e kemi ndarë në pesë kaptina: 1) rrogë personali, 2) mbajtj'e spitaleve dhe instituteve të tjera shëndetësore, 3) blerje barnash, 4) bursa specializimi dhe 5) të ndryshme. Pranë cifrës absolute të çdo kaptine kemi vënë edhe përqindjen që kap ajo cifër nga suma e përgjithëshme e buxhetit.

BUXHETI I DREJTORISË SË PËRGJITHËSHME TË SHËNDETËSISË
në mijëra fr. ari

KAPTINA	1928-29		1929-30		1930-31		1931-32		1932-33	
	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%
Rrogë personali	150,3	26,8	165,7	29,0	165,8	28,0	152,9	29,1	290,3	32,7
Mbajtj'e spitaleve	317,0	56,6	310,6	54,5	350,8	60,0	297,8	56,8	426,0	48,0
Barna	49,3	8,8	37,0	6,5	37,0	6,2	34,0	6,5	76,8	8,6
Bursa	21,8	4,0	21,8	3,9	18,5	2,8	14,4	2,9	39,0	4,5
Të ndryshme .	20,6	3,8	34,9	6,1	21,9	3,0	25,1	4,7	55,3	6,2
Shuma	559,0	100	570,0	100	594,0	100	524,2	100	887,4	100

Gjer në vitin financiar 1932-33 nuk ka nonjë ndryshim me rëndësi që meriton të komentohet. Kurse buxheti i vitit 1932-33 ndryshon nga të tjerët jo vetëm në sumën e përgjithëshme por edhe në mënyrën se si është ndarë. Duke çkëputur nga pasqyra e sipërme dy vitet e fundit do të shohim se:

	ROGË	SPITALE	BARNA	BURSA	Të ndrysh
	(në % të buxhetit)				
më 1931-32 janë harxhuar	21,9	56,8	6,5	2,9	4,7
» 1932-33 » »	32,7	48,0	8,6	4,5	6,2

Suma në cifra absolute e harxhuar për spitale etj. më 1932-33 është shtuar 43% në barazim me vitin e mëparshëm; po n'atë kohë suma e harxhuar për rrogë personali është shtuar 89%. Nga ana tjetër suma e harxhuar për mbajtjen e spitaleve etj. instituteve shëndetësore më 1931-32 kapte 56,8% të gjithë buxhetit, kurse më 1932-33 zbret më 48,0%; gjith'ashtu rrog'e personalit nga 29,1% më 1931-32 hipën në 32,7% më 1932-33. Gjith'ashtu është shtuar edhe përqindja relative e rubrikave të tjera. Me një fjalë, pakësimi prej 8,8% në kapitullin e spitaleve është kompensuar me shtimin e rubrikave të tjera: rrogë personali: 3,6%, barna: 2,1%, bursa: 1,6, të ndryshme: 1,5%.

Tabela Nr. 12 na jep në një formë skematike ndarjen e buxhetit pas kapitujve që caktuam më sipër, domethënë: rrogë personali, mbajtj'e spitaleve e dispanserive, blerje barnash, bursa specializimi. Për të simplifikuar punën, rubrikën «të ndryshme» nuk e futmë në këtë tabelë.

II. — ORGANIZIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËNDETËSISË

Veprimet e Drejtoris s'onë shvillohen duke u bazuar në katër lloje organesh: spitale, dispanseri, ambulanca dhe mjekë shetitës. Spitalet dhe dispanseritë sot-për-sot ndodhen në qendrat e prefekturave më shumë; ambulancat, ku mjekimi i të sëmurëve bëhet më këmbë, ndodhen pranë bashkive, spitaleve dhe dispanserive; fundi, mjekët shetitës janë lidhur me komunet dhe shetisin katund më katund.

Sot për sot spitale kemi në këta qytete: Tiranë (200 shtretë), Vlorë (50 shtretë), Korçë (50 shtretë), Shkodër (50 shtretë), Gjinokastër (30 shtretën).

Ngrehja e spitalit Zog i I. në kryeqytet ka çelur posibilitete të rá për të shvilluar aktivitetin e Drejtorisë s'onë. Ndërtuar në vëndin më të bukur të Tiranës, në këmbën e Dajtit madhështor, rethuar me kodra të gjelbëryera dhe me një atmosferë të pastër e të kulluar ku natyrës i qesh buza dhe i sëmuri ndien një rahatí në shpirt vetëm duke marrë frymë, spitali Zog i I. me dipendencat e tij po bëhet një qendër udhëheqëse për shëndetësin'e tërë Shqipërisë.

Në kohra normale spitali i kryeqytetit përmban 200 shtretë, por në rast shtërngese munt të vendosen gjer më 300 të sëmurë. Spitali është'i ndarë në 5 pavilione. Prej tyre 2 janë për kirurgji, gjinekollogji dhe maternite, një sekcion për oto-rino-larinkologji. Dy pavilione janë për sëmundje të brëndëshme (1 për gra, 1 për burra) dhe 1 pavilion për sëmundje venerike. Për dermatologjí ka një sallë të veçantë, gjith'ashtu dhe për oftalmologjí. Çdo pavilion përmban 2 salla nga 20 shtretën. Përveç pavilioneve spitali ka dhe oda të veçanta për të sëmurë me pagesë, 20 oda të veçanta janë të klasit të 1-rë dhe 20 oda të kl. të 2-të. Çdo kategori sëmundjesh, domethënë çdo pavilion ka dhe një ambulancë ku vin'e shikohen të sëmurë t'asaj kategorie.

Spitali Zog i I. ësht'i pajosur me instalimet më moderne, me dy salla operacionesh (aseptike dhe septike) të ndërtuara me kujdesjen më të madhe dhe pas regullave të shkencës moderne, në mënyrë që të sigurohen shanset teknike më të mbëdha për suksesin e operacioneve.

Spitali ka brenda edhe një barnatore të plotësuar me gjithë mjetet e nevojshme.

Pavilionet janë radhitur paralel njëri me tjetrin, dhe janë lidhur në mes të tyre me një galëri të mbuluar, e cila, me një gjatësí 100 metrash, i jep spitalit një pamje madhështore.

TABELA Nr. 12

Buxheti i Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësisë për vitet 1928-32



BKSH

Brënda në spitalin Zog i I. ësht' instaluar dhe Instituti Roentgen. Ky Institut përbëhet prej dy sallash: një sallë radiologjie dhe një sallë elektroterapie. Salla e radiologjisë ka brënda tërë aparaturën e nevojshme për të bërë radiografinë dhe radioskopin' e të gjitha pjesëve të trupit. Në sallën e elektroterapisë janë instaluar të gjitha veglat që sigurojnë përdorjen e rëzëve X, diellit artificial dhe korrentit elektrik (diatermi) në mjekimin e sëmundjeve të ndryshme ku përdorja e këtyre methodave të mbaruara ka dhënë rezultate të kënaqëshme.

Aktiviteti i Institutit Roentgen, i cili përfshin jo vetëm Tiranën por edhe tërë Shqipërinë, përmblidhet në këto cifra:

	Radiografi e radioskopi	Elektroterapi
1929	620	90
1930	1079	265
1931	1425	245
1932	—	—

Karshi Spitalit Zog i I. po ndërtohen Instituti Bakteriologjik e Shimik, i cili është në mbarim e sipër. Ky institut më tutje do të transformohet në qendër higjenike dyke patur pranë seksionet përkatëse.

Instituti bakteriologjik sot-për-sot qëndron në një ndërtesë me qirá në të cilën kryen edhe shërbimin antirabik.

Vepërimet e laboratuarit bakteriologjik që kemi sot-për-sot përmblidhen në pasqyrën që vijon:

	1927	1928	1929	1930	1931
Analiza të ndryshme	826	503	776	1177	1068
Vaksinac. antirabike	73	70	44	46	106
» anti. T. B. C.	—	—	54	37	6

Në Korçë spitali hë për hë ndodhet në një ndërtesë të ré të marrë me qirá. Kjo gjindje do të mos vazhdojë shumë kohë. Z. Thoma Turtulli po i dhuron qytetit të Korçës një spital të ri. Ngrehja e këtij spitali ka filluar dhe po vazhdon me hapa të shpejta. Me transferimin në ndërtesën e ré, spitali i Korçës do të jetë më i ujdisuri pas atij të kryeqytetit.

Në Vlorë spitali është në një vënt mjaft të bukur, lark nga qyteti dhe i rrethuar me drurë gjith farësh q' i japin ambientit një bukuri të këndëshme dhe atmosferës një pastërtí shumë të dobishme për të sëmurët.

Deri në vitin 1929 dispanserí kemi patur në këta qytete: Gjinokastër, me 10 shtretë, Berat, me 15 shtretë, Elbasan, me 15 shtretë. Po n' atë kohë në Përmet kish një spital të Bashkisë me 18 shtretë, të subvencionuar prej Drejtorisë s' onë. Më 1929 filloi të funksionojë regullisht dispanseria e Kurveleshit (me 10 shtretë), dispanseria e prefekturës së Dibrës (me 10 shtretë). Fundi me 1932 u çel një spital me 15 shtretë në këthizën e Myzeqesë, në Ardenicë, për të lëftuar me sistem kundër malaries dhe sifilizit.

Ambulanca për mjekime me këmbë ka pranë dispanserive dhe pranë Bashkive. Në qytetet ku ka një spital ose dispanserí ka nga dy ambulanca: një e spitalit ose dispanserisë dhe një e Bashkisë. Vëndet ku ka vetëm nga një ambulancë Bashkie janë këto: Durrësi, Kavaja, Shiaku, Kruja, Bilishti, Kolonja, Pogradeci, Delvina, Saranda, Lushnja, Fieri dhe Peqini. Shërbimi nër ambulancat e Bashkive sigurohet prej mjekut të Bashkisë.

Institut' i mjekëve shetitës u krijua më 1932 pas ardhjes në detyrë të Drejtorit Përgjithshëm t' onë të tanishmë. Sikundër e tregon dhe titull' i tyre, mjekët shetitës kanë për detyrë të vizitojnë katundet së paku dy javë në muaj. Në çdo katund që venë mjekët shetitës ekzaminojnë pik së parë djemt' e shkollave dhe ndajnë ata që kanë nevojnë për mjekime. Pastaj, duke u pështetur mbi kallzimet e plakut të katundit, vizitojnë të sëmurët e vëndit, dhe ata që vuajnë nga sëmundje ngjitëse dhe kanë nevojë për mjekime të gjata i drejtojnë në qendrën më të afërme ku ka një spital ose dispanserí. Në rast se një i sëmurë nga sifilisi nuk pranon të vejë atje ku dërgohet mjeku shetitës ka të drejtë t' a detyrojë të shkojë me anë të gjandarmërisë. Për të sëmurët lehtë mjeku ka me vehte barna, të cilat u a ndan gratis. Pa dyshim ilaçi i parë dhe më me rëndësí është kininua.

Mjekë shetitës kemi në këto qarke: Vlorë Himarë, Kurvelesh, Gramsh, Shpat, Malësi e Elbasanit, Pukë, Mirditë, Kosovë (në Kukës) e Malësi e Madhe.

Në disa vende si: Konispol, Tepelenë, Skrapar, Mallakastër, Mat, Zergjan, Lesh dhe Frashër shërbimi sanitar sigurohet nga një mjek qeveritar.

Fundi, në Roskovec, Këlcyrë, Libohovë, Leskovik kemi nga një mjek komunal.

Nga organet shëndetësorë të specializuar,

në radhë të parë vinë degët e Sekcionit Antimalarik nëpër qarket. Të tilla degë deri në funt të 1932-së kemi çelur në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan. Në fillim të vitit 1933 të tilla degë u krijuan dhe në Vlorë e në Berat. Degët e Sekcionit Antimalarik kanë nga një mjek të specializuar në Romë me mjetet e Fondacionit Rockefeller. Për mbajtjen e degëve antimalarike nëpër qarket gjysma e spenximeve sigurohet prej Fond. Rockefeller dhe gjysma prej Bashkís së vëndit. Degët e qarkeve sikundër dhe Sekcioni Antimalarik i qendrës janë nënë udhëheqjen e Drejtorís së Përgjithëshme të Shëndetsisë. Mbi aktivitetin e këtij Sekcioni do të flasim në kapitullin e veçantë «*Lufta kundër malaries*».

Në kategorin' e instituteve shëndetësore të specializuar hyjnë dhe dy ambulancat për foshnja që kemi në Tiranë e në Shkodër.

Qëllimi i ambulancave foshnjore është të mjekojnë fëmijët e vobektë deri në moshën a loleshente, që vuajnë nga çfarëdo sëmundje. Aktiviteti i ambulancës foshnjore të Tiranës shtrihet jo vetëm mbi fëmijët e qytetit por edhe të qarkut dhe të Malësive reth' e rotull. Për foshnjat që, për çdo shkak qoftë, nuk munt t' ushqehen me qumështin e mëmës së tyre, ambulanca ndan qumësht (gratis për të vobektët) në sasinë dhe kompozitën' e duhur pas moshës së foshnjës. Ambulanca përpiqet me çdo mjet të përhapë në popull regullat e higjienës moderne për ritjen e foshnjave. Kjo pikë është' esenciale me që sot për sot prindërit kujtohen të sjellin në ambulancë foshnjat që vuajnë nga nonjë sëmundje në një kohë kur sëmundja ka përparuar aqë tepër sa që shumë herë mjekim' i tyre është' i pamundshëm.

Fëmijëve që sillen në ambulancë u bëhet një ekzaminim i plotë: analiz' e gjakut me ndihmën e Laboratuarit bakteriologjik, shikimi në Roentgen etj. Foshnjat që kanë nevojë për një kurë të gjatë (sifilis hereditar etj.), e cila nuk munt të vazhdohet n' ambulancë as në banesën private, dërgohen në spital.

Për çdo foshnjë q' ekzaminohet n' ambulancë mbahen shënime të plota mbi gjendjen e tij shëndetësore. Me materialin e mbledhur kësisoj bëhet një statistik' e përmuajshme. Kjo statistikë ka filluar të mbahet me regull me hyrjen në shërbim të mjekut të tanishmë (tetor 1932). Sëmundjet që konstatohen më shpesh nër foshnjat e Tiranës dhe të qarkut janë: malaria, në të gjitha format e saj; distrofia, e cila rjeth nga ritja dhe ushqimi të keq; ekzema, zgjebja dhe të tjera sëmundje lëkure, që shkaktohen nga moskujdesja dhe mosdisja në ritjen e fëmijëve.

Personali i ambulancës foshnjore të Tiranës është' i përbërë prej: mjekut, drejtoreshës së shkollës s' infermierave, 2 infermiera për pregatitjen e qumështit, 1 infermiere që regjistron të sëmurët dhe 1 infermiere-ndihmëse e mjekut.

Kemi në projekt ndarjen e ambulancës foshnjore në dy degë: dega kurative nënë drejtimin e një mjeku pediatrë dhe dega profilaktike nën drejtimin e një mjeku higjienist. Gjith' ashtu për së shpejti shpresojmë t' a kompletojmë ambulancën me një laboratuar të vogël.

Qëllimi kryesor që duhet të realizojmë është të përhapim në popull rregullat e higjienës në ritjen e fëmijës, se andej varet shtim' i popullsisë dhe, në një masë të gjerë, forcim' i shëndetit të saj.

Për pregatitjen e personelit medikal që është kondita e domosdoshme që të munt të zgjerojmë aktivitetin t' onë, sot për sot, edhe për shumë kohë akoma, do të jemi të shtërnguar të dërgojmë njerëz të studiojnë përjashta. Por me që pasja e infirmiereve të stërvitura lot një rol shumë të math në suksesin e vepërimit të mjekëve, dhe pregatitja e tyre përjashta do të na kushtonte shumë shtrenjtë, me shumë sakrifica e mundime mundëm të krijojmë një shkollë infirmierash në Tiranë. Kjo shkollë, e drejtuar prej dy mësonjëseve frënge, ka 18 nxënëse me mësime fillore. Në shkollën mësimet vazhdojnë tre vjet; nxënëset infirmiere gjysmën e kohës praktikohen nëpër spitalet.

Rieta e instituteve shëndetësore që kemi sot për sot është përfytyruar në një formë të dukëshme në kartën Nr. 2.

Në projekt kemi: një sanatorium në Voskopojë, për të cilin vëndi u zgjoth dhe plani është gati, një pavilion për tuberkulozë me me 60 shtretë pranë spitalit Zog i I.; themelimin e një instituti për higjienë sociale në çdo prefekturë, duke filluar më parë nga qendra, kanalizimin e lumit të Tiranës e të tjera vepra kësodore për të lëftuar kundër malaries.

Për pregatitjen e personelit të aftë kemi 5 doktorë të diplomuar që po specializohen në degë të ndryshme, 17 studentë bursistë për medicinë dhe 2 vajza që studiojnë për mami dhe infirmiere-vizitonjëse.

MËSUESET DHE NJË PJESË E NXËNËSVET TË SHKOLLËS S' INFERMIERAVE

AMBULANCA FOSHNJORE NË KOHËN E KONSULTACIONIT


KARTA E INSTITUTEVE SHËNDETËSORE.
LEGENDË.
Spital
Dispanseri
Ambulancë
Çmëndinë
Amb. Foshnj.
St. Antimalarik
Mjek Shetitës
Mjek Bashkije
Mjek Komunal
Mjek Qeveritar
TROPOJË
KOPLIK
SHKODRË
PUKË
KUKËS
LESH
BURREL
KRUJË
SHIJAK
DURRËS
TIRANË
KAVAJË
LIBRAZHD
ELBASAN
PEQIN
LUSHNJË
LIBOFSH
FJER
RESKOVEC
GRAMSH
BERAT
BILISHT
BALLSH
VLORË
TEPELLNË
DUKAT
HIMARË
GJINOKASTRË
SARANDË
KONISPOL
DETI ADRIATIK

III. — AKTIVITETI I INSTITUTEVE SHËNDETËSORE NË PERIUDEN 1927-1932

Numri i përgjithëshmë i të mjekuarve nëpër spitale, dispanserí e ambulanca arrin për çdo vit në periudën që kemi parasysh cifrat e posht-shënuara:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
70309	57060	63725	67279	66431	81127

Nga kjo pasqyrë munt të konstatohet se më 1932 numri i të mjekuarve është shtuar 25% në krahasim me vitin e mëparshëm. Ky shtim nuk rjeth nga keqësimi i gjendjes shëndetësore të popullit por nga zgjerimi i fushës s' aktivitetit të instituteve sanitare, në lidhje

TABELA Nr. 13

Numr' i përgjithëshmë i të mjekuarve në vitet 1927-32



BKSH

me shtimin e buxhetit që pamë më sipër. Po të këqyrim në detajë statistikat e qarkeve për vitin 1932 do të shohim një epidemí fruthi mjaft të përhapur, por pa dëme serioze. Pa dyshim kjo epidemi sikundër edhe të sëmurët nga gripi do të kenë influencuar gjer më një farë pike çifrën e sipërme, por jo gjer m' até shkallë sa që të ndryshojnë tendencën e përgjithëshme që theksuam më sipër.

Këto cifra, që përfytyrohen më një mënyrë më të dukëshme në tabelën Nr. 13, na tregojnë vetëm si është shvilluar aktiviteti i organeve të shëndetësisë në vitet që kemi parasysh, por nuk munt të na japin një idhé të saktë mbi sasinë ekzakte t' atyreve që sëmuren brënda një viti. Kjo do të munt të bëhet kur të kemi kompletuar kuadret e mjekëve shetitës në mënyrë që të mos mbetet katund pa u vizituar. Paralelisht me këtë popullit do t' i shtohet besimi te medicina, besim që po

TABELA Nr. 14

Të mjekuarit në tërë Shqipërinë në periudën 1927-32 të kategorizuar pas llojit të sëmundjes



përhapet me shpejtësí të madhe që sot, kështu që do të mos mbetet i sëmurë as më një kënd të Shqipërisë që të mos i drejtohet mjekut. Nga ana tjatër do të sigurojmë që mjekët privatë nëpër qytetet t'u komunikojnë regullisht organeve të shëndetësisë statistikën e të sëmurëve që kanë vizituar brënda një viti.

Për tri sëmundjet endemike — malarie, sifilis, tuberkuloz, që ndeshen më shpesh në vëndin t'onë — kemi mbajtur lista të veçanta. Në bazë të këtyre listave kemi pregatitur tabelën Nr. 14 ku shtylla e tërë tregon numrin e përgjithëshmë e të mjekuarve, pastaj vinë duke filluar nga lart: të sëmurët nga tuberkuloza, sifilisi, malaria dhe sëmundje të ndryshme. Në rezervat që bëmë më lart theksuam se cifrat e të mjekuarve nuk na japin një idhé të saktë mbi numrin e përgjithëshmë t'atyreve që sëmuren brënda një viti, por mbi rëndësinë relative të çdo sëmundjeve dhe sidomos mbi evolucionin e saj nga viti në vit munt të nxjerim konkluzie fare të sakta nga numri i të mjekuarve nëpër spitale dhe ambulanca. Kur shohim se numri i përgjithëshmë i të mjekuarve shtohet kurse përqindja e të sëmurëve nga malaria paksohet, kjo domethënë se malaria po lëftohet me sukses. Po të marrim numrin e të mjekuarve në çdo vit për 100, do të kemi përqindjet që vijojnë për sëmundjet që kemi veçuar:

PASQYRA E RËNDËSISË RELATIVE TË SËMUNDJEVE ENDEMIKE

EMR'I SËMUNDJES	1927 %	1928 %	1929 %	1930 %	1931 %	1932 %
Malarie . . .	42	41	40,5	33	31,8	34,3
Sifilis	2,8	2,3	2,3	1,8	1,5	1,5
Tuberkulozë . .	1,5	2,0	1,5	1,3	1,3	1,2
Sëmundje të tjera	53,7	54,7	55,7	63,9	65,4	63,0
Shuma	100	100	100	100	100	100

Këtu pakësimi i malarjes bie në sy: përqindja e malarikëve zbret nga 42 gjer më 34,3. Ky pakësim bëhet regullisht nga viti në vit. Vetëm nga '31-a me '32 kemi një shtim prej 2,5%, i cili është në lidhje me epidemin'e gripit që patmë vjet dhe, në disa qarke, me keqësimin e jashtëzakonshëm të konditave atmosferike. Sido qoftë pasqyra e përgjithëshme nuk ndryshohet, pakësimi i malarjes është një fakt i pamohuarshëm.

Kjo vërtetohet edhe me cifrën absolute të malarikëve që janë mjekuar, cifër që vete duke u pakësuar nga viti në vit, sikundër shihet në pasqyrën që vijon:

NUMRI I TË MJEKUARVE MALARIKË

1927	1928	1929	1930	1931	1932
29656	23443	25863	22209	21145	27881

Në pasqyrën e faqes 32 pamë se numr'i përgjithëshmë i të mjekuarve më 1932 në krahasim me vitin 1931 është shtuar 22%. Këtu shohim se po n'atë kohë numr'i përgjithësh. më i malarikëve të mjekuar është shtuar 31%. Domethënë se të mjekuarit malarikë janë shtuar 9% më tepër se të mjekuarit nga sëmundjet e tjera. Shtimin e të mjekuarve për-

gjithërisht e shpieguam me zgjerimin e aktivitetit t'organeve shëndetësore nëpër qarket. Për sa i përket malarjes shtim'i të mjekuarve në vitin 1932 shpjegohet pjesërisht me zgjerimin e luftës antimalarike dhe pjesërisht rjeth nga disa shkake të përkohëshme si epidemí e gripit etj.

Në periudën që kemi parasysh numr'i sifilitikëve të mjekuar ka qënë:

NUMRI I TË MJEKUARVE SIFILITIKË					
1927	1928	1929	1930	1931	1932
1969	1345	1495	1208	1048	1233

Edhe këtu shohim një pakësim pak a shumë të rregullshëm gjer më 1931. Më 1932 kemi një shtim prej 17% domethënë 5% më pakë nga sa është shtuar numr'i përgjithëshmë i të mjekuarve.

Edhe tuberkuloza na paraqet një pasqyrë pothuaj identike.

NUMRI I TË MJEKUARVE QË VUANIN NGA TUBERKULOZI					
1927	1928	1929	1930	1931	1932
1078	1223	949	910	899	965

Shtim'i të mjekuarve tuberkulozë më 1932 është vetëm 7%, domethënë se numri i të mjekuarve nga kjo sëmundje është shtuar shumë më pakë se numri i përgjithëshmë i të mjekuarve. Vetëm duhet të kemi parasysh këtë që diagnoza e tuberkulozës pa patur veglat e nevojshme, si aparat Roentgen-i etj., është shumë vështirë që të bëhet me sigurí të plotë. Prandaj shumë herë qëllon që midis atyre që kanë ethe periodike dhe për këtë arësye futen në kategorin'e malarikëve, munt të ketë të sëmurë që kanë lezione në mushkëritë dhe ethja atëhere ka origjinë tuberkuloze. Gjith'ashtu munt të ngjasë që malarja të jetë përzierë me tuberkulozë. Kështu që cifrat mbi tuberkulozën nuk munt të na japin kursesi një idhé të saktë mbi përhapjen e kësaj sëmundjeje. Këtë do t'a shohim më mirë kur të studiojmë prefekturat veç e veç.

Në diagramën Nr. 2 evolucioni i sëmundjeve që analizuam më sipër duket më një mënyrë më goditëse.

IV. — TË SËMURËT E SHTRUAR NËPËR SPITALE E DISPANSERI

Sikundër e shënuam edhe në parathënien, në këtë statistikë nuk do të vëmë listën e të shtruarve për mjekim nëpër spitale e dispanserí, duke i ndarë në kategorí. Ndarja e pazientëve në kategorí pas sëmundjeve nga të cilat vuajnë, munt të jetë e dobishme vetëm për disa sëmundje karakteristike si malarja, tuberkuloza etj. Këtë gjë nê e bëmë më sipër për sa i përket tërë Shqipërisë, më poshtë do t'a bëjmë edhe për çdo prefekturë veçanërisht. Këtu do të kufizohemi duke sjellë numrin e përgjithëshmë e të shtruarve për mjekim nëpër spitale e dispanserí në çdo vit, numrin e t'operuarve, numrin e të shëruarve dhe numrin e të vdekurve.

Këto të gjitha figurojnë në pasqyrën që vijon:

TË MJEKUARIT NË SPITALE E DISPANSERI NË PERIUDËN 1927–32

VITI	SHTRUAR	OPERUAR	SHËRUAR	VDEKUR
1927	4884 100%	585 13%	3417 80%	238 5%
1928	4351 100%	615 14%	3410 80%	262 6%
1929	4637 100%	543 11,7%	3760 81%	309 6,6%
1930	4409 100%	648 14,7%	3608 80,8%	266 6%
1931	4554 100%	629 13,8%	3487 76%	284 6%
1932	5400 100%	648 14,4%	3608 68,4%	266 6,8%

Nënë çdo cifër absolute kemi vënë edhe përqindjen. Me këtë mënyrë caktojmë sa për qint janë operuar, sa për qint shëruar e sa për qint kanë vdekur. Kështu po të marrim për 100 numrin e të shtruarve nëpër spitale e dispanseri më 1927, do të gjejmë se prej tyre 13 për qint janë operuar, 80 për qint janë shëruar dhe 5 për qint kanë vdekur. Suma e këtyre përqindjeve na jep 98; 2 për qindat që nuk figurojnë n'asnjërën nga këto rubrika janë ata të sëmurë që mbeten për vitin tjetër. Më 1930 shuma e përqindjeve na jep 101,5. Kjo domethënë se n'atë vit përveç 4409 të sëmurëve të rinj që janë pranuar për herë të parë, kishin mbetur 66 të sëmurë nga vit'i mëparshëm.

Gjer më 1931 nuk ka nonjë ndryshim që meriton të shënohet Kurse më 1932 numr'i të shtruarve arrin 5400 veta, domethënë 846 veta — 18,4% — më tepër. Kjo shtesë në lidhje me çeljen e spitalit Zog i I. Më 1931 në spitalin e Tiranës ishin shtruar 1231 të sëmurë kurse me 1932 kjo sumë arrin cifrën 1951 domethënë 720 më tepër. Kështu që pjesa m'e madhe (ekzaktërisht 85%) e shtesës që konstatojmë më 1932 vete për hesap të spitalit të Tiranës. Po të mbledhim përqindjet e të shëruarve, operuarve dhe të vdekurve më 1932 do të gjejmë gjithsej 89,6. Gjer më 100 mbeten 10,4 të qinta, domethënë 561 të sëmurë, të cilët mbeten për vitin 1933.

Në cifrat e përgjithëshme që sqyrtuam më lart hyjnë dhe të mjekuarit më këmbë nëpër ambulancat e spitaleve dhe të bashkive. Një pik'e interesatshme që meriton të kiarohet është mënyra se si ndahen sëmundjet endemike midis të mjekuarve nëpër ambulanca dhe të shtruarve për mjekim nëpër spitale e dispanserí. Po të marrim për 100 cifrën mesatare e të mjekuarve nëpër spitale e ambulanca në sicilindo nga vitet 1927—32 do të të kemi këto përqindje për sëmundjet endemike:

NUMR'I PËRGJITHËSHMË I TË MJEKUARVE	PREJ TYRE			
	Malarikë	Sifilitikë	Tuberkulozë	Sëm. të tjera
100	38,8%	2,2%	1,4%	57,6%

Kurse kategorizimi i të sëmurëve shtruar nëpër spitale e dispanseri pas këtyre kritereve na jep cifrat që vijojnë:

NUMRI I TË MJEKUARVE NËPËR SPITALE E DISPANSERI	PREJ TYRE			
	Malarikë	Sifilitikë	Tuberkulozë	Sëm. të tjera
100	27%	3,5%	2,3%	67,2%

Krahasimi i këtyre dy pasqyrave na tregon se midis të sëmurëve që mjekohen nëpër ambulancat dhe prej mjekëve shetitës malarikët arrijnë 38,8% kurse midis të sëmurëve që shtrohen nëpër spitale e dispanseri malarikët kapin 27%. Ky ndryshim mjaft i math ka dy arësye. E par' e punës malaria është m' e përhapur nëpër katundet, e dyta populli i katundeve u mësua të vejë të shikohet te mjeku kur vuan nga malaria, me që reth kësaj sëmundjeje u bë një buje mjaft e madhe. Pastaj malaria është një sëmundje që i lé arallëk të sëmurit të vejë vetë në ambulancë. Kurse sëmundjet e tjera q' e detyrojnë të sëmurin të rijë rënë gjithmonë dhe lypin një mjekim të gjatë s' kanë se si shërohen nëpër ambulanca. Fundi populli i katundeve nuk është stervitur aqë sa të vejë të shihet ne doktori për çdo semundje q' i bie mbi kokë, sidomos kur i sëmuri është femër. Përkundrazi në qytetet, ku janë spitalet e dispanseritë, malarie ka më pakë dhe populli m' i përparuar vete ne mjeku më shpesh dhe për çdo sëmundje që t' i bjerë. Gjith' ashtu shohim një ndryshim për sa i përket sifilizit dhe tuberkulozës. Në spitalet e dispanseritë përqindja e të sëmurëve nga sifilizi dhe tuberkuloza është m' e lartë. Shpiegim' i këtij fakti është që në qytetet kë. to dy sëmundje janë më të përhapura.

V. — ÇMËNDINA

Vepërimet e çmëndinës në Vlorë përmblidhen në cifrat që vijojnë:

VITI	PRANUAR	SHËRUAR	VDEKUR	MBETUR PËR VITIN TJETËR
1927	55	9	—	36
1928	62	—	3	46
1929	69	1	13	45
1930	71	5	3	50
1931	94	1	9	61
1932	115	4	7	81

Edhe këtu shohim një progresion në numrin e të sëmurëve që pranohen në çmëndinë. Ky progresion vete duke u shtuar nga viti në vit. Kjo duket më qartë në pasqyrën që vijon. Atje tregohet shtimi në përqindje i të sëmurëve duke marrë numrin e vitit të mëparshëm për 100.

1927	1928	1929	1930	1931	1932
100	+12%	+11%	+3%	+31%	+22%

Fundi nga 1927-a gjer më 1932 numri i të sëmurëve është shtuar 100 e ca për 100. Nuk munt të themi me siguri në ky shtim vjen nga shtimi efektiv i të sëmurëve në vënt apo nga shtim' i besimit në popull mbi dobín'e çmendinës për të sëmurin që gjer die rinte në mes të families duke qënë shumë herë dhe i rezikshëm për 'të.

VI. — VEPRIMET E SHËNDETËSISË NËPËR PREFEKTURAT

1. - Prefektura e Shkodrës

Duke studiuar lëvizjen demografike pamë se në Shqipërinë t' onë të vogël ka ndryshime të mbëdha midis qarkeve për sa i përket ndarjes së popullsisë dhe evolucionit të saj. Gjith' ato ndryshime konstatohen edhe në punën të përhapjes së sëmundjeve të ndryshme dhe gjëndjes sanitare përgjithërisht. Prandaj passi dhamë pasqyrën e sëmundjeve në tërë Shqipërinë, tani duhet të zbresim një shkallë më poshtë dhe të studiojmë gjendjen shëndetësore në çdo prefekturë. Kufitë administrative të prefekturave nuk korespondojnë me ato të qarkeve që kanë karakteristika analoge nga pikëpamja shëndetësore. Për shëmbëll prefektur' e Shkodrës ka një pjesë malësie dhe një pjesë fushe, të cilat ndryshojnë fare në mes të tyre nga pikëpamja e masave që duhen marrë për të lëftuar sëmundjet e ndryshme. Por, me qënë se materiali që kemi në dispozicion është mbledhur në bazë të ndarjes në prefektura, né do të ndjekim atë sistem, duke theksuar në çdo rast ndryshimet specifike që munt të ndeshen midis retheve të ndryshmë të çdo prefekture.

Prefekturat do t' i radhitim duke filluar nga ajo që ka mjekuar numrin më të math të sëmurësh. E para vjen prefektura e Shkodrës ku në 6 vjet (1927—32) janë mjekuar:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
12934	12874	11970	11210	8210	8518

Po të marrim cifrën e 1927-ës për 100 do të kemi:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
100	99,6	92,6	87,0	63,2	66,0

Këtu shohim se numri absolut i të mjekuarve vete duke u pakësuar regullisht. Ky pakësim arrin afro 24% më 1931 në krahasim me vitin 1927. Më 1932 në krahasim me vitin e mëparshëm kemi një shtim prej 2,8%. Po të marrim parasysh se shtimi për atë vit në tërë Shqipërinë ka qënë 26%, duhet të konstatojmë se, me gjithë zgjerimin e aktivitetit t' organeve shëndetësore, në prefekturën e Shkodrës numr' i të mjekuarve ka mbetur stacionar. Kjo shpjegohet vetëm po të pronojmë se pakësohet përgjithërisht numr' i të sëmurëve. Kjo konkluzie forcohet po të marrim të mjekuarët për çdo vit e për çdo sëmundje veç e veç. Në pasqyrën që paraqesim më poshtë kemi treguar për çdo vit numrin e përgjithëshmë e të mjekuarve dhe *sa prej tyre* kanë qënë të sëmurë nga malarja, nga sifilizi, nga tuberkuloza dhe sa nga sëmundje të tjera. Përveç kësaj, duke marrë shumën e të mjekuarve në çdo vit për 100, kemi treguar se si ndahet kjo shumë midis sëmundjeve të ndryshme, domethënë, *sa për qint* nga gjithë të mjekuarit në çdo vit kanë qënë malarikë, sa për qint sifilitikë etj.

VEPËRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E SHKODRËS
në periudën 1927-32

VITI	SHUMA e të mjekuarve	PREJ TYRE							
		Malarie	%	Sifilis	%	Tuberkulozë	%	Sëmundje të tjera	%
1927	12934	4640	35,6	131	1,0	204	1,6	7959	61,8
1928	12874	5009	39,0	73	0,5	259	2,0	7433	58,5
1929	11970	5827	48,7	74	0,6	115	0,9	5945	50,2
1930	11210	3622	32,1	60	0,5	166	1,5	7462	65,9
1931	8210	2889	35,2	136	1,6	217	2,6	4968	60,6
1932	8518	2810	33,0	79	0,9	221	2,6	5408	63,5

Po të hedhim një sy mbi pasqyrën e sipërme do të shohim një evolucion t'interatshëm për sa i përket malarjes. Në tre vjetët e parë (1927—29) cifra e malarikëve të mjekuar vjen duke u shtuar dhe kalon nga 35,6% gjer më 48,7% të shumës së përgjithëshme të mjekuarve, pastaj fillon pakësimi dhe më 1932 përqindja e malarikëve të mjekuar zbret gjer më 33. Kështu në periudën e parë, me aktivizimin e luftës kundër malarjes shtohet numri i malarikëve të mjekuar, kurse në periudën e dytë, me gjithë që lufta kundër malarjes forcohet edhe më tepër, ky numur vjen duke u pakësuar si në cifrat absolute ashtu edhe në përqindjet relative me sëmundjet e tjera. Kjo tregon se në prefekturën e Shkodrës malarja vete duke u çprapsur nga viti në vit, dhe me një rithmë më të shpejtë se në tërë Shqipërinë. Prova është që më 1932 numri i përgjithëshmë i të mjekuarve në prefekturën e Shkodrës shtohet 2,8% kurse numri i malarikëve pakësohet 1,8%

Për sa i përket sifilizit, cifrat e sipërme përmbysin një legjendë. Ka qënë po-thua një akciomë për të gjithë né se në Malësít'e Shkodrës sifilizi në formë hereditare është shumë i përhapur. Kjo nuk është'e vërtetë me që përqindja e sifilitikëve që figuron në pasqyrën e sipërme është m'e ulët se përqindja mesatare për tërë Shqipërinë. Pa dyshim cifrat t'ona nuk kapin të gjitha rastet e çdo sëmundjeje, me fjalë të tjera të gjithë sa sëmuren nuk kalojnë nëpër duart e mjekëve t'anë. Por mjekët shetitës që kanë vizituar Malësin'e Madhe katund më katund kanë konstatuar se atje sifilizi nuk është'i përhapur ashtu siç besohet. Bile, siç do t'a shohim më poshtë, ka vise të tjera në Shqipëri ku në bazë të cifrave mbi mjekimet nëpër spitale, ambulanca dhe prej mjekëve shetitës, munt të konstatohet me siguri se sifilizi është m'i përhapur se në Malësín'e Veriut.

Sa për tuberkulozën, duket sikur është m'e përhapur në prefekturën e Shkodrës se sa në disa vise të tjera të Shqipërisë. Përqindja mesatare e përvitëshme e të sëmurëve nga tuberkuloza midis të mjekuarve në tërë Shqipërinë ka qënë 1,4% në periudën 1927—32, kurse në prefekturën e Shkodrës përqindja e të sëmurëve nga tuberkuloza arrin cifrën rumbullake 2%. Me qënë se ky fakt konstatohet edhe në prefekturën e Korçës, shjegimi duhet të jetë ky që në këto dy prefektura diagnoza e të sëmurëve bëhet më me kujdes. Se nuk munt të pranojmë që në këto dy prefektura që kanë klimën më të shëndetëshme dhe nga pikëpamja ekonomike janë në gjendje më të mirë, tuberkuloza të jetë m'e përhapur se në prefekturat e tjera. Po të marrim parasysh se në këto dy prefektura malarja është relativisht më pakë e përhapur, atëhere munt të jetë pjesërisht e vërtetë ajo theorí që thotë se mikrobi i malarjes (hematozoaire) e lëfton mikrobin e tuberkulozës (bacil'i Koch-ut). Kështu që në ato vise ku malarja është shum'e përhapur tuberkuloza ndeshet më rallë, sikundër munt të konstatohet duke krahasuar statistikat e Korçës me ato të Beratit.

Sëmundjet ngjitëse që çfaqen më shpesh në prefekturën e Shkodrës janë fruthi dhe tifua, si kundër duket nga pasqyra që vijon:

VITI	ROUGEOLE	FIEVRE TYPHOIDE	DIPHTERIE	TYPHUS
1927	19	13	—	—
1928	1	2	—	—
1929	25	8	—	—
1930	118	33	5	—
1931	35	24	2	—
1932	459	12	3	9

Për fat të mirë këto sëmundje epidemike nuk kanë një karakter tepër të rezikshëm dhe vdekjet që shkaktohen prej tyre janë mjaft të ralla. Kështu për shëmbëll më 1932 ka pasur nëntë vdekje nga fruthi dhe tri nga tifua.

Edhe një pikë e interesatshme për t'u studiuar është mënyra se si ndahet numr'i të mjekuarve midis qytetit të Shkodrës dhe qarkut

t'asaj prefekture. Pasqyra që shtrojmë më poshtë e tregon këtë ndarje. Për të lehtësuar punën kemi marrë cifrën mesatare e të mje kuarve për çdo vit në periudën 1927—32; gjith' ashtu dhe për sëmundjet endemike.

TË MJEKUARIT NË QYTETIN DHE PREFEKTURËN E SHKODRËS

VËNDI	NUMRI MESATAR I TË MJEKUARVE NË ÇDO VIT	PREJ TYRE			
		Malarie	Sifilis	TBC.	Sëmundje të tjera
Prefektura e Shkodrës	10953	4133	92	197	6533
Qyteti i Shkodrës . .	8697	3070	83	159	5385

Po të marrim për 100 cifrat e prefekturës do të gjejmë.

VËNDI	N-ri MESATAR I TË MJEKUARVE	PREJ TYRE			
		Malarie	Sifilis	TBC.	Sëmundje të tjera
Prefektura e Shkodrës	100	100	100	100	100
Qyteti i Shkodrës . .	80	70	90	80	82

Këtu dy sende janë për të vënë ré. E par' e punës të sëmurët nga malaria janë më të pakë në qytetin e Shkodrës se sa në qarkun e prefekturës. E dyta, dhe ajo që ka më tepër rëndësí, është që qyteti i Shkodrës, i cili ka 19,0% të popullsís' së prefekturës ka 80% të të sëmurëve. Kjo nuk do me thënë se këta të sëmurë janë të gjithë nga banorët e qytetit. Me qënë se në Shkodër ndodhen institutet shëndetësore të gjithë prefekturës, aty vinë e shikohen edhe populli i katundeve. Këtej rjeth vetiu detyra jonë për të arthmen: të zgjerojmë rjetën e organeve t' onë vepëronjës duke krijuar së paku një dispanseri në çdo komunë.

2. - Prefektura e Beratit

Prefektura e Beratit vjen e dyta nga numri i të mjekuarve, sikundër duket nga pasqyra që vijon:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
9440	5779	7327	10513	9235	12715

Po të marrim për 100 të mjekuarit e vitit 1927 do të kemi:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
100	61,1	77,6	111,3	98,0	135,5

Pika karakteristike këtu është shtim'i të mjekuarve, gjë që është në lidhje me zgjerimin e aktivitetit të instituteve shëndetësore përgjithërisht. Kjo duket më mirë po të marrim çdo sëmundje veç e veç, sikundër e kemi bërë në pasqyrën që vijon:

VEPËRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E BERATIT

VITI	SHUMA e të mjekuarve	PREJ TYRE							
		Malarie	%	Sifilis	%	TBC.	%	Sëmundje të tjera	%
1927	9440	6148	65,1	116	1,2	100	1,0	3076	32,7
1928	5779	2499	43,0	60	1,0	88	1,5	3132	54,5
1929	7327	3656	49,5	47	0,6	88	1,2	3536	48,7
1930	10513	4683	44,6	60	0,6	130	1,2	5640	53,6
1931	9235	4149	45,0	45	0,5	114	1,2	4927	53,3
1932	12715	5594	44,0	67	0,5	69	0,5	6980	55,0

Tendenca që shënuam më sipër përsëritet pik për pikë me numrin e malarikëve të mjekuar. Kështu nga viti 1931 më 1932 si numr'i përgjithëshmë i të mjekuarve ashtu dhe ay i malarikëve të mjekuar është shtuar 37%. Përgjithërisht duhet vënë ré se prefektura e Beratit ka një përqindje malarikësh mjaft të lartë. Kështu, kurse përqindja mesatare e të mjekuarve malarikë ka qënë në periudën 1927—32 për tërë Shqipërinë 37,1%, në prefekturën e Beratit kjo cifër arrin 48,5%; domethënë se nga gjithë të sëmurët që janë mjekuar në prefekturën e Beratit në këto 6 vjet, 48,5% kanë qënë malarikë, kurse në tërë Shqiperinë malarikë ka pasur vetëm 37,1%. Si kundër numri i përgjithëshmë i të mjekuarve ashtu dhe numri i malarikëve vete duke u shtuar. Kjo do me thënë se në prefekturën e Beratit, për sa i përket luftës kundër malarjes, jemi akoma në periudën e kinizimit sistematik për të ndaluar hovin e sëmundjes në formë kronike.

Për sa i përket sifilizit përqindja mesatare e të mjekuarve nga kjo sëmundje në pref. e Beratit është mjaft m'e ulët se në tërë Shqipërinë. Në pref. e Beratit kemi 0,7% sifilitike kurse në tërë Shqipërinë cifra mesatare është 2%. Këtej rjeth se në pref. e Beratit sifilizi nuk ka një përhapje në masë të rezikëshme për shëndetin e popullsís s'atij qarku.

Edhe cifrat e të sëmurëve nga tuberkuloza nuk kanë një karakter alarmonjës. Kështu për tërë Shqipërinë kemi të mjekuar tuberkulozë 2,5%, dhe për pref. e Beratit 1,1%. Vetëm këtu duhet bërë një vërejtje me rëndësí. Përqindja e të mjekuarve nga tuberkuloza nuk do me thënë kursesi përqindja e të sëmurëve efektivisht nga kjo sëmundj'e tmershme. Cifrave që parashtruam më sipër u mungojnë dy sende. E par'e punës të gjithë të sëmurët e prefekturës së Beratit nuk janë ekzaminuar prej mjekëve t'anë; e dyta shumë nga ata që janë parë nëpër ambulancat munt të kenë patur lezione tuberkuloze në stadën e parë, kur zbulim'i tyre është shum'i zorshëm dhe lyp me doemos ekzaminime bakteriologjike dhe sidomos radiografike. Prandaj cifrat që analizuam më sipër duhen marrë me rezervë. Ato na japin një idhé mbi dinamikën e sëmundjeve të ndryshme por jo mbi përhapjen e tyre në cifra absolute.

Hetimet indirekte që kemi bërë në raste të ndryshme na tregojnë se tuberkuloza është m'e përhapur në Shqipërí, nga ç'tregojnë cifrat e përgjithëshme të mjekimeve nëpër ambulanca e spitale.

Nga sëmundjet ngjitëse m'e përhapura në prefekturën e Beratit është fruthi, sikundër duket nga pasqyra që vijon:

VITI	ROUGEOLE	FIEVRE TYPHOIDE E PARATYPHOIDE	DIPHTERIE	SCARLATINE
1927 . . .	160	21	—	—
1928 . .	37	2	—	—
1929 . . .	42	1	2	—
1930 . . .	9	15	—	1
1931 . . .	154	18	1	1
1932 . . .	1051	31	—	20

Fruthi jo vetëm arrin cifra që s'i ka as një prefekturë tjetër por merr edhe forma të rezikëshme. Epidemia e fruthit ka qënë m'e ashpër më 1932 ku janë konstatuar 53 raste vdekjeje nga kjo sëmundje. Kurse nga tifua kemi 3 vdekje më 1931 dhe 3 më 1932.

Roli i qytetit të Beratit në aktivitetin e organeve të Shëndetësisë publike nuk është në proporcion me popullsín'e qytetit në krahasim me atë të prefekturës. Me fjalë të tjera përsëritet ajo që pamë në Shkodër.

Mënyra se si janë ndarë të sëmurët e mjekuar nëpër spitale, dispanserí e ambulanca, ndërmjet qytetit dhe prefekturës së Beratit duket në pasqyrën që vijon. Për të simplikuar punën kemi marrë cifrën mesatare e të mjekuarve në çdo vit si në qytetin ashtu dhe në tërë prefekturën, domethënë shumën e të mjekuarve në 6 vjet (1927-32) e kemi ndarë më 6:

TË MJEKUARIT PËR ÇDO VIT NË QYTETIN DHE PREFEKTURËN E BERATIT

TË MJEKUAR	Shuma	%	PREJ TYRE							
			Malarie	%	Sifilis	%	T.B.C.	%	Sëmundje të tjera	%
në tërë prefekturën	9168	100	4455	48,6	66	0,7	98	1,1	4547	49,6
në qendër	5273	57,6	2866	54,3	26	0,5	56	1,6	2325	43,6

Nga kjo pasqyrë munt të nxiren disa konkluzie. E para është ajo që shënuam më sipër: domethënë se Berati, i cili ka vetëm 7 për qint të popullsís së prefekturës, përfshin 57,5 për qint nga të mjekuarit në tërë prefekturën. Kjo tregon se aktiviteti i organeve të shëndetësisë është koncentruar sidomos në qendrën e prefekturës. Midis të mjekuarve në Berat një pjes'e madhe janë të ardhur nga qarket. Këtej rjeth se duhet të zgjerojmë rjetën e instituteve sanitare sidomos nëpër qarket e prefekturave.

Përqindja e malarikëve në pref. e Beratit është mjaft m'e lartë nga ajo e tërë Shqipërisë. Për tërë Shqipërinë kemi 37,1% të mjekuar malarikë kurse në prefekturën e Beratit kjo përqindje arrin 48,6, domethënë 11,5% më tepër. Kjo s'duhet të na çuditë me që prefektur'e Beratit është djepi malaries ne Shqipërí. Një gjë tjetër për të vënë ré është që përqindja e të mjekuarve që vuajnë nga malaria në Berat arrin 54,3% kurse në qarkun e prefekturës vetëm 48,6%. Përkundrazi sifilizi duket të jetë m'i përhapur në qarket dhe tuberkuloza m'e përhapur në qendër. Si gjithmonë, këto cifra na japin vetëm një idhé q'i afrohet së vërtetës, me që kemi përpara sysh jo numrin absolut e të sëmurëve por vetëm numrin e të mjekuarve prej organeve të shëndetsisë.

3. — Prefektura e Korçës

Korça ësht' e para nga prefekturat për sa i përket numrit të popullsisë, me gjithë këtë vjen e treta nga numri i të mjekuarve. Po të marrim parasysh se në prefekturën e Korcës institutet sanitarë janë aqë të shumta sa dhe në prefekturat e tjera, duhet të konstatojmë se në atë prefekturë populli është m' i shëndetshëm se në të tjerat. Këtë konkluzie që munt të nxiret nga cifrat e vërteton edhe eksperienca direkte. Po t' ua lemë fjalën cifrave. Të mjekuarit për çdo vit kanë qënë:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
6567	6831	7159	9111	11022	12779

Po të marrim cifrën e 1927-ës për 100 do të gjejmë.

1927	1928	1929	1930	1931	1932
100	104	109	138	167	194

Fundi, në pasqyrën që vijon kemi të mjekuarit për çdo sëmundje veçanërisht:

VEPËRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E KORÇËS
në periudën 1927-32

VITI	MJEKUAR	PREJ TYRE							
	Shuma	Malarie	%	Sifilis	%	T. B C.	%	Sëmundje të tjera	%
1927	6567	893	13,6	98	1,5	415	6,3	5161	78,6
1928	6831	1646	24,2	115	1,7	517	7,6	4543	66,5
1929	7159	1337	18,7	69	1,0	279	3,9	5474	76,4
1930	9111	644	7,0	97	1,1	261	2,9	8109	89,0
1931	11022	1020	9,2	78	0,7	164	1,5	9760	88,6
1932	12779	1583	12,4	79	0,6	206	1,6	10911	85,4

Për herë të parë në këtë pasqyrë shohim që evolucioni i të mjekuarve të shtohet regullisht nga viti në vit. Kështu, duke marrë cifrën e vitit 1927 për 100 kemi një shtim të regullshëm dhe më 1932 arrijmë në 194%, domethënë në këtë vit të fundit numri i të mjekuarve është shtuar 94% në krahasim me vitin 1927. Ky shtim i regullshëm rjeth sidomos nga zgjerim' i aktivitetit të instituteve sanitare. Këtë e vërteton dhe fakti që në tre vjetët e parë (1927—29) përqindja mesatare e sëmundjeve të ndryshme ka qënë 73,8 dhe ajo e sëmundjeve endemike 26,2, kurse në tre vjetët fundit sëmundjet e ndryshme arrijnë 88,0 kurse sëmundjet endemike (malarie etj.) zbresin më 12,0%. Domethënë se shtim' i të mjekuarve është bërë për hesap të sëmundjeve të ndryshme.

Për sa i përket malaries munt të themi se në prefekturën e Korçës kjo sëmundje është më pakë e përhapur se kudo. Përqindja mesatare e përvitëshme e malarikëve të mjekuar në tërë Shqipërinë në periudën 1927—32 arrin 37,1 kurse në prefekturën e Korçës kjo përqindje është vetëm 14,2, domethënë 22,9% më pakë. Numri i malarikëve të mjekuar, është siç e pamë fare i ulët, por ndryshon mjaft nga viti në vit. Kjo tregon se malaria nuk ësht' e rënjosur thellë në qarkun e Korçës.

Përqindja e sifilitikëve është m' e ulët se

në tërë Shqipërinë (1,1% me 2%), përkundrazi të sëmurët nga tuberkuloza arrijnë 4% kurse në tërë Shqipërinë janë 1,5%. Këtu munt të shërbejë shpiegimi që dhamë për prefekturën e Shkodrës: tuberkuloza është m'e përhapur me që malarie ka më pakë, ose diagnoza e sëmundjeve bëhet më me sigurí se gjetkë. Përveç kësaj shohim se përqindja e të sëmurëve nga tuberkuloza vete duke u pakësuar (nga 6,3% më 1927 zbret në 1,6% më 1932) ashtu dhe numri absolut i tyre (415 me 206).

Nga sëmundjet ngjitëse më të përhapura janë tifua dhe difteria, sikundër duket nga pasqyra që vijon:

SËMUNDJET NGJITËSE NË PREFEKTURËN E KORÇËS
në periudën e 1927-32

VITI	ROUGEOLE	FIEV. TYPH.	PARATYPH.	DIPHTERIE	TYPHUS
1927	46	—	20	—	—
1928	15	7	—	20	—
1929	—	—	13	20	—
1930	4	12	5	10	—
1931	2	15	—	9	9
1932	463	4	9	1	—

Kësisoj sëmundjet epidemike nuk kanë një karakter të rezikshëm në prefekturën e Korçës; gjithsej në 6 vjet kanë vdekur prej tyre 10 veta. Kjo duhët të jetë cifra absolute me që deklarimi i sëmundjeve ngjitëse është'i detyruarshëm edhe për ata që mjekohen nëpër shtëpitë, prej mjekëve privatë.

Tani na mbetet të bëjmë një studim paralel midis të mjekuarve në qendër dhe në qarkun e prefekturës së Korçës. Ja pasqyra q'e përmbleth këtë pikë:

TË MJEKUARIT PËR ÇDO VIT NË QYTETIN DHE PREFEKTURËN E KORÇËS

TË MJEKUAR	Suma	%	PREJ TYRE							
			Malarie	%	Sifilis	%	T. B C.	%	Sëmundje të jera	%
në tërë prefekturën	8911	100	1187	13,3	89	1,0	307	3,4	7328	82,3
në qendër . . .	7027	78,8	841	11,9	81	1,1	296	4,2	5809	82,8

Shtylla e parë e kësaj pasqyre na tregon se po të marrim numrin mesatar e të mjekuarve në çdo vit në tërë prefekturën e Korçës për 100 pjesa e tyre që janë mjekuar në qytetin e Korçës arrin 78,8%, me fjalë të tjera afro 4/5 të gjithë të sëmurëve janë mjekuar në qytetin e Korçës dhe vetëm 1/5 nëpër qarket e asaj prefekture. Po të marrim parasysh se në prefekturën e Korçës institutet shëndetësore janë mjaft të përhapura, duhet të pranojmë se popullsia e qarkeve t'asaj prefekture është m'e shëndetëshme se ajo e qendrës. Një pikë tjetër për të vënë ré është proporcioni midis sëmundjevë endemike dhe sëmundjeve të ndryshme. Kështu, kurse në prefekturën e Beratit sëmundjet endemike kapin 50,4% të gjithë të mjekuarve, në prefekturën e Korçës të sëmurët nga malarja, sifilisi e tuberkuloza arrijnë vetëm 17,7% nga shuma e të mjekuarve. Rolin kryesor në këtë ndryshim e lot malarja, e cila në prefekturën e Beratit kap 48,6% dhe në atë të Korçës

13,3%. Me një fjalë sëmundjet endemike në prefekturën e Korçës nuk kanë një karakter të rezikshëm për shëndetin e popullsisë.

Ndryshimet midis qendrës dhe qarkeve përsa u përket sëmunqjeve endemike nuk janë me rëndësi. Malarja është m'e përhapur në qarket se sa në qendër; në tërë prefekturën kemi 13,3% malarikë të mjekuar kurse në Korçë 11,9%. Përkundrazi tuberkuloza në Korçë kap 4,2% dhe në qarket 3,4%. Këto krahasime na provojnë se statistika jonë e përfytyron gjendjen reale me një aproksimacion të mjaftë. E dimë nga eksperienca se malarja është'e përhapur sidomos reth liqenit të Maliqit; nga ana tjetër është'e logjikëshme që tuberkuloza të jetë m'e përhapur në qytetin e Korçës, me që kudo kjo sëmundje dëmet më të mbëdha i bën nëpër qytetet.

4. - Prefektura e Durrësit

Prefektura e Durrësit vjen e shtata nga numri i popullsisë dhe e katërta nga numri i të mjekuarve. Në periudën që kemi parasysh numri i përvitshëm i të mjekuarve paraqitet si vijon:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
8206	3996	6487	9489	10071	12861

Po të marrim cifrën e 1927-ës për 100 do të kemi:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
100	48,7	79	115,6	122,7	156,7

Pasqyra tregon një pakësim anormal nga viti 1927 në vitin 1928 dhe pastaj numri i të mjekuarve vete duke u shtuar regullisht.

Para se të japim një gjykim të prerë mbi këto cifra duhet të këqyrim evolucionin e sëmundjeve endemike në këto 6 vjet. Këtë evolucion na i jep pasqyra që vijon:

VEPRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E DURRËSIT
në periudën 1927-32

VITI	Numri i të mjekuarve	PREJ TYRE							
		Malarie	%	Sifilis	%	T.B.C.	%	Sëm. të tjera	%
1927	8206	3270	39,8	190	2,3	107	1,3	4639	56,6
1928	3996	1566	39,1	115	2,9	66	1,6	2149	56,4
1929	6487	1963	30,4	87	1,3	66	1,0	4371	67,3
1930	9489	2399	25,3	99	1,0	58	0,6	6933	73,1
1931	10071	1140	11,3	87	0,9	57	0,6	8787	87 2
1932	22862	2605	20,2	95	0,7	75	6,6	10087	78,5

Këtu duket sheshit se shtim' i të mjekuarve që konstatuam më sipër është rezultati i zgjerimit t'aktivitetit të organeve shëndetësore, me qënë se është bërë për hesap të sëmundjeve të ndryshme. Shtylla e fundit na tregon një shtim të shpejtë t'atyreve që vuanin nga

sëmundje të ndryshme, kështu që këta arrijnë më 1931 gjer më 87,2% të gjithë të mjekuarve n' atë vit. Kjo përqindje i aferohet asaj së Korçës e cila në ketë pikë mban rekordin midis prefekturave. Më 1932, të mjekuarit që vuanin nga sëmundje të ndryshme zbresin 78,5%, domethënë janë 8,7% më pakë se në vitin e mëparshëm. Ky ndryshim është shkaktuar nga shtimi i malarikëve të mjekuar më 1932 në krahasim me vitin 1931. Sido qoftë tendenca e përgjithëshme mbetet e pandryshuar. Me gjithë që aktivitet' i instituteve shëndetësore në prefekturën e Durrësit është shtuar, pesha specifike e sëmundjeve endemike është pakësuar. Midis sëmundjeve endemike në radhë të parë vjen malaria. Cifrat mbi malarien në pasqyrën e sipërme e forcojnë këtë thezë. Malarikët e mjekuar në në këtë prefekturë nga 39,8% më 1927 zbresin më 20,2% në 1932, domethënë nga 100 të mjekuar më 1927 afro 40 ishin malarikë kurse më 1932 në 100 të mjekuar kish vetëm 20 malarikë. Më 1931, viti rekord, malarikët kanë qënë vetëm 11,3%. Nga 1931-ja më 1932 malarikët janë shtuar më se dyfish kurse numri i përgjithëshmë i të mjekuarve është shtuar vetëm 28%. Këtu kanë lozur rol disa faktorë akcidentale dhe të përkohëshmë, si konditat atmosferike etj. Me gjithë këtë tendenca e përgjithëshme tregon pakësimin e malaries në prefekturën e Durrësit. Po atë konkluzie munt të nxjerim nga ba rasimi i cifrave të prefekturës së Durrësit me ato të gjithë Shqipërisë. Në tërë Shqipërinë cifrat mesatare e malarikëve në periudën 1927—32 ka qënë 37,1% nga gjithë të mjekuarit, kurse në prefekturën e Durrësit kjo cifër kap vetëm 27,7%. Po ka dhe më. Në tërë Shqipërinë malarikët e mjekuar nga 42% më 1927 kanë zbritur në 37,1% më 1932, domethënë janë pakësuar 11,6% kurse në prefekturën e Durrëssit cifrat rispektive janë 39,8% më 1927 dhe 20,2% më 1932, domethënë se pakësimi këtu arrin 49%.

Sapër sëmundjet e tjera endemike (sifilis, tuberkulozë) ato nuk lozin nonjë rol me rëndësí në prefekturën e Durrësit, pa dyshim nga sa munt të kuptohet prej cifrave që kemi në dorë. Përqindja mesatare e të sëmurëve nga sifilizi dhe tuberkuloza është m' e ulët se në tërë Shqipërinë. Gjith' ashtu pesha specifike e këtyre sëmundjeve midis gjithë të sëmurëve janë mjekuar, vete duke u pakësuar.

Nga sëmundjet ngjitëse e vetëmja e përhapur në pref. e Durrësit është fruthi me 102 të sëmurë më 1927, 49 më 1930 dhe 23 më 1932. Midis këtyre shënohen vetëm dy vdekje më 1932.

Pika e fundit që na mbetet të sqyrtojmë për sa i përket prefekturës së Durrësit është mënyra se si janë ndarë të mjekuarit midis qarkeve dhe qytetit të Durrësit. Sikundër e bëmë edhe më sipër, për të lehtësuar punën do të marrim cifrat mesatare për çdo vit dhe çdo kategorí, duke ndarë me 6 shumën e të mjekuarve në periudën 1927—32. Rezultatet tregohen në pasqyrën që vjen më poshtë.

TË MJEKUARIT PËR ÇDO VIT NË PREFEKTURËN DHE QYTETIN E DURRËSIT

TË MJEKUAR	Shuma	%	PREJ TYRE							
			Malarie	%	Sifilis	%	T. B C	%	Sëmundje të tjera	%
në tërë prefekturën	8518	100	2157	25,4	112	1,3	71	0,8	6178	72,5
në qendër . . .	6977	80,2	1644	23,6	54	0,8	13	0,2	5266	75,4

Edhe këtu përsëritet ajo që pamë në prefekturat e tjera. Në qoftë se shumën mesatare e të mjekuarve për çdo vit në tërë prefekturën e marrim për 100, gjejmë se 80 prej tyre janë mjekuar në qytetin e Durrësit, me gjithë që ky i fundit ka vetëm 7,6 për qint të popullsísë s' asaj prefekture. Arësyeja prapë ësht' ajo që pamë më sipër. Në qendër vin' e mjekohen shumë banorë të qarkeve.

Për sa u përket sëmundjeve endemike nuk shohim nonjë ndryshim me rëndësí midis qendrës dhe periferisë. Kështu p. sh. po të marrim për 100 numrin e të mjekuarve për çdo vit në tërë prefekturën do të shohim se afro

25 prej tyre kanë qënë të sëmurë nga malarja, kurse brënda në Durrës të sëmurët nga malarja formojnë afro 24 për qint të shumës s'atyreve që janë mjekuar po n'atë kohë. Të sëmurët nga sifilisi janë më tepër në qarket se sa në qendër, gjith'ashtu edhe për tuberkulozën.

5. - Prefektura e Gjinokastrës

Prefektura e Gjinokastrës vjen e dyta midis prefekturave nga numri i popullsisë dhe e pesta nga numri i përgjithëshmë i të mjekuarve në periudën 1927—1932. Të mjekuarit ndahen për çdo vit si pas pasqyrës që vijon:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
7478	6726	8790	8457	7172	9559

Po të marrim cifrën e 1927-ës për 100 do të gjejmë për vitet e tjerë:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
100	90	118	113	96	128

Këtu kemi një vijë me zigzage që tregon një proces pa tendencë të karakterizuar. Po të marrim dy vitët ekstremë do të shohim se numr'i të mjehuarve është shtuar 28 për qint. Por ky shtim nuk ësht'i regullshëm, prandaj që të nxjerim një konkluzie të saktë duhet të shohim se si ndahen të mjekuarit midis sëmundjeve të ndryshme. Këtë e gjejmë në pasqyrën që vijon:

VEPËRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E GJINOKASTRËS

VITI	Numri i të mjekuarve	PREJ TYRE							
		Malarie	%	Sifilis	%	T. B. C	%	Sëm. të tjera	%
1927	7478	2735	37	130	1,7	71	0,9	4542	60,4
1928	6726	2937	33	174	2,5	85	1,3	3530	63,2
1929	8790	3905	44	201	2,3	115	1,3	4569	52,4
1930	8457	3216	38	243	2,9	109	1,3	4989	57,8
1931	7172	2748	38,3	127	1,7	63	0,9	4234	59,1
1932	9559	4235	44,3	191	1,9	63	0,7	5070	53,1

Këtu shohim se prefektura e Gjinokastrës është një nga ato ku malarja lot rolin më të dëmshim në keqësimin e shëndetit publik. Edhe, duke analizuar cifrat'e pasqyrës së sipërme nuk munt të themi se kjo sëmundje vete duke u pakësuar. Përkundrazi, kur se nga 1929-a në 1931 shohim një pakësim të rregullshëm, më 1932 numri i malarikëve të mjekuar shtohet në një proporcion mjaft të fortë. Esht'e vërtetë se ky shtim i të mjekuarve përgjithërisht dhe i malarikëve veçanërisht konstatohet në vitin 1932 po thua në të gjitha prefekturat, por gjetkë pesha specifike e të sëmurëve nga malarja vete duke u pëkësuar kurse në prefekturën e Gjinokastrës kjo shtohet. Prandaj na takon të zgjerojmë fushën e aktivite-

tit të Sekcionit Antimalarik duke çelur sa më shpejt një degë edhe në prefekturën e Gjinokastrës.

Përqindja e sifilitikëve në prefekturën e Gjinokastrës është m'e lartë se e tërë Shqipërisë. Për tërë Shqipërinë kemi 2% të mjekuar sifilitikë kurse në prefekturën e Gjinokastrës 2,2%.

Duke folur mbi Malësin'e Shkodrës thamë se ka vise në Shqipëri ku sifilisi është m'i përhapur se atje. Vëndi ku përqindja e sifilitikëve të mjekuar është m'i lartë në tërë Shqipërinë është Kurveleshi. Ja cifrat për tre vjet:

	1930	1931	1932
Numr'i përgj. të mjekuarve	1344	1546	1854
prej tyre sifilitikë	106	102	74

Po të marrim përqindjet e këtyre cifrave do të gjejmë se në Kurvelesh të sëmurët nga sifilisi formojnë 6% të gjithë të mjekuarve kurse në tërë Shqipërinë 2%. Një gjë ngushëllonjëse është që numri i sifilitikëve të mjekuar vete duke u pakësuar nga viti në vit kurse numri i përgjithshëm i të mjekuarve shtohet.

Përkundrazi të mjekuarit që vuajnë nga tuberkuloza janë më të pakë në prefekturën e Gjinokastrës se sa në tërë Shqipërinë (1,0% me 1,5%). Këtu natyrisht duhen bërë rezervat e zakonëshme për sa i përket diagnozës.

Sëmundjet ngjitëse janë mjaft të përhapura në prefekturën e Gjinokastrës. Ato që ndeshen më shpesh janë fruthi, tifua, dhe skarlatina, sikundër shihet në paqyrën që vijon:

VITI	ROUGEOLE	FIEV. TYPH. E PARATYPH.	DIPHTÉRIE	SKARLATINË	VDEKJE
1927	22	4	3	33	3
1928	55	—	—	190	7
1929	113	—	—	10	—
1930	6	15	13	—	2
1931	—	16	3	—	2
1932	462	4	2	39	8

Vdekjet e shkaktuara nga sëmundjet ngjitëse kanë qënë: më 1927: 3, më 1928: 7, më 1930: 2, më 1931: 2 dhe më 1932: 8.

Të vimë tani te mënyra se si janë ndarë të sëmurët e mjekuar midis qytetit dhe prefekturës së Gjinokastrës. Edhe këtu, me ca ndryshime të vogla përsëritet ajo që pamë në prefekturat e tjera. Për të formuar një mendim të prerë edhe mbi këtë pikë marrim cifrat mesatare e të mjekuarve për çdo vit dhe kemi pasqyrën që vjen më poshtë:

TË MJEKUARIT PËR ÇDO VIT NË PREFEKTURËN DHE QYTETIN E GJINOKASTRËS

TË MJEKUAR	Shuma	%	PREJ TYRE							
			Malarie	%	Sifilis	%	T B. C	%	Sëmundje të tjera	%
në tërë prefekturën	8031	100	3296	41	178	2,2	84	1,0	4473	55,8
në qendër . . .	4158	52	1623	36,7	114	2,7	43	1,0	2378	59,6

Këtu shohim pik së pari se po të marrim shumën e të mjekuarve në tërë prefekturën për 100, të mjekuarit në qytetin e Gjinokastrës formojnë 52% të kësaj shume, me fjalë të tjera më tepër se gjysma e mjekimeve janë bërë në qendrën e prefekturës kurse banorët e Gjinokastrës formojnë 7% të popullsisë së prefekturës. Nga ana tjetër përqindja e mala-

rikëve është m'e lartë në periferinë se sa në qendër (41 me 36,7 për qint), përkundrazi sifilisi është m'i përhapur brënda në qytet se sa në qarkun e prefekturës. Përqindja e sifilitikëve vjen m'e lartë në prefekturën e Gjinokastrës se sa në tërë Shqipërinë. Për sa i përket tuberkulozëz Gjinokastra del me një përqindje më të ulët nga ajo e tërë Shqipërisë, por kjo duhet marrë me rezervë me që nuk është bërë një ekzaminim sistematik i popullatës dhe nuk janë përdorur mjetet e përshtatëshme për një diagnozë të sigurtë.

6. - Prefektura e Tiranës

Prefektur'e Tiranës vjen e 8-a nga popullsia dhe e 6-a nga numri i përgjithëshmë i të mjekuarve në periudën 1927—32. Të mjekuarit për çdo vit kanë qënë:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
9969	6722	7162	5411	5381	7030

Nga 1927-a me 1931 kemi një pakësim pak a shumë të regullshëm, i cili duket më mirë po të marrim cifrat e sipërme në përqindje të cifrës së vitit 1927:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
100	67,4	71,7	54,2	54	70

Nga viti 1931 më 1932 kemi një shtim të fortë prej 30%, kurse për tërë Shqipërinë ky shtim ka qënë 26%. Këtu ka lozur rol sidomos çelja e spitalit të ri Zog i I por edhe një shtim në përhapjen e disa sëmundjeve konstatohet me sigurí.

Pasqyra që vjen më poshtë na tregon mënyrën se si janë ndarë cifrat e sipërme midis sëmundjeve të ndryshme.

VEPËRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E TIRANËS
në periudën 1927-32

VITI	NUMRI I TË MJEKUARVE	PREJ TYRE							
		Malarie	%	Sifilis	%	T B.C.	%	Sëmundje të tjera	%
1927	9969	3580	35,9	574	5,7	46	0,4	5768	58,0
1928	6722	1679	25,0	270	4,0	43	0,6	4770	70,4
1929	7162	1799	25,1	442	6,1	113	1,5	4808	67,3
1930	5411	1382	25,5	246	4,5	120	2,2	3668	67,8
1931	5381	1768	33,0	196	3,6	106	1,9	3311	61,5
1932	7030	1876	26,7	306	4,3	144	2,0	4704	67,0

Këtu pik së pari duhet të vëmë ré se tendenca e malarjes nuk është caktuar mirë akoma. Më 1927 kemi cifrën rekord të malarikëve që janë mjekuar, më 1928 kjo cifrë pakësohet më tepër se gjysmë për gjysmë, më 1930 kemi cifrën më të ulët dhe në dy vitet e fundit kjo cifër vete përsëri duke u shtuar. Sido qoftë munt të themi se intensiteti i kësaj sëmundjeje, me masat energjike që janë marrë prej Sekcionit Antimalarik, vete gra-

SPITAL' I PËRGJITHSHËM "ZOG I I."

PAMJA NGA JASHTË

GALERIA KRYESORE

SPITAL' I PËRGJITHSHËM "ZOG I I."

NJË PAVILION

BARNATORJA

SPITAL' I PËRGJITHSHËM "ZOG I I."

SALLA E RADIOLOGJISË

SALLA E ELEKTROTERAPISË

SPITAL'I PËRGJITHSHËM "ZOG I I."

SALLA E OPERACIONIT

NDËRTESA E RÉ E LABORATUARIT BAKTERIOLOGJIK

dualisht duke u pakësuar. Të sëmurët që paraqiten për mjekim kanë më tepër malarje kronike se sa të ré.

Sifilisi në prefekturën dhe sidomos në qytetin e Tiranës është m'i përhapur se kudo gjetkë në Shqipëri, përveç Kurveleshit natyrisht. Kjo është në lidhje me prostituciònin e fshehtë, i cili mbetet jashtë çdo kontroli mjekësor. Edhe gjëja m'e keqe është që shumica e të sëmurëve që paraqiten për mjekim e kane marrë për herë të parë këtë sëmundje. Përqindja mesatare e sifilitikëve të mjekuar për çdo vit në prefekturën e Tiranës ka qënë 4,7%, në tërë Shqipërinë 2% dhe në Kurvelesh 6%.

Tuberkuloza paraqet një pikë karakteristike: në dy vitet e parë 1927—28 është fare e pakë kurse në katër vjetët e fundit shtohet afro 3 fish. Ky shtim shpjegohet me hyrjen në vepërim të Institutit Radiologjik, me anën e të cilit ka qënë e mundur të bëhet një diagnozë m'e saktë e kësaj sëmundjeje. Sapër shtimin e të mjekuarve nga tuberkuloza në vitin 1932 ay shpjegohet gjer më një farë pike me çeljen e spitalit të kryeqytetit, ku ka qën'e mundur të pranohen një numur m'i math të sëmurësh.

Pik'e fundit që duhet shënuar është që shtimi i fortë i të mjekuarve që konstatohet në prefekturën e Tiranës më 1932 është bërë sidomos për hesap të sëmundjeve të ndryshme. Po të krahasojmë cifrat e dy vjetve të fundit do të gjejmë se numri i të mjekuarve që vuanin nga sëmundje endemike (malarja, sifilis etj.) është shtuar nga viti 1931 më vitin 1932 me 12% kurse numri i të mjekuarve që vuanin nga sëmundje të ndryshme është shtuar po n'atë kohë me 42%. Kjo provon se shtimi i të mjekuarve është rezultati i zgjerimit t'aktivitetit t'organeve të Shëndetësisë nga një anë dhe i ashpërimit të disa sëmundjeve si gripi etj. që varet nga shkaku akcidentale e të përkohëshme, nga ana tjetër.

Sëmundjet ngjitëse me forma epidemike nuk kanë një karakter të rezikshëm në prefekturën e Tiranës, sikundër duket nga pasqyra që vijon:

VITI	ROUGEOLE	FIEV. TYPH.	SKARLATINË	DIPHTERIE	VDEKJE
1927	8	8	—	—	2
1928	4	3	—	—	—
1929	2	5	1	1	2
1930	105	2	1	—	1
1931	26	10	—	—	3
1932	8	8	—	1	2

7. - Prefektura e Vlorës

Prefektur'e Vlorës vjen e 9-a nga numr'i popullsisë dhe e 7-a nga numr'i përgjithësh-më i të mjekuarve në periudën 1927—32. Të mjekuarit ndahen si vijon midis viteve të ndryshmë të periudës që na intereson:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
6398	6363	5531	5175	6210	8347

Po të marrim përqindjet e këtyre cifrave do të gjejmë:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
100	99,4	86,3	80,8	97	130,4

Gjer më 1930 numr'i të mjekuarve vete regullisht duke u pakësuar, kurse në dy vitet e fundit kemi një shtim të fortë.

Mënyra se si ndahen të mjekuarit midis sëmundjeve endemike dhe të ndryshme, duket nga pasqyra që vijon:

VEPËRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E VLORËS
në periudën 1927-32

VITI	SHUMA e të mjekuarve	PREJ TYRE							
		Malarie	%	Sifilis	%	Tuberkulozë	%	Sëmundje të tjera	%
1927	6398	2621	40,9	449	7,0	57	0,9	3271	51,2
1928	6363	2744	43,1	226	3,5	74	1,2	3319	52,2
1929	5531	3485	63,0	167	3,0	46	0,8	1833	33,2
1930	5175	3098	59,8	158	3,0	60	1,2	1859	36,0
1931	6210	3750	60,3	144	2,3	40	0,6	2276	36,8
1932	8347	5158	61,7	282	3,8	73	0,9	2834	33,4

Pasqyrë mjaft e tristuarshme, sidomos për sa i përket malarjes. Të sëmurët nga malarja venë duke u shtuar edhe në cifra absolute edhe në cifra relative. Numr'i i përgjithëshmë i të mjekuarve nga viti 1927 më 1932 është shtuar siç e pamë 30,4% kurse numr'i malarikëve të mjekuar është shtuar 96,7%. Nga ana tjetër nga shuma e të mjekuarve më 1927 malarikët kanë kapur 40,9%, kurse më 1932 malarikët e mjekuar arrijnë 61,7% t'asaj shume. Me gjithë këtë prefektur'e Vlorës vjen pas Elbasanit për sa i përket përhapjes së malarjes.

Edhe sifilisi është mjaft i përhapur në prefekturën e Vlorës ku përqindja mesatare e të mjekuarve nga kjo sëmundje arrin 3,8%, kurse në tërë Shqipërinë është 2%. Për sa i përket sifilisit Vlora vjen pas Tiranës.

Të mjekuarit nga tuberkuloza që figurojnë në pasqyrën e sipërme janë më të pakët se në tërë Shqipërinë, por këtu sigurisht cifrat nuk i përgjigjen realitetit. Kjo vjen, siç e thamë edhe herë tjetër, nga mungesa e mjeteve teknike për të bërë një diagnozë të saktë.

Këtu është vëndi për të bërë një krahasim midis cifrave të lëvizjes demografike dhe ato të sëmundjeve. Pamë në pjesën e parë se Vlora (me Elbasanin) ish prefektura ku vdekjet kapërxejnë lindjet. Nga cifrat e sipërme duket se Vlora është prefektura që paraqet gjendjen shëndetësore më kritike.

Me gjithë këtë sëmundjet ngjitëse janë fare pakë të përhapura në prefekturën e Vlorës, shumë më pakë se në prefekturat e tjera si Korça, Shkodra, Berati, etj.

Ja cifrat q'e karakterizojnë këtë pikë:

VITI	ROUGEOLE	FIEV. TYPH. E PARATYPH.	SKARLATINË	DIPHTERIE
1927	32	20	—	—
1928	20	—	—	—
1929	—	10	—	—
1930	—	—	—	—
1931	—	3	—	1
1932	114	3	—	—

Gjithësej kemi 2 vdekje nga fruthi më 1932.

Krahasimi midis të mjekuarve në qendër dhe në qarkun e prefekturës nuk ka kuptim këtu, me që tërë institutet shëndetësore të prefekturës janë grumbulluar në qytetin e Vlorës.

8. - Prefektur' e Elbasanit

Prefektur'e Elbasanit vjen e 5-a nga popullsia dhe e 8-a nga numr'i të mjekuarve. Mënyra se si ndahen të mjekuarit në çdo vit duket nga cifrat e poshtme:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
7590	6267	5142	3347	4243	7826

Për të pasur një idhé më të qartë, të marrim përqindjet e këtyre cifrave:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
100	82,3	67,7	42,7	55,8	103,1

Këtu shohim një proces mjaft karakteristik. Nga 1927-a më 1930 shohim një pakësim të regullshëm në numrin e të mjekuarve, kurse më 1931 dhe 1932 ky numur shtohet me një rithmë mjaft të shpejtë. Me qënë se këtë fakt e konstatuam dhe në disa prefektura të tjera, këtej munt të kuptohet lehtë se kemi të bëjmë me një evolucion t'instituteve dhe t'organëve të Shëndetsis. Domethënë se gjer më 1930 gjendja shëndetësore ka shkuar në gjyrma të pandryshuara, kurse në dy vitet e fundit, në lidhje pa dyshim me shtimin e organëve, dhe kështu të një aktiviteti më të gjerë në fushën shëndetsore, numri i të mjeksuarve vete dyke u shtuar, gjë që jep të kuptohet se mjekët shetitës kanë vënë dorë mbi çdo të sëmurë.

Që t'a kuptojmë më mirë këtë pikë duhet të shohim se si ka shkuar evolucion'i sëmundjeve endemike në këto gjashtë vjet. Kjo duhet në pasqyrën që vijon:

VEPËRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E ELBASANIT
në periudën 1927-32

VITI	NUMRI I TË MJEKUARVE	PREJ TYRE							
		Malarie	%	Sifilis	%	T. B. C.	%	Sëmundje të tjera	%
1927	7590	5463	71,9	171	2,3	78	1,2	1878	24,6
1928	6267	4544	72,5	164	2,6	38	0,6	1521	24,3
1929	5142	2541	47,6	125	2,4	56	1,1	2420	49,9
1930	3347	1737	51,6	122	3,6	47	1,4	1441	43,4
1931	4243	2051	48,4	113	2,7	29	0,7	2052	48,2
1932	7826	4218	53,8	122	1,5	62	0,8	3424	43,9

Tendenca që konstatuam në numrin e përgjithëshmë t'atyreve që janë mjekuar përsëritet edhe në cifrat e të sëmurëve nga malaria. Edhe atje pakësimi është'i regullshëm gjer më 1930, kurse në dy vjetët e fundit numri i malarikëve të mjekuar shtohet më tepër se dyfish. Përgjithërisht Elbasani është prefektura që ka përqindjen më të fortë të mala-

rikëve të mjekuar. Po të marrim përqindjen mesatare të cifrave të sipërme do të gjejmë se nga gjithë të mjekuarit në 6 vjet 57,6 për qint kanë qënë të sëmurë nga malaria. Vlora vjen e dyta 54,6 për qint të mjekuar që vuanin nga malaria. Këtu duhet evituar një konfuzion. Po të marrim cifrat absolute ka prefektura ku malarikë janë mjekuar më tepër se në prefekturën e Elbasanit. Kjo ngjet në Berat e në Shkodër. Por atje popullsia është m' e tepër dhe numri i përgjithëshmë i të mjekuarve është m' i math. Më sipër né kemi nxjerrë përqindjen e malarikëve në lidhje me të mjekuarit përgjithërisht. Kjo domethënë se kur në prefekturën e Shkodrës janë mjekuar 100 veta, 37 prej tyre kanë qënë malarikë, kurse në prefekturën e Elbasanit midis çdo 100 të mjekuarve afro 58 kanë qënë të sëmurë nga malaria.

Edhe sifilisi është m' i përhapur në Elbasan se sa në tërë Shqipërinë. Me gjithë këtë për sa i përket sifilisit Elbasini vjen pas Tiranës dhe Vlorës. Përqindja e të sëmurëve nga tuberkuloza del fare e ulët, por edhe këtu duhen bërë rezervat e zakonëshme për sa i përket diagnozës.

Edhe në prefekturën e Elbasanit, si në atë të Vlorës, sëmundjet ngjitëse me karakter epidemik nuk janë shumë të përhapura. Kjo duket në pasqyrën që vijon:

VITI	ROUGEOLE	FIEVRE TYPHOIDE P. PARATYPHOIDE	DIPHTERIE	SCARLATINE
1927 . . .	230	1	—	—
1928 . .	4	—	—	—
1929 . . .	—	—	—	2
1930 . . .	—	1	—	—
1931 . . .	4	4	1	—
1932 . . .	46	—	—	—

Më 1927 vetëm ka pasur 3 vdekje nga fruthi. Sapër mënyrën e ndarjes së të mjekuarve midis qendrës dhe qarkeve, pasqyra s' ka kuptim të bëhet me që pothua tërë aktiviteti (ekzaktërisht 80%) i instituteve shëndetësore është koncentruar në qytetin e Elbasanit.

9. · Prefektura e Dibrës

Prefektura e Dibrës vjen e 6-a nga popullsia dhe e 9-a nga num'i të mjekuarve. Këta ndahen në mënyrën që vijon:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
727	1312	3565	4425	4263	2516

Këtu duket një tendencë origjinale që s' është parë as në një nga prefekturat e tjera. Përgjithërisht pasqyrat e gjertanishme na kanë treguar një cifër të fortë të mjekuarësh më 1927, pastaj një pakësim pak a shumë të regullshëm gjer më 1930, fundi një shtim pak a shumë të fortë në dy vitet e fundit. Kurse këtu në prefekturën e Dibrës shohim një shtim të regullshëm në numrin e të mjekuarve që nga 1927-a e më 1931, kurse më 1932 ky numur pakësohet afro 40% në krahasim me vitin e mëparshëm.

Po të marrim cifrën e vitit 1927 për 100 do të kemi:

1927	1928	1929	1930	1931	1931
100	180	490	608	586	346

SPITAL' I SHTETIT NË KORÇË

SPITAL' I SHTETIT NË SHKODËR

SPITAL' I SHTETIT NË VLORË

AMBULANCA E BASHKISË NË DURRËS

DY PAMJE E ÇMENDINËS NË VLORË

DISPANSERI E BERATIT

DISPANSERI E SHTETIT N'ELBASAN

Shtimi që nga viti 1927 më 1931 është rezultati i zgjerimit t'aktivitetit t'organeve shëndetësore, kurse pakësim' i vitit 1932 tregon një mungesë aktiviteti ng'an'e organëve të shëndetësís, gjë që bën përjashtim nga çdo prefekturë tjetër.

Në pasqyrën që vijon gjejmë se si janë ndarë këta të mjekuar pas sëmundjeve.

VEPËRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E DIBRËS

VITI	SHUMA e te mjekuarve	PREJ TYRE							
		Malarie	%	Sifilis	%	TBC.	%	Sëmundje të tjera	%
1927	727	306	40	100	13,7	0	—	321	46,3
1928	1312	808	62	104	7,8	19	1,4	381	28,8
1929	3565	1283	36	239	6,7	43	1,2	2000	56,1
1930	4425	1381	31	117	2,6	53	1,2	2874	65,2
1931	4263	1327	31	105	2,4	58	1,3	2773	65,3
1932	2516	827	33	10	0,4	21	0,8	1658	65,8

Në fillim pjesa e malarikëve të mjekuar është'e madhe me që ata janë të parët që vinë të mjekohen. Pastaj duke u zgjeruar aktiviteti i organeve të shëndetësisë, numri i përgjithëshmë i të mjekuarve shtohet më shpejt se ay i të sëmurëve nga malarja, kështu që pjesa relative e malarikëve bie nga 62 gjer më 33%. Një pikë karakteristike është që më 1932 numr'i malarikëve të mjekuar pakësohet pothua aqë sa dhe numr'i përgjithëshmë i të mjekuarve: numr'i përgjithëshmë i të mjekuarve është pakësuar 41% kurse numr'i malarikëve të mjekuar është pakësuar 39%.

Sifilisi është shum'i përhapur në prefekturën e Dibrës, e cila për këtë sëmundje vjen e dyta në tërë Shqipërinë, pas Kurveleshit.

Por edhe në prefekturën e Dibrës duket një pakësim sistematik i të mjekuarve nga kjo sëmundje, pakësim i cili më 1932 arrin një shkallë fare të ulët. Kjo do t'ishte një gjë mjaft ngushëllonjëse po t'ishim të sigurtë se cifrat t'ona kapin me të vërtetë të gjithë të sëmurët e atij qarku.

Sapër tuberkulozën, nuk duket që të jetë shum'e përhapur në prefekturen e Dibrës, përqindjet mesatare që na jep pasqyra e sipërme janë më të ulta se ato të Shqipërisë përgjithësisht.

10. - Prefektura e Kosovës

Prefektur'e Kosovës vjen e 10-a nga popullsia dhe e 10-a nga numr'i të mjekuarve. Atje vepërimet e Shëndetësisë fillojnë më 1928 dhe shvillohen në mënyrën që vijon.

Të mjekuar për çdo vit:

1928	1929	1930	1931	1932
190	606	310	624	976

Po të marrim cifrën e 1928-ës për 100 do të kemi:

1928	1929	1930	1931	1932
100	320	168	330	513

Këtu bie në sy një shtim i regullshëm dhe mjaft i fortë i të mjekuarve. Ky shtim nuk munt të jetë tjetër veçse rezultat'i aktivitetit që ka treguar mjeku shëtitës i atij vëndi. Për të formuar një idhé mi mënyrën se si ndahen këta të mjekuar midis sëmundjeve të ndryshme do të marrim cifrat mesatare për çdo vit. Kësisoj gjejmë:

VEPËRIMET E SHËNDETËSISË NË PREFEKTURËN E KOSOVËS

TË MJEKUAR	SHUMA	PREJ TYRE							
		Malarie	%	Sifilis	%	T. B C.	%	Sëmundje të tjera	%
1928-32 (cif. mesatare)	541	208	38,4	23	4,2	31	5,7	279	51,7

Me gjithë që kemi të bëjmë me një prefekturë ku predominojnë malësitë prap se prapë përqindja e malarikëve të mjekuar është m'e lartë se në tërë Shqipërinë (38,4% në Kosovë, 34,3% në tërë Shqipërinë.)

Edhe nga sifilisi prefektur'e Kosovës vjen në radhë të parë, pas Kurveleshit, Dibrës dhe Tiranës.

Një gjë për t'u vënë ré është që nga tuberkuloza prefektur'e Kosovës vjen e para në tërë Shqipërinë me 5,7% të sëmurë tuberkulozë të mjekuar. Këtu arësyeja duhet kërkuar në varfërin'e madhe që mbretëron n'ato vise, dhe në mënyrën e jetesës.

* * *

Studimi i imtë që bëmë më sipër na dha një idhé të përgjithëshme mbi rëndësinë relative të sëmundjeve më të rezikëshme në viset e ndryshme të Shqipërisë. Konkluziet që munt të nxiren nga ky studim janë fare të kufizuara dhe aproksimative me që cifrat me të cilat kemi operuar nuk përfshijnë të gjithë të sëmurët e çdo kategorie por vetëm ata që janë paraqitur në organet e shëndetësisë. Me gjithë këtë duke studiuar këtë proces për disa vjet me radhë kemi mundur të caktojmë me siguri pothua të plotë tendencat e evolucionit të çdo sëmundjeje në çdo qark veç e veç dhe në tërë Shqipërinë. Dhe duke qënë se për një statistikë në kuptimin e vërtetë të fjalës kjo është pika më esenciale, munt të themi se mundimi ynë nuk vate kot.

Për të mbyllur këtë kapitull kemi vendosur një tabelë (Nr. 15), e cila përmbleth në një mënyrë që bie në sy ato që studiuam më sipër më hollësí. Kjo tabelë është bërë duke marrë për çdo prefekturë dhe për çdo sëmundje citrat mesatare të përvitëshme. Prefekturat janë radhitur duke marrë numrin e përgjithëshmë të të sëmurëve që janë mjekuar në 6 vjet (1927—32).

Më poshtë japim kategorizimin e prefekturave duke marrë për bazë cifrën absolute e të mjekuarve përgjithësisht dhe për çdo sëmundje veçanërisht.

I. - **Radhim' i prefekturave pas numrit të përgjithëshmë të pacientëve të mjekuar në vitet 1927—32**

PREFEKTURA	Numr' i përgj. i të mjekuarve	PREFEKTURA	Numr' i përgj. i të mjekuarve
1) *Shkodër* . . .	65716	6) *Tiranë* . . .	41675
2) *Berat*	55009	7) *Vlorë*	38024
3) *Korçë*	53469	8) *Elbasan* . . .	34415
4) *Durrës* . . .	51111	9) *Dibër*	16808
5) *Gjinokastër* .	48188	10) *Kosovë* . . .	2706

TABELA Nr. 15

Ndarja e të mjekuarve pas llojit të sëmundjes në çdo prefekturë



II. - **Radhim' i prefekturave pas numrit të përgjithëshmë të malarikve të mjekuar në vitet 1927—32**

PREFEKTURA	Numr'i malarikëve të mjekuar	PREFEKTURA	Numr'i malarikëve të mjekuar
1) *Berat*	26729	6) *Durrës* . . .	12943
2) *Shkodër* . . .	24797	7) *Tiranë* . . .	11984
3) *Vlorë*	20854	8) *Korçë*	7123
4) *Elbasan* . . .	20464	9) *Dibër*	5932
5) *Gjinokastër* .	19779	10) *Kosovë* . . .	1040

III. - **Radhim' i prefekturave pas numrit të përgjithëshmë të sifilitikëve të mjekuar në vitet 1927—32**

PREFEKTURA	Numr'i sifilitikeve të mjekuar	PREFEKTURA	Numr'i sifilitikëve të mjekuar
1) *Tiranë* . . .	2034	6) *Durrës* . . .	673
2) *Vlorë*	1426	7) *Skkodër* . . .	553
3) *Gjinokastër* .	1066	8) *Korçë*	536
4) *Elbasan* . . .	817	9) *Berat*	395
5) *Dibër*	675	10) *Kosovë* . . .	117

IV. - **Radhim' i prefekturave pas numrit të përgjithëshmë të tuberkulozëve te mjekuar në vitet 1927—32**

PREFEKTURA	Numr' i tuberkulozëve të mjekuar	PREFEKTURA	Numr' i tuberkulozëve të mjekuar
1) *Korçë*	1842	6) *Durrës* . . .	427
2) *Shkodër* . . .	1182	7) *Vlorë*	350
3) *Berat*	589	8) *Elbasan* . . .	310
4) *Gjinokastër* .	502	9) *Dibër*	194
5) *Tiranë* . . .	472	10) *Kosovë*. . . .	156

BISHT

V. - **Radhim' i prefekturave pas popullsisë.**

PREFEKTURA	POPULLSIA	PREFEKTURA	POPULLSIA
1) *Korçë*	147.536	6) *Dibër*	86.992
2) *Gjinokastër* .	143.926	7) *Durrës* . . .	77.890
3) *Berat*	142.616	8) *Tiranë* . . .	57.808
4) *Shkodër* . . .	132.307	9) *Vlorë*	53.561
5) *Elbasan* . . .	111.442	10) *Kosovë*. . . .	49.119

VII. — LUFTA KUNDËR MALARIES

1. - Krijimi i Sekcionit Antimalarik

Malaria është armiku kryesor dhe m' i rezikshëm i shëndetit publik në Shqipërí. Në fusha e në male, në qytete e në katunde, me një fjalë në çdo kënd të Shqipërisë ndeshen viktimat e kësaj sëmundjeje të tmershme. Prandaj, që kur se u krijua, Drejtoria e Përgjithëshme e Shëndetsisë, energjinë më të madhe është përpjekur t' ja kushtojë luftës kundër malaries. Në fillim të aktivitetit t' onë rëndësia m' e madhe i u dha kininizimit të popullit për të ndaluar hovin e sëmundjes nër ata që qenë prekur prej saj. Sasia (në kgr.) e kininës së përndarë për këtë qëllim në vitet e ndryshmë tregohet në pasqyrën që vijon:

1927	1928	1929	1930	1931	1932
193	205	255	188	209	270 (1)

Por një luftë serioze kundër malaries nuk munt të kufizohej vetëm me masa kurative (shëronjëse). Për të patur rezultate të vazhduarshme në përmirësimin e shëndetit publik duhëshin masa profilaktike, me fjalë të tjera duhej lëftuar dhe çfarosur agjenti përhapës i sëmundjes i cili, siç dihet, është mushkonja. Për të shtuar mjetet e nevojshme për këtë luftë Drejtoria jonë ndërhyri pranë qeverisë me propozimin që të kërkohej ndihma dhe bashkëpunimi i Fondacionit Rokfeller. Si përgjigjie kërkesës së qeverisë s' onë Fondacioni Rokfeller dërgoi në Shqipërí në Tetorin 1926 Z. Dr. L. W. Hackett që të bënte studimet paraprake mbi përhapjen e malaries në vëndin t' onë dhe të caktonte methodat më të mira për të lëftuar këtë sëmundje. Në përfundim të kësaj vizite dhe me interesimin e nxehtë të së ndjerës Lady Camarvon ashtu dhe të ministrit të Shteteve të Bashkuar Z. Charles C. Hart, Fondacioni Rokfeller autorizoi më 1927 Z. Dr. Hackett të themelojë një shërbim antimalarik në bashkëpunim me Drejtorinë t' onë. U-pranue propozimi që gjysma e spenzimeve e Shërbimit Antimalarik të paguhej prej qeverisë s' onë dhe gjysma tjetër prej Fondacionit Rockefeller, dhe në jenar të vitit 1929 u çelë dy stacionet e para antimalarike në Tiranë dhe në Durrës. Më 1930 u krijua stacion' i Elbasanit, më 1932 stacion' i Shkodrës dhe në funt

(1) Në këto sasira nuk hyn kinina e sjellë nga Spitalet e Dispanseritë me kreditin e tyre.

t' atij viti u vendos çelja e stacioneve të Vlorës dhe të Beratit. Programi i paskëtajmë parashikon çeljen e një ose dy stacioneve antimalarike në çdo vit, në mënyrë që të gjitha qendrat e prefekturave të kenë bazën e tyre të veçantë për të lëftuar malarien.

Kësisoj Sekcioni Antimalarik, si një degë e Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë, në stadën e sotme të organizimit të tij paraqitet si një institut i plotë i pajosur me të gjitha mjetet e nevojshme për të lëftuar malarien simbas methodave profilaktike të pranuara prej shkencës së sotme.

Elementi kryesor për organizimin e Sekcionit antimalarik është pregatitja e një personali mjekësor dhe teknik të specializuar. Prandaj Fondacioni Rokefeller përveç që dërgoi në Shqipërí një malariolog dhe një inxhiner specialist për kanalizimin e ujrave, caktoi dhe dy borsa të përvitëshme për specializimin e mjekëve dhe inxhinerëve shqiptarë pranë Stacionit Eksperimental Antimalarik të Romës. Deri tash tetë mjekë dhe një preparator teknik i laboratuarit kanë marë të tilla bursa (1).

Paralelisht me pregatitjen e personalit të specializuar u shvillua dhe organizimi i brëndëshmë i Sekcionit Antimalarik, i cili sot përmban një Degë Inxhinierie që pregatit planet për të çdukur folet' e mushkonjave dhe një Degë kërkimesh që studion mënyrën se si shumëzohen dhe përhapen mushkonjat (anofelet), bën klasifikimin e tyre dhe kërkon epidemiologjinë e sëmundjes. Kjo deg' e fundit ka dhe një stacion meteorologjik që shërben për të caktuar lidhjet midis klimës dhe shvillimit të mushkonjave.

2. - Methodat e punës

Methodat e punës që përdor Sekcioni ynë Antimalarik varet drejt për drejt nga qëllimi që ndjek. Ky qëllim është, siç e pamë, të lëftuarit e malarjes me masa profilaktike. Kjo domethënë se lëftohen shkaket e sëmundjes, ose më mirë faktorët që shkakëtojnë përhapjen e saj. Këta faktorë janë siç e dimë anofelet (mushkonjat) dhe ujrat e fjetura që shërbejnë si folé për shvillimin e anofeleve. Nuk mjafton të mjekohet një i sëmurë nga malarja me anë të kininës deri sa ay është në rezik të kafshohet prej mushkonjës dhe të infektohet rishtas. Prandaj mjekimi i atyreve që vuajnë nga malarja në formë kronike duhet të vejë baras me luftën për çdukjen e anofeleve, që kështu elementi i shëndoshë i popullsisë dhe sidomos brezi i rí të shpëtohet nga infektimi. Sekcioni Antimalarik me masat profilaktike që mer përpiqet t'i arrijë këtij qëllimi duke përdorur methodat më të reja që ka gjetur shkenca mjekësore deri sot.

Lufta kundër malarjes varet pothua krye këput nga lufta kundër anafeleve. Një njeri që arrin t'a mbrojë vehten nga thumbat e kësaj mize të rezikëshme ësht'i siguruar qint për qint kundër malarjes, Kështu që masat profilaktike kundër malarjes janë tri sojesh: 1) mbrojtja e banesave nga mushkonjat, 2) çfarosja e mushkonjave me mjete shimike dhe 3) çdukja e foleve ku shumëzohen dhe riten mushkonjat. Për sa i përket izolimit të banesave nga mushkonjat roli i Shërbimit Antimalarik kufizohet me propaganden në favor të mjeteve që shërbejnë për këtë qëllim. Por kjo mënyrë mbrojtjeje individuale lyp spenxime dhe munt të përdoret vetëm nëpër qytete ku arkitektura e banesave lejon një gjë të tillë. Kjo masë është fort e dobishme por jo e mjaftë me që agjentin përhapës të sëmundjes e lé të pa-prekur. Prandaj roli aktiv i Shërbimit Antimalarik fillon me pikën e dytë. Me çfarosjen e mushkonjave kuptohet shëmbja e larvave të tyre që lindin dhe riten (deri sa bëhen flutura) në ujrat e ndënjura. Për këtë qëllim përdoret një pluhur i gjelbër që quhet «vert de Paris» dhe ka një helm q'i ngordhë larvat e anofeleve. «Vert de Paris» përziehet me 99% pluhuri prej dheu dhe përhapet përmbi ujrat ku janë zbuluar folé larvash anofeli. Larva, e cila ron mbi cipën e ujit ushqehet me «vert de Paris» dhe ngordhë pas pakë orëve. Përdorja e «vert de Paris» është një masë radikale por ka një të metë: duhet hedhur kohë pas kohe po n'atë vent. Kjo vjen nga shkaku se larvat bëhen mush-

(1) Këta janë: Dr. Andon Asbta, Dr. Xhafer Kolli, Dr Hajrulla Harxhi, Dr. Musa Delvina, Dr. Lush Pogu, Dr. Balto Benushi, Dr. Hivzi Kasimati, Dr. Mihal Çaushi, Neki Radovicka (preparator teknik i laboratuarit).

konja në krye të 8 deri më 10 ditëve, prandaj çdo brez i ri larvash duhet ngordhur që posa ngjallet me një dozë të ré «vert de Paris».

Pa dyshim masa më radikale për të lëftuar malarjen është çdukja e foleve ku ngjallen dhe riten mushkonjat. Kjo bëhet duke tharë këneta e moçale, duke regulluar kursin e lumenjve, duke mbushur çdo gropë ku munt të mblidhen ujra gjithfarësh. Këtej rjeth se lufta për të çdukur folet'e mushkonja ndahet në disa etape. Janë disa masa elementare që munt të merren menjëherë dhe me fare pak spenxime. Këtu hyjnë mbushja e gropave që çelen për të fabrikuar tjegulla, për të shuar gëlqere etj., pastrimi i vijave të mullinjve, i vijave që çelen për të vaditur kopshtet, orizoret etj., k»nalizim'i ujrave që dalin nga burimet, me një fjalë çdukja e çdo pellgu që munt të shërbejë si folé për larvat e anofeleve. Pastaj vinë masat që lypin punë të gjatë dhe spenxime të mëdha.

Këto janë masa që kanë një karakter përmirësimi nga pikëpamja bujqësore. Këtu hyjnë: tharja e këneta e dhe moçaleve me anë të kanalizimit ose drenazhit, regullimi i rjedhjes së lumënjve të mëdhenj për të ndaluar mbytjen e fushave dhe formimin e pellgjeve të përkohëshmë në stinën e shirave. Pa dyshim çdukja radikale e malarjes në Shqipëri është lidhur me realizimin e këtyre veprave të mëdha që lypin kohë dhe mjete. Por kjo nuk dome-thënë se malarja nuk munt të lëftohet me mjetet që kemi sot. Eksperienca e gjertanishme na provon se duke kombinuar masat që nëmëruam më sipër, shëmbja e larvave me «vert de Paris» nga një anë dhe disa drenaxhe të vogla e të mesme reth qyteteve nga ana tjetër, munt t'arrihen rezultate fare të mira.

Aktiviteti i Sekcionit Antimalarik është organizuar duke u bazuar mbi kriteret që parashtruam më sipër, domethënë të shfrytojë në shkallën më të madhe posibilitetet që janë sot për të lëftuar malarjen në Shqipëri. Me të instaluar në qendrën e një zone malarike, Stacioni Antimalarik bën një kartë topografike që përfshin një zonë periferike tri kilometrash reth qendrës së banuar; kjo zonë llogaritet duke filluar nga banesat më të largme të qendrës së banuar. Në kartën topografike shënohen një nga një dhe me precizionin më të math të gjitha foletë ku riten larvat e anofeleve. Në bazë të këtyre kartave që përpillohen për çdo zonë malarike Sekcion'i inxhenierave pregatit projektet për çdukjen e foleve anofelash me sistemin më të përshtatshëm për çdo rast: drenazhë kur janë këneta, kanalizim kur janë ujëra rjedhëse, mbushje kur janë moçale të vogla. Për deri sa këto projekte vihen në zbatim, Sekcioni operativ organizon shëmbjen e larvave anofelike duke përdorur «vert de Paris». Për këtë qëllim zona ndahet në 8 deri më 10 pjesë. Në çdo pjesë hyn një ose më tepër fole anofelash, të cilave për të lehtësuar punën u vihet nga një emër. Çdo ditë vizitohet një pjesë e zonës prej punëtorëve që hedhin «vert de Paris» nër foletë anofelash. Kësisoj çdo foleje mushkonjash malarike i bie një kontrollim krye 10 ditëve. Kjo është'e domosdoshme me që në funt të 10 ditëve larvat bëhen fluturake dhe dalin nga uji. Këtu duhet vënë ré një pikë. Nga 5 lloje anofelash që janë zbuluar gjer më sot në Shqipëri vetëm 3 lloje janë agjentë transportonjës të mikrobit të malarjes nga i sëmuri tek i shëndoshi. Mbi gjithë llojet e anofelave efekti ngordhës i «vert de Paris» është'i sigurt dhe i shpejtë. Përkundrazi mbi një lloj mushkonjash që quhet «Culex» helmi «vert de Paris» s'ka asnjë efekt. Culex-i shvillohet në çdo farë uji por sidomos afër banesave, me që nuk ka fuqi të fluturojë lark. Me gjithë se i padëmshëm nga pikëpamja e shëndetit, ky lloj mushkonjash bën më tepër përshtypje në popull, sidomos pse, po të mos lëftohet, shumëzohet me një shpejtësi të habitëshme. Culex-i munt të lëftohet fare lehtë prej banorëve të çdo shtëpie duke hedhur vajguri regullisht në krye të dhjetë ditëve mbi nevojtoret e çelura, pusët me ujra të ndyra, voze me ujë shiu të ndënjur etj.

Në një kohë me pregatitjen e projekteve për çdukjen e foleve anofelash, çdo Stacion antimalarik organizon këqyrjen sistematike të popullsisë për të caktuar se sa është përhapur malarja në zonën q'i përket. Rezultatet e hetimeve midis popullsisë regjistrohen regullisht për çdo qendër të vizituar dhe për çdo vit. Për çdo njerí që vizitohet prej mjekëve t'anë kemi një karnet të posaçmë ku shënohet gjendja e shpretkës së tij dhe rezultat'i analizës së gjakut të tij. Në bazë të këtyre dateve bëjmë dy indekse: Indeksin Splenik, që tregon se në ç'proporcion popullsia e një qyteti ose katundi ka shpretkën të zmadhuar nga malarja; Indeksin Parazitar, që tregon se sa për qint nga popullsia e një vëndi kanë

në gjakun e tyre parazitin (mikrobin) e malarjes. Duke vazhduar përpillimin e këtyre dy indekseve për disa vjet me radhë munt të caktojmë me një mënyrë fare të sigurtë evolucionin e malarjes në çdo qendër ose zonë ku shvillohet aktiviteti i Sekcionit Antimalarik. Baras me statistikën e evolucionit të malarjes në mes të popullit, në bazë të indekseve splenik e parazitar, bëjmë edhe diagramet që tregojnë pakësimin e regullshëm vit pas viti të anofeleve që shvillohen në viset ku është organizuar lufta kundër malarjes. Fundi, Dega e Kërkimeve, e cila ësht' e pajosur me tërë veglat e nevojshme dhe mbahet krejt prej Fondacionit Rockefeller, merret me studimin dhe klasifikimin e mushkonjave që përhapin malarjen, ashtu dhe me studimin e epidemiologjis së kësaj sëmundjeje.

3. - Veprimet e Stacioneve Antimalarike në qarket e ndryshme.

A) – TIRANË

Qyteti i Tiranës shtrihet mbi një fushë të qarkuar nga të gjitha anët prej malesh dhe prej një vargu të gjatë kodrinash. Në pjesën Veri-Perëndimore kalon lum' i Tiranës në të cilin shvillohet lloji mushkonjash Superpictus (agjent përhapës i malaries); në pjesën Jugo-Lindore gjarpëron Lana, e cila i shkon qytetit për qark dhe vetëm'në dy vënde (Lagj'e Tabakëve dhe Tirana e Ré) i kalon përmes. Në qytetin e Tiranës dhe në një zonë tri kilometrash reth e rotull ndeshen të gjitha tipet e foleve për larva mushkonjash. Pik së pari në periferit dhe brënda në qytet gjenden më tepër se 300 gropa të çelura për tjegulla dhe të regjistruara si benesa larvash. Pastaj vinë një seri përonjsh si ay i Reçës, i Çezmës së thatë, i Husajt, i Selitës, dhe shumë burime si Kroj' i Shën Gjinit, Brakat e Petrelës etj. Pesë kilometra jashtë qytetit shtrihej këneta e gjerë e katundit Izberish. Të gjitha këto kanë qënë, dhe pjesërisht janë edhe sot, folé natyrale për larvat e anofelit Maculipennis (edhe ky lloj i rezikshëm). Përveç këtyre burimeve periferike dhe natyrale përhapja e malaries në qytet ka edhe shumë shkake që rjedhin nga mënyra e rojtjes dhe të punimit. Në këtë kategorí hyjnë: vijat e mullinjve, vaditja e tokës dhe grumbullim' i ujit të shiut për nevoja shtëpiake. Uji që shërben për mullinjt' e qytetit merret prej lumit të Tiranës dhe kalon nëpër tri vija kryesore, të cilat kanë edhe disa degë. Me qënë se kanalet nuk pastrohen hohë pas kohe ujët del jashtë vijës dhe mbush të gjitha gropat që janë çelur për gurore prej sipërmarrësve të ndryshmë, duke formuar pellgje uji t' ëmbël që janë banesa ideale për larvat e mushkonjave. Prapë nga këto vija merret uji për vaditje tokash. Kjo bëhet në një mënyrë kaqë primitive sa shkakton formimin e pellgjeve të vegjël, të cilët transformohen menjëherë në folé anofelash. Vijat ku kalon uji për vaditje zihen me plisa e barishte, kësisoj pritet rjedhja e ujit dhe anës vijës krijohen folé larvash.

Sapër Cullex-in dhe shumë llojeve të tjera kësodore, që nuk janë të dëmshme nga pikëpamja e malaries por vetëm të mërzitëshme, këto shvillohen nga pakujdesia e popullit. Folet' e Cullex-it dhe të llojeve analoge janë nevojtoret e çelura, vozet që mbushen me ujë shiu për të larë tesha dhe lihen të zbuluara nëpër hoborë, ujrat që mblidhen më një vënt nga të larit e lëvereve dhe që nuk kanë se ku derdhen, sifonat e kanaleve nëpër rugët etj.

Ato disa masa elementare që mjaftojnë për të çdukur mushkonjën «Cullex» dhe tipet q'i përgjasin, duhet të merren prej popullit dhe prej Bashkive. Për këtë nuk duhet gjë tjetër veçse të regullohen pikat që numëruam më sipër. Lufta kundër mushkonjave që nuk ngjisin malarien dhe që folet' e tyre i kanë nëpër hoboret e shtëpive dhe rugët e qyteteve nuk hyn në rethin e aktivitetit të Sekcionit Antimalarik, i cili tërë energjinë i a kushton çfarosjen së anofeleve malarie-ngjitëse. Për sa i përket Tiranës kemi pregatitur dy karta topografike nga të cilat njëra tregon të gjitha folet' e mushkonjave që përhapin malarien në një zonë tre kilometrash reth qytetit dhe në tjetrën tregohet tërë sistemi i vaditjes së tokave brënda kësaj zone. Që kur se kemi filluar nga puna shpërndarja e «vert de Paris» në të gjitha foletë anofelike në zonën 3 kilometrash reth Tiranës është bërë regullisht

në çdo 10 ditë. Rezultatet e këtij veprimi që po vazhdon qysh katër vjet nuk kanë munguar të çfaqen menjëherë. Për sqyrtimet e Degës së kërkimeve kemi zënë mushkonja regullisht çdo javë me anë të veglave të posaçme dhe në vënde të ndryshme të qytetit.

Në diagramën Nr. 3 duket qartas se si pakësohet nga viti në vit dhe me një shpejtësí të jashtëzakonëshme sasia e mushkonjave që janë kapur. Kaptim'i mushkonjave fillon në prenverë dhe mbaron në vjeshtë. Në çdo vit ka një javë kur numr'i mushkonjave që janë zënë arrin cifrën maksimale. Kjo cifër vete duke u pakësuar me një shpejtësí të madhe nga viti në vit, sikundër duket nga pasqyra që vijon:

Prej 11 më 17 Gusht	1929	janë zënë	2637	mushkonja
» 20 » 26 Korrik	1930	» »	743	»
» 21 » 27 Qërshor	1931	» »	73	»
» 26 Qer. më 2 Kor.	1931	» »	52	»

Po të marrim cifrën e vitit 1929 për 100 do të gjejmë se më 1932 janë kapur një sasi mushkonjash që arrijnë 2 për qint të cifrës së vitit 1929. Kjo tregon sheshit se është pakësuar përgjithërisht sasia e mushkonjave që janë ngjallur në folet'e ndryshme. Kesisoj pakësimi i malarjes që konstatuam në pjesën e parë lidhet drejt për derjt me pakësimin e agjentit përhapës të kësaj sëmundjeje.

Tirana na paraqet shëmbëllën klasike të luftës antimalarike të shvilluar pas sistemit t'etapeve që përshkruam në fillim. Kur nisëm nga puna energinë më të madhe i a kushtuam mbytjes së larvave, prandaj sasia e «vert de Paris» që përdorej në fillim ishte mjaft e madhe. Mirëpo në këtë koh'e sipër Dega e Inxhinjerave pregatiti një serí projektesh drenazhi, të cilat u vunë një pas një në zbatim. Kështu që sasia e «vert de Paris» të përdorur vate duke pakësuar më një shpejtësí të madhe. Punët më me rëndësí të kryera prej Inxhenierave në qarkun e Tiranës janë: 1) Te sistemuarit e burimeve të Krojit të Shën Gjinit, 2) bonifikim'i kënetës n'Izberish me një sipërfaqe prej 400 hektarësh. Përveç kësaj është regulluar gërmim'i gropave për çelje tjegullash; me këtë mënyrë janë çdukur 390 folé anofelesh. Pronarët kanë që-në të detyruar të pastrojnë regullisht me drënazhe kanalet që kalojnë nëpër tokat e tyre. Ushtëria ka dhënë ushtarë për hapjen e hendeqeve për drenazhe në sipërfaqen përqark kazermave.

Rezultatet e punës që kemi bërë gjer tani kanë qënë mjaft të mira, sikundër shifet nga Indekset Splenik e Parazitar të bërë me materialin e mbledhur mbi nxënësit e shkollave (djem e vajza) gjer më 12 vjeç. Indeksi splenik tregon gjëndjen e shpretkës. Smadhim'i këtij organi është shënja e malaries kronike nër fëmijë t'infektuar me kohë; grada e smadhimit deften gradën e keqësimit të sëmundjes. Të gjeturit e parazitëve të malaries (Indeks parazitar) në gjakun e fëmijëve që duken të shëndoshë tregon një infektim të rí e të ashpër (aigu) në popullsin'e një vëndi.

PASQYRA E INDEKSIT SPLENIK NËR FËMIJËT E TIRANËS

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	1069	1000	1000	1009	1000	1000	1000	1000
Prej tyre: *fëmijë me shpretkë të smadhuar*	350	385	340	275	274	173	208	164
fëmijë me shpretkë normale (o) .	619	615	660	725	726	827	792	836
fëm. me shpretkë shumë të madhe	24	9	5	3	3	1	—	—

Po të marrim numrin e fëmijëve t'ekzaminuar në çdo stinë për 100 do të gjejmë se përqindja e fëmijëve më shpretkë të smadhuar është pakësuar regullisht:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	100	100	100	100	100	100	100	100
Përqindja e fëmijëve me shpretkë të smadhuar . .	42	38	34	28	27	17	21	16

Në katër vjet përqindja e fëmijëve me malarie kronike ka zbritur nga 42 në 16%. Po të marrim parasysh se fëmijët janë elementi më sensibël, munt të themi me siguri të plotë se ky pakësim kap tërë popullsin' e Tiranës.

Rezultatet e sipërme konfirmohen edhe me Indeksin parazitar që parashtrohet më poshtë:

PASQYRA E INDEKSIT PARAZITAR NË FËMIJVËT E TIRANËS

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	1069	1000	1000	1000	1000	1000	1000	1000
Prej tyre: *fëmijë me parazit në gjak*	138	80	55	77	20	30	7	—

Fëmijët me parazit në gjak ndahen pas formës së sëmundjes në tri kategorí:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Fëmijë me malarie: *Terzana* (T)	25	21	23	19	1	7	3	—
Verore-Vjeshtore (E-A) . .	106	54	21	55	11	20	3	—
Quartana (Q)	7	5	1	3	8	3	1	—
Shuma	138	80	55	77	20	30	7	—

Po të marrim numrin e fëmijëve t'ekzaminuar për 100 do të gjejmë se përqindja e fëmijëve t'infektuar pakësohet regullisht:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	100	100	100	100	100	100	100	—
Përqindja e fëmijëve me parazit në gjak	13	8	5	8	2	6	2	—

Edhe këtu përqindja e fëmijëve me parazit në gjak zbret në katër vjet nga 13% deri më 2%. Cifrat flasin vetë, komentet mundin vetëm t'a dobësojnë efektin e tyre.

Për të çdukur edhe një nga faktorët më kryesorë të përhapjes së malarjes në Tiranë duhet regulluar çështja e vaditjes së tokave, në mënyrë që të mos i japë shkak formimit të foleve për ritjen e larvave anofelash.

B) — DURRËS

Qyteti i Durrësit shtrihet pjesërisht mbi fushë dhe pjesërisht mbi kodrina. Nga Perëndimi është'i rethuar prej detit, nga Veri-Lindja prej Liqenit të Durrësit dhe fushës së Shkozës. Shkaku i parë i përhapjes së malarjes është liqeni, i cili shtrihet mbi një sipërfaqe mjaft të madhe dhe vështirson luftimin e sëmundjes. Pastaj vjen Fusha Shkozet me gropat e shumta ku larvat e anofelave gjejnë lehtësi banese dhe shvillimi. Fundi, si folé larvash shërbejnë edhe moçalet gjatë bregut të detit. Në kartat që janë pregatitur dhe që përfshijnë hinterlandin e Durrësit me gjithë liqenin deri në Porto Romano, folet'e anofelave figurojnë pa asnjë përjashtim. Mushkonjat më të rezikëshme që janë gjetur në këtë qark janë: A. Elutus, që shvillohet veçanërisht në liqenin e Durrësit ku uji përmban gjer më 18,5 për mijë kripë, A. Maculipennis që shvillohet ndër ujra t'ëmbla të pellgjeve në Shkozet dhe ndër kanale që janë çelur gjatë rugëve.

Si dhe në viset e tjera, pun'e parë që është bërë ka qënë të hedhurit e pluhurit «Vert de Paris» në të gjitha foletë anofelash për katër vjet resht. Ky operacion është zbatuar në stinën e shvillimit të mushkonjave dhe çdo folé larvash është pluhuruar regullisht në krye të 10 ditëve. Numri i mushkonjave është pakësuar për së tepërmi në qytetin e Durrësit. Kjo shihet në diagramën Nr. 4 dhe në pasqyrën që vijon, ku tregohet për çdo vit numri maksimum i mushkonjave të zëna brënda 1 javë në dhjetë banesa e grazhde. Mushkonjat janë zënë me vegla të posaçme dhe me qëllim që të sqyrtohen.

Prej	14	më	20	Korrik	1929	janë zënë	19.400 mushkonja
»	24	»	30	Gusht	1930	» »	7.055 »
»	21	»	27	Qershor	1931	» »	2.250 »
»	3	»	9	Korrik	1932	» »	2.575 »

Nga 1929 më 1932 pakësimi 87%.

Hedhje e pluhurit «Vert de Paris» me dorë mbi të gjithë sipërfaqen e liqenit të Durrësit nuk ka qënë e mundur të kryhet. Për këtë punë duhet një aeroplan.

Dega e Inxhinierave ka pregatitur dhe vënë në zbatim tre projekte që kanë për qëllim çdukjen e riprodhimit të mushkonjave malarja ngjitëse në rethet e Durrësit. Këta janë:

1) Mbushja e moçalës anës detit nënë Vilën Mbretnore.

2) Tharja e mbushja e shumë pellgjeve në Shkozet.

3) Bashkim'i liqenit me detin në Porto Romano me anën e një kanali 2 km ½ të gjatë dhe 3 metra të gjerë. Këtu qëllimi ka qënë të shtohet sasia e kripës në ujët e liqenit përmbi 18,5 për mijë, në mënyrë që larvat e anofelit Elutus të mos munt të shvillohen. Në verën e vitit 1932 janë vënë në këtë kanal dyer automatike me qëllim që ujët e detit të munt të hyjë në liqen në kohën e lartësimit por të mos mundë më të dalë s'andejmi kur deti është'i qetë. Duke u shtuar ujët e kripur në gjol shpresohet se bimët (vegjetacioni) do të çrënjosen, kështu që larvat e mushkonjave nuk do të mundin të mprohen nga era dhe valët dhe do të mos munt të qëndrojnë deri në shvillimin e tyre të plotë.

Rezultatet e punës së kryer duken pjesërisht që tani, por efekti i veprës s'inxhenierave do të duket plotërisht duke filluar nga viti që vjen.

Indeksi splenik që biem më poshtë na jep një idhé të saktë mbi rezultatet e gjertanishme të luftës antimalarike në qarkun e Durrësit.

PASQYRA E INDEKSIT SPLENIK NËR FËMIJËT E DURRËSIT

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	328	531	510	648	552	590	585	843
Prej tyre: *fëmijë me shpretkë të smadhuar*	149	174	147	233	160	160	173	189
fëmijë me shpretkë normale (0) .	179	375	362	415	392	429	412	654

Fëmijt me shpretkë jo normale ndahen në mënyrën që vijon:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Fëmijë me: *shpretkë të vogël*	81	106	90	141	93	69	109	70
Shpretka të mesme (1-2) . .	51	64	53	91	66	91	64	119
Shpretka shumë të mëdha .	17	4	4	1	1	0	0	0
Shuma	149	174	147	233	160	160	173	189

Po të marrim numrin e fëmijëve t'ekzaminuar në çdo stinë për 100 do të gjejmë se përqindja e fëmijëve me malarje kronike kafilluar të pakësohet me një rithmë mjaft të shpejtë:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	100	100	100	100	100	100	100	100
Përqindja e fëmijëve me shpretkë të smadhuar .	45	33	29	36	29	27	30	22½

PASQYRA E INDEKSIT PARAZITAR NËR FËMIJËT E DURRËSIT

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	328	531	510	648	552	192	292	—
Prej tyre: *numr i fëmijëve me parazit në gjak* . .	44	52	27	116	44	35	12	—
Numr' i fëmijëve pa parazit në gjak	284	479	483	532	408	257	280	—

Fëmijët që kanë parazit në gjak ndahen në tri kategorí pas formës së malarjes:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë
Fëmijë me malarie: *Terzanà* (T)	7	10	17	38	3	11	4	—
Verore-Vjeshtore (E-A) . .	37	42	10	76	37	20	4	—
Quartana (Q)	0	0	0	2	4	4	4	—
Shuma	44	52	27	116	44	35	12	—

Po të marrim për 100 numrin e fëmijëve t' ekzaminuar në çdo stinë përqindja e fëmijëve me parazit në gjak ka për të qënë:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	100	100	100	100	100	100	100	—
Përqindja e fëmijëvet me parazit në gjak	13%	9%	5%	18%	8%	6%	4%	—

Krahasimi i ndekseve splemik dhe parazitar për Durrësin na jep rastin të bëjmë disa vërejtje me rëndësí. Pas Indeksit splemik përqindja e fëmijëve me shpretkë të madhuar ka zbritur në katër vjet (1929—1932) nga 45% gjer më 22½ %, domethënë është pakësuar gjysmë për gjysmë, kurse përqindja e fëmijëve me parazit në gjak ka zbritur po n' atë kohë nga 13% në 4%, domethënë ka mbetur afro një e treta. Kjo provon se me masat që janë marrë të sëmurët e infektuar për herë të parë pakësohen më shpejt se ata që vuajnë nga malaria kronike.

QENDRA E SEKCIONIT ANTIMALARIK NË TIRANË

DEGA E KËRKIMEVE

LABORATUARI

PREGATITJA E PLUHRIT «VERT DE PARIS»

Gjendja e burimeve të Krojit të Shën-Gjinit para sistemimit

Kroj' i Shëngjinit pas sistemimit

Nji grup punëtorësh që po çelin kanalin e kënetës n' Izberish

Rjedhja e ujit në kanalin e kënetës n' Izberish

Një nga gropat e mbëdha në Shkozet

Kanali i daljes prej Shkozet në det

Instalimi i qyngjeve dhe i dyerjeve automatikë në kanalin e Porto Romanos

Pamj' e kanalit që bashkon liqenin e Durrësit me detin

PKSH

c) — ELBASAN

Qytet' i Elbasanit është ngrehur mbi një fushë të rethuar nga të tri anët me male e kodrina. Nga Juga i kalon Shkumbini, në Veri proj' i Zaranikës, në Lindje ay i Manasdeirit dhe në Perëndim, pakë jashtë zonës 3 kilometrash, proj' i Kushit. Prej Veri-Lindje në Jugë-Perëndim shtrihet zona e fushave t' orizit. Këto bien afër qytetit dhe janë punuar pas një sistemi të dëmshëm për higjienën publike, sidomos nga pikëpamja e malaries, mbassi janë një folé e dorës së parë për shvillimin e larvave anofelesh.

Një kanal i çelur sjell në qytet ujët për të pirë, dhe çdo lagje ka një ose dy kronj uji të pijshëm. Uj' i këtyre kronjve rjeth ku mundet dhe formon kanale të hapurë, të cilët përhapen nëpër rugët e qytetit dhe bashkohen më kanale të tjerë të çelur për të sjellë ujë nga lumenjtë dhe përronjtë me qëllim vaditjeje. Uj' i këtyre kanaleve futet në të gjitha lulishtet, të cilat janë të shumta n' Elbasan, dhe shkon e derdhet në Shkumbin ose në Zaranikë.

Përgjithërisht trolli mbi të cilin është ngrehur qyteti është pakë në tatëpjetë dhe uji gjen lehtësi në rjedhjen. Por nga një herë mbetet i ndaluar nga vagjetacioni (bimët) i math.

Bashkë me lumin dhe përronjtë kanalet janë burimet kryesore për shumëzimin e mushkonjave.

Duke pasur për qëllim të fillojë nga puna më 1930 Sekcioni ynë Antimalarik ka bërë n' Elbasan më 1929 një studim preliminar duke bërë hetime mbi zonën e malaries dhe përhapjen e saj në popull.

Janë pregatitur dy karta nga të cilat njëra tregon vëndet e foleve anofelesh brënda rëzës së tre kilometrave duke filluar nga shtëpí e fundit, dhe tjetra sistemin e vaditjes brënda kësaj zone. Mbjellja e orizit brënda zonës së tre kilometrave nga qyteti është ndaluar. Është caktuar që në zonën nga 3 deri më 6 kilometra lark qytetit fushat e orizit të vaditen vetëm 10 ditë në çdo dy javë, në mënyrë që të lihen 4 ditë për të tharë dhe kështu të mos munt të shvillohen mushkonjat.

Mushkonjat e rezikëshme n' Elbasan janë: 1) *A. Maculipennis* e cila ritet në fushat e orizit, në moçale dhe në hendeke vaditëse, 2) *A. Superpictus* që gjëndet më tepër në lumin Skumbin.

Hedhja e «vert de Paris» është' organizuar dhe vënë në vepërim regullisht për tre vjet resht.

Nga thatësir' e madhe më 1931 uj' i Shkumbinit qé pakësuar në një shkallë q' e vështirsonte tepër kontrollimin e larvave. Për këtë arësye nuk ndodhi nonjë pakësim i dukshëm në sasin' e larvave dhe indekset splenik e parazitar që sjellim më poshtë nuk tregojnë një pakësim të malaries n' Elbasan aqë të fortë sa në Tiranë e në Durrës.

PASQYRA E INDEKSIT SPLENIK NËR FËMIJË T' ELBASANIT

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	—	742	749	796	903	838	850	1000
Prej tyre: *fëmijë me shpretkë të madhuar*	—	499	501	580	554	498	519	504
Fëmijë me shpretkë normale	—	243	248	216	349	240	331	496

Fëmijët me shpretkë të prekur nga malaria ndahen si vijon:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Fëmijë me: *Shpretkë të vogël*	—	174	250	262	260	172	114	119
Shpretkë të mesme (1-2) . .	—	242	221	296	268	292	396	377
Shpretkë shumë të madhe . .	—	83	30	22	26	34	9	8
Shuma	—	499	501	580	554	498	519	504

Po të marrim numrin e fëmijëve t'ekzaminuar në çdo stinë për 100, si përqindje të fëmijëve me shpretkë të smadhuar do të gjejmë:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	—	100	100	100	100	100	100	100
Përqindja e fëmijëve me shpretkë të smadhuar . .	—	67%	67%	73%	61%	60%	61%	50%

BIBLIOTEKA

PASQYRA E INDEKSIT PARAZITAR NËR FËMIJËT E ELBASANIT

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	—	742	749	796	903	418	425	—
Numr' i fëmijëve me parazit në gjak	—	187	76	174	84	81	28	—

Fëmijët me parazit në gjak ndahen pas formës së malaries në mënyrën që vijon:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Fëmijë me malarie: *Terzana* (T)	—	53	53	42	12	12	7	—
Verore Vjeshtore (E-A) . .	—	132	23	121	55	66	19	—
Quartana (Q)	—	2	—	11	17	3	2	—
Shuma	—	187	76	174	84	81	28	—

Po të marrim numrin e fëmijëve t'ekzaminuar në çdo stinë për 100, si përqindje të fëmijëve me parazit në gjak do të gjejmë:

OBJEKTI	1929		1930		1931		1932	
	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë	Prenv.	Vjeshtë
Nri i fëmijëve t'ekzaminuar	—	100	100	100	100	100	100	—
Përqindja e fëmijëve me parazit në gjak	—	25%	10%	22%	9%	19%	7%	—

Vepërimet e ardhëshme të Sekcionit Antimalakrik n'Elbasan do të shvillohen reth ndreqjes së sistemit të vaditjes dhe një pluhurimi më intenziv të Shkuminit me «Vert de Paris».

Duke marrë parasysh se fëmija janë elementi më sensibël, munt të themi se pakësimi që konstatohet më sipër përfshin tërë popullsinë.

SHËNIME TË PËRGJITHËSHME

Vërejtjet që janë bërë gjer tani nga an'e Sekcionit Antimalarik nër qytetet e tjera të Shqipërisë tregojnë se malarja është'e përhapur shum'a pakë në të gjitha prefekturat.

Lista që vjen më poshtë tregon se sa për qint nga fëmijët e vizituar në çdo qytet kanë malarje kronike (Indeks splenik — shtylla e IV) dhe sa për qint kanë malarje të ré (Indeks parazitar — shtylla e V).

QYTETI	STINA	VJETI	Përqindsh'i shpetkavetë zmadhuara	Përqindshi parasitàr i poz tivëve t'ekzaminuar
Korçë	Vjeshtë	1930	25%	8½%
Shkodrë	Vjeshtë	1931	29%	7%
Berat	Vjeshtë	1931	74%	19%
Lushnjë	Vjeshtë	1931	59%	14%
Lesh	Vjeshtë	1931	75%	24%
Krujë	Vjeshtë	1931	14%	5%
Vlorë	Vjeshtë	1931	81%	17%
Shjak	Vjeshtë	1931	51%	11%
Kavajë	Vjeshtë	1931	53%	10%
Gjinokastrë	Vjeshtë	1931	21%	—
Peqin	Prenverë	1932	82%	10%
Delvinë	Prenverë	1932	43%	4%
Fier	Prenverë	1932	56%	5 %
Sarandë	Prenverë	1932	45%	5%
Pogradec	Prenverë	1932	8%	2%

Pasqyra e sipërme ashtu dhe tabela Nr. 16 vërtetojnë në vijat e përgjithëshme rezultatet e tabelës Nr. 15, mbi të sëmurët e mjekuar në çdo prefekturë.

Vepra antimalarike në Shqipëri ka tërhequr vërejtjen e Malariologëve të Shtetëve të tjera dhe vizitorë të ndryshëm, siç e tregon lista më poshtë, kanë ardhur në Shqipëri për të këqyrur prej së afërmi masat që po merren:

Dr. C. W. Wenyon, Drejtor'i Laboratuarit të Kërkimeve Welcome (London).

Sir Malcom Watson, Malariolog i Institutit ROSS (London).

Dr. M. C. Balfour, Malariolog i Departamentit Kombëtar të Shëndetësisë në Greqi.

Dr. R. K. Collins, Drejtor i Stacionit Rockefeller të Malarjes në Bullgari.

Dr. Livadas, i Departamentit Kombtar të Shëndetësisë në Greqi.

Dr. Simiç, Malariolog i Institutit të sëmundjeve Tropikale në Shkup.

Dr. Turcu, Malariolog në Cluj, (Rumani).

Dr. Abdurrahim Rifat, Shef'i luftimit antimalarik në Brusë (Turqi).

Dr. W. C. Washburn, i Drejtorisë P. të Shëndetësisë, Jamaica.

Prof. Dr. Eric Martini, Entomolog i Institutit të sëmundjeve tropikale në Hamburg (Gjermani).



SEKSIONI ANTIMALARIK
QENDRA - DURRËS

Pasqyra katërvjetore e kaptimit mushkonjave

BKSH


2500
2000
1500
1000
500
400
300
200
100
1929
1930
1931
1932
SEKSIONI
ANTIMALARIK
QENDRA
TIRANË
Pasqyra
katërvjetore e
kaptimit
mushkonjave
JAVË Nr. 1 2 3 4 5 10 15 20 25 30 35 40 45 50 53

BKSH

TABELA Nr. 16



Përqindshi i shpnetkave të smadhueme nder fëmij të shkollave prej 4 deri 12 vjetshë të vizituem rrokull tri vjetve (1929-32) të luftimit antilarvuer në Tiranë, Durrës, Elbasan.

1. *Vlorë*
2. *Peqin*
3. *Lezhja*
4. *Berat*
5. *Lushnja*
6. *Fjer*
7. *Kavajë*
8. *Shijak*



9. *Sarandë*
10. *Delvinë*
11. *Shkodër*
12. *Korçë*
13. *Gjinokastër*
14. *Kruja*
15. *Pogradec.*

Nji pasqyrë e përqindjes t'infektimit malarik në qytete të ndryshme në 1931

BASH

VIII. — MJEKËT SHETITËS DHE LUFTA KUNDËR SËMUNDJEVE TË TJERA ENDEMIKE: SIFILIS, TUBËRKULOZË

Sistem'i mjekëve shetitës u krijua me qëllim që organet e Shëndetësisë të arrijnë deri në katundet më të largmë nga çdo qendër. Deri sot kemi mjekë shetitës, të cilët janë përndarë në mënyrën që tregohet në kartën Nr. 2. Viset që hyjnë në zonën e aktivitetit të mjekëve shetitës janë: Puka, Mirdita, Gramshi, Shpata, Myzeqeja, Himara, Kurveleshi etj.

Pas regullores që është në zbatim çdo mjek shetitës ka një qendër banese ku ndodhet dhe një ambulancë për t'ekzaminuar të sëmurët e vobektë që paraqiten dhe për t'u ndarë barna gratis. Mjekët shetitës detyrohen të shetisin 'qarkun e tyre të paktën 15 ditë në çdo muaj dhe të vizitojnë regullisht të gjitha katundet. Në çdo katund që vizitojnë mjekët shetitës kanë për detyrë kryesore të këqyrin, herë pas here, të gjithë nxënësit, t'u shpërndajnë kininë dhe t'i shënojnë në rast nevoje, ashtu dhe t'u bëjnë mësonjësve porosit'e nevojshme për higjieniën e shkollave. Gjith'ashtu mjekët shetitës kanë për detyrë të shikojnë me kujdesjen më të madhe gjithë banorët e çdo katundi që vizitojnë. Kjo pikë ka rëndësinë më të madhe sidomos për sa i përket sifilizit. Siç dihet në disa vise të Shqipërisë sifilizi është'i përhapur në formë hereditare. Kjo gjë është'e rezikëshme sidomos pse sjell me vehte çkatërrimin e racës. Prandaj porosija m'e madhe q'u bëhet mjekëve shetitës është që, kur konstatojnë një të sëmurë nga sifilizi t'a shënojnë në një regjistër të posasme, duke i a bërë të njohur kryeplakut të katundit dhe komunës së vëndit. Kur i sëmuri nga sifilizi është në periudën ngjitëse, mjeku shetitës e drejton për mjekim në spitalin ose dispanserinë më t'afërme. Në rast se i sëmuri nuk paraqitet në vëndin q'i caktohet, mjeku shetitës lajmëron post-komandën e vëndit për t'a dërguar me përdhuni. Sifilitikët në periudën terciare mjekohen në vënt prej mjekut shetitës. Ky sistem ka dhënë rezultate të çmuarshme duke na dhënë posibilitet të zbulojmë disa folé sifilitikësh, të cilat gjer die ishin lënë fare në heshtje. Sasia e barnave antisifilitike që janë përdorur në këto 6 vjetët e fundit na jep një idhé të kjartë mbi punën që është kryer.

Midis të tjerave mjekët shetitës kanë për detyrë të përpiqen të gjejnë shkakun e vdekjeve, sidomos nër foshnja. Gjith'ashtu mjekët shetitës duhet të mbledhin me kujdes informata mbi numrin e lindjeve dhe t'ia komunikojë Drejtoris s'onë.

Kështu që kompletim'i rjetës së mjekëve shetitës dhe organizimi më mirë i aktivitetit të tyre, do të na japin lejë të mbledhim informatat më të plota, në mënyrë që Statistika e Drejtorisë s'onë të jetë sa munt m'e mbaruar.

Lista e mjekvet në Shqipni më 1932

Nr. Rend.	EMNI E MBIEMNI	Cilësija	Vent-banimi	Vërejtje
1	Dr. Osman Jonuzi	Drejtor i P. i Shëndetsis	Tiranë	
2	» Beqir Puto	Inspektor' i ,,	,,	
3	» Sabri Tefiku	Mjek i Spit. P. „Zog il“	,,	
4	» Janko Teodosi	,, ,, ,, ,, ,,	,,	
5	» Vasil Laboviti	,, ,, ,, ,, ,,	,,	
6	» Kristo Kristidhi	,, ,, ,, ,, ,,	,,	
7	» Besim Zyma	,, ,, ,, ,, ,,	,,	
8	» Jorgji Jorgoni	,, ,, ,, ,, ,,	,,	
9	» Stefan Pano	,, ,, ,, ,, ,,	,,	
10	» Ismajl Tartari	Drej. Inst. Ront. pr. Sp. Zog I.	,,	
11	» Bajram Iljazi	,, i lab. Bakt. të Shtetit	,,	
12	» Anton Ashta	Shef i Seks. Antimalarik	,,	
13	» Hajrullah Harxhi	Mjek i Bashkisë	,,	
14	» Jecques Panteqi	,, ,,	,,	
15	» Ali Qemal Jusufati	Drejt. i P. Kryqit Kuq	,,	
16	» Jan Basho	Drejtor i Sp. P. Ushtarak	,,	
17	» Ibrahim Dhrami	Mjek ,, ,, ,, ,,	,,	
18	» Spiro Treska	,, ,, ,, ,, ,,	,,	
19	» Luigj Benushi	,, ,, Ushtëris	,,	
20	» Agostin Sheldija			për spec. Romë
21	» Nusret Kokobobo			,, ,, ,,
22	» Refat Frashëri	,, Privat	,,	(Pensionist)
23	» Syrja Pojani	,, ,,	,,	
24	» Jani Melo	,, ,,	,,	(Deputet)
25	» Ismet Gega	,, ,,	,,	
26	» Jacques Hobdari	,, ,,	,,	
27	» Bedri Permeti	,, ,,	,,	(Pensionist)
28	» Simon Simonidhi	,, ,,	,,	(Deputet)
29	» Ludovik Kalmar	,, ,,	,,	U emërua mjek
30	» Dhimolea Lluka	,, ,,	,,	i Sp. ZOG I
31	» Aleksander Buda	Mjek i Bashkisë	Durrës	
32	» Elena Andruçi	Mjekse e Bashkis	,,	
33	» Neki Ata	Mjek Privat	,,	
34	» Mit Vokopola	,, ,,	,,	
35	» Zucchi Gino	,, ,,	,,	
36	» Mustafa Halit	,, i Bashkis	Kavajë	
37	» Dhimiter K. Shurajiti	,, Privat	,,	
38	» Katerine M. Bal-Dini	Mjekëse e Bashkis	Shijak	
39	» Dhimiter Ikonomi	Mjek i Bashkis	Krue	
40	» Basri Qallimi	Drejt. i Sp. Shtetit	Shkodër	
41	» Abdullah Mehmeti	Mjek shetitës i malësinave	,,	
42	» Jorgji Karamitri	,, ,, Puk-Mjeditë	,,	
43	» Sadik Ymeri	,, i Bashkis	,,	
44	» Gjon Saraçi	,, Privat	,,	

Nr. Rend.	EMNI E MBIEMNI	Cilësija	Vend-banimi	Vërejtje
45	Dr. Pjeter Prela	Mjek Privat	Shkodër	
46	» Natalija Mirzabeg	,, ,,	,,	
47	» Lush Pogu	Shef i Stac. antimalarik	,,	
48	» Mihal Çaushi	Mjek i qeveris	Lesh	
49	» Myrteza Aliu	Drejt. i Disp. Shtetit	Pështkupi	
50	» Mokin Potruli	Mjek i Qeveris	Mat	
51	» Mehmet Izeti	,, ,,	Zergjan	
52	» Mihal Cani	,, shetitës i Kosovës	Kukës	
53	» Abduraman Kasimati	Drejt. i Disp. Shtet.	Elbasan	
54	» Simo Popa	Mjek i bashkis	,,	
55	» Vasil I. Rako	,, Shetitës	,,	
56	» Xhafer Elbasani	Shef Stac. antimalarik	,,	
57	» Petraq Popa	Mjek i Ushtëris	,,	
58	» Dhim. Propopullos	Mjek shetitës	Gramsh—Shpat	
59	» Abdullah Vehapi	Mjek i bashkis	Peqin	
60	» Fahri Reshiti	Drejt. i Sp. Shtetit	Vlonë	
62	» Vasil Dhimitraj	Mjek i sp. ,,	,,	
62	» Ali Mihali	Drejt. çmend. Shtetit	,,	
63	» Isan Korça	Mjek i Bashkis	,,	
64	» Hajdar Vlora			Përspec. Paris
65	» Hazbi Kuçi	,, Shetitës	Vlonë—Himarë	
66	» Qazim Seidini	,, Privat	,,	
67	» Athanas Qirko	,, Privat	,,	
68	» Athanas Grillo	,, ,,	Himarë	
69	» Nikolla Spiro Milios	,, ,,	,,	
70	» Hajdar Sulo	Drejt. i Disp. Shtetit	Berat	
71	» Nikolla Haxhistasa	Mjek i bashkis	,,	
72	» Jani Kona	,, Privat	,,	
73	» Sami Berati	,, i Bashkis	Lushnje	
74	» Llambi Gjergo	,, shetitës	Libofsh	
75	» Musa Delvina	,, i bashkis	Fier	
76	» Leonidha Gjinaj	,, Privat	,,	
77	» Kostandin Kallogjeri	,, ,,	,,	
78	» Haxhi Pumo	,, i Qeveris	Mallakastër	
79	» Viktor Zografi	,, ,,	Skrapar	
80	» Aksellon G. Nigdeli	,, i Komunës	Reskovec	
81	» Llambi Dardha	Drejt. i Sp. Shtetit	Korçë	
82	» Sali Zavalani	Mjek i sp. shtetit	,,	
83	» Hifzi Kasimati	,, i bashkis	,,	
84	» Shyqri Çupishti	,, privat	,,	
85	» Sotir J. Bilbili	,, ,,	,,	
86	» Pandeli Diozheni	,, ,,	,,	
87	» Vasil Zografi	,, ,,	,,	
88	» Nikolla P. Zografi	,, ,,	,,	
89	» Sotir Polena	,, ,,	,,	
90	» Epiminonda Harizi	,, ,,	,,	
91	» Avni Prishtina	,, i Bashkis	Bilisht	
92	» Filip Papajani	,, ,, ,,	Pogradec	
93	» Aleksandër Kristoduli	,, ,, ,,	Leskovik	

Nr. Rend.	EMNI E MBIEMNI	Cilësija	Vend-banimi	Vërejtje
94	» Nikolla Papajani	Mjek i Bashkis	Kolonjë	
95	» Telemak Laboviti	Drejt. i Sp. Shtet	Gjinokastër	
96	» Kamber Malili	Mjek i bashkis	,,	
97	» Sokrat Boxhori	,, privat	,,	
98	» Hasan T. Çaçoli	,, ,,	,,	
99	» Alek. Kalivopullo	,, ,,	,,	
100	» Sh. Kryezokopullo	,, ,,	,,	
101	» Musa Ohri	,, i bashkis	Permet	
102	» Stathi Kondi	,, Privat	Zagori	
103	» Kostandin Dedopullo	,, i komunes	Këlcyrë	
104	» Haki Babameto	,, shetitës	Kurvelesh	
105	» Halit Kamberi	,, i Qeveris	Tepelenë	
106	» Ali Kumbaro	,, ,, bashkis	Libëhovë	
107	» Vasil Papavangjeli	,, Privat	,,	
108	» Petro Dudi	,, ,,	,,	
109	» Ilia Th. Zeri	,, ,,	,,	
110	» Mihal Papadhimitri	,, ,,	Jorgucat-Libëhovë	
111	» Grigor Kiçati	,, ,,	Poliçan	
112	» Athanas Jan Çipa	,, ,,	Kakavie (Bulerat)	
113	» Jorgji Nako	,, i Qeveris	Konispol	
114	» Spiro Karajani	,, ,, bashkis	Sarandë	
115	» Pavlo Nathanaili	,, ,, ,,	Delvinë	
116	» Vasil Lezo	,, privat	,,	
117	» Petro Nako	,, ,,	,,	
118	» Mihal Mano	,, ,,	,,	
119	» Spiro Vrizopullo	,, ,,	,,	

BISHT

Lista e dentisteve në Shqipní më 1932

Nr. rend.	EMNI E MBIEMNI	Vend-banimi	I Dipllomuar, Teknik apo Praktikant	V r e j t j e
1	Avni Lako	Tiranë	I Dipllomuar	
2	Rudolf Schürman	,,	,,	
3	A. Bournazian	,,	,,	
4	Markarian Agop	,,	,,	
5	Athanas Prosi	,,	Teknik	
6	Myrteza Bega	,,	,,	
7	Rudolf Musani	,,	,,	
8	Sherif Verdi	,,	Pratikant	S' ka Ateljer
9	Perikli Prosi	Durrës	Teknik	
10	Themistokli Prosi	,,	Pratikant	
11	Thoma Tanko	,,	,,	S' ka Ateljer
12	Mihal Hebe	,,	,,	,, ,,
13	Jorgji Vava	,,	,,	,, ,,
14	Munir Dobi	Kavajë	,,	
15	Hasan Kaduku	Shkodër	I Dipllomuar	
16	Ismail Haki Kaduku	,,	,,	
17	Islam H. J. Turkaj	,,	,,	
18	Sali Ibrahim	,,	Pratikant	
19	Rifat R. Dibra	Lesh	,,	
20	Sulejman Bisha	Kukës	,,	
21	Qemal Bobrati	Elbasan	Teknik	
22	Emin Ruzhdi	,,	,,	
23	Emin Qamil	Berat	,,	
24	Emanuel Asderian	,,	,,	
25	,, Berberian	,,	Pratikant	
26	Havset Berberian	Vlonë	I Dipllomuar	
27	Ruzhdi Skenduli	Gjinokastër	,,	
28	Xhemal Çuçi	,,	,,	
29	Haki Kaman Seldo	,,	Teknik	
30	Atif Laka	Përmet	Pratikant	
31	Jakup Haxhiu	Libohovë	,,	
32	Kristaq Zografi	Korçë	I Dipllomuar	
33	Dhimiter K. Terzia	,,	,,	
34	Ilia M. Fundo	,,	,,	
35	Theodor Sotir Maliqi	,,	,,	
36	Anastas Ziko	,,	Teknik	
37	Nikolla Konduli	,,	I Dipllomuar	
38	Kostantin Saro	Hoçisht (Bilisht)	Teknik	
39	Engelbert Churman	Pogradec	,,	

Lista e Farmacistevet në Shqipní më 1932

Nr. Rend.	EMNI E MBIEMNI	Vënd-banimi	I Dipllomuar ose Praktikant	V r e j t j e
1	Hidajet Ajdini	Tiranë	I Dipllomuar	Farm. i Spit. P. ZOG I.
2	Athanas Shundi	,,	,,	
3	Ahmet Fevzi Rusi	,,	,,	
4	Musli Izet Kokobobo	,,	,,	
5	Spiro Papanastasi	,,	,,	Farm. i Spit. Përgj. Ush.
6	Telemak Noçka	,,	,,	,, ,, ,, ,,
7	Vladimir Caku	,,	Praktikant	Ndih farm. i sp. P. ZOG I.
8	Faik Tomini	,,	,,	
9	Zef Herzek	Vorës (Tiranë)	,,	
10	Mark Stefan Herzek	Durrës	I Dipllomuar	
11	Moise Popa	,,	,,	
12	Sururi Libohova	,,	,,	F. i ambul. Bash. Durrësit
13	Andrea Mima	,,	Praktikant	
14	Anton Herzek	,,	,,	
15	Neki Kaman Halit	Shijak	,,	S'ka farmaci
16	Kozma Bitri	Kavajë	,,	
17	Athanas M. Bidoshi	,,	,,	
18	Xhafer Kokobobo	Krujë	,,	
19	Zoj. Gjiuseppina Pardo	Milot (Krue)	,,	
20	Jak Mishon Arditi	Shkodër	I Dipllomuar	
21	Ndoc Ashiku	,,	,,	
22	Pashko Ashiku	,,	,,	
23	Reuf Sulo	,,	,,	
24	Daniel Muzali	,,	,,	
25	Mehmed Said Pipa	,,	,,	
26	Zoj. Cento Emma Battzi	,,	,,	
27	Risto Tomiqi	,,	Praktikant	
28	Hamza Ramia	Lesh	,,	
29	Shyqri Ymer Dibra	Koplik (Shkodër)	,,	
30	Pavlo Dh. Gushi	Kukës	,,	
31	Taqi Buda	Elbasan	I Dipllomuar	
32	Hasan Misiri	,,	Praktikant	
33	Spiro J. Lazeri	,,	,,	S'ka farmaci
34	Xhelal Et-hem Dallija	Peqin	,,	
35	Vangjel Haxhistasa	Berat	I Dipllomuar	
36	Athanas Haxhistasa	,,	,,	S'ka farmaci
37	Lluka Papa Athanasi	,,	Praktikant	
38	Mihal I. Zako	,,	,,	
39	Kabuli Fazlli	Lushnje	I Dipllomuar	
40	Koço Papadhopullo	,,	,,	
41	Ton Gjysh Gjonej	Fier	Praktikant	
42	Sotir A. Bitri	,,	,,	
43	Sherif Ago Dushi	Mallakastër	,,	

SHSH

Nr. Rend.	EMNI E MBIEMNI	Vënd-banimi	Diplome ose Praktikant	V r e j t j e
44	Vangjel A. Gjata	Reskovec	Praktikant	
45	Jani Zoga	Vlonë	I Dipllomuar	
46	Fadil Kotoni	,,	,,	
47	Jani Anastasiadhi	,,	,,	
48	Pavllo Athanas Qirko	,,	,,	
49	Jani M. Pantozi	Himarë	Praktikant	
50	Ilia Joanidhi	Nartë	,,	
51	Abdulla V. Gjoka	Dhermi (Himarë)	,,	
52	Myhedin M. Kokolari	Gjinokastër	I Dipllomuar	
53	Aleks Çeçi	,,	,,	
54	Besim V. Gega	,,	,,	
55	Niko Çeçi	,,	,,	S'ka farmaci
56	Jorgji Pantozi	Delvinë	,,	
57	Areti Anastasiadhi	,,	,,	
58	Kasem Muharemi	Piqeras (Delvinë)	Praktikant	
59	Vasil Çepo	Dhrovjan(,,)	,,	
60	Vasil Stavro Çati	Sarandë	I Dipllomuar	
61	Sulejman Kunjari	,,	Praktikant	
62	Irakli N. Maqellari	Përmet	I Dipllomuar	
63	Vasil S. Avramidhi	,,	,,	
64	Lazar K. Sadrica	Tepelenë	Praktikant	
65	Thoma K. Dhima	,,	,,	S'ka farmaci
66	Mahmut Halit Toto	Libëhovë	Praktikant	
67	Petrit Gega	Jergucat (Libhov)	,,	
68	Vangjel V. Thaka	Konispol	,,	
69	Ligor Skali	Korçë	I Dipllomuar	
70	Nikuça Bullamaçi	,,	,,	
71	Thoma P. Shomo	,,	,,	
72	Dhimiter Shanozi	,,	,,	
73	Petro Dh. Jankulla	,,	,,	
74	Nikolla Mihali	,,	,,	
75	Danjel Kostandini	,,	,,	S'ka farmaci
76	Kozma Vasil Qirinxhiu	,,	,,	
77	Nikolla Naçi	,,	Praktikant	Farm. i Spit. Korçë
78	Koço Dh. Gecka	,,	,,	S'ka farmaci
79	Jani Mima Koçallari	,,	,,	në Rev. Usht. Korçë
80	Nikolla Çekani	,,	,,	
81	Vasil Anastas Melani	Leskovik	,,	
82	Stathi I. Papalilo	Kolonjë	,,	
83	Kristo Stefa	Pogradec	,,	
84	Sokrat Çapi	Bilisht	,,	
85	Ilo Mihali	,,	,,	

Lista e mamive në Shqipni më 1932

Nr. Rend.	EMNI E MBIEMNI	Cilësia	Vend-banimi	Vërejtje
1	Zonja Makbule Dizdari	Mami e Bashkis	Tiranë	
2	,, Nedime Laka	,, ,, ,,	,,	
3	Zonjusha Luçia Berisha	,, ,, ,,	,,	
4	,, Luba Tasi	,, Private	,,	
5	Zonja Agjeliqi Pepi	,, e Bashkis	Durrës	
6	Zonjusha Kaliroj Bitta	,, ,, ,,	,,	
7	,, Pranvera Hamzaraj	,, Private	,,	
8	,, Dilbere Deliallisi	,, e Bashkis	Shijak	
9	,, Theodore Guga	,, ,, ,,	Krujë	
10	,, Muhrije Xheka	,, ,, ,,	Kavajë	
11	,, Çile Sheldija	,, ,, ,,	Shkodër	
12	Zonja Marie Giorgji	,, Private	,,	
13	Zonjusha Nadire Elbasani	,, e Bashkis	Berat	
14	Zonja Rosalia Xhimitiku	,, Private	,,	
15	Zonjusha Polikseni Anastasi	,, e Bashkis	Fier	
16	,, Katrina Gjon Kola	,, ,, ,,	Vlonë	
17	,, Zehra Kalajxhi	,, ,, ,,	Gjinokastër	
18	Zonja Marie Akshia	,, Private	,,	
19	Zonjusha Fereniqi Lomka	,, e Bashkis	Përmet	
20	,, Urani Noçka	,, ,, ,,	Delvinë-Sarandë	
21	Zonja Areti Kacimbro	,, Private	Delvinë	
22	Zonjusha Emilie Shahini	,, e Bashkis	Korçë	
23	Zonja Dhimitrulla Beluri	,, Private	,,	
24	,, Zejnepe Dushi	,, e Bashkis	Bilisht	

BIBLIOTEKA

BKSH